Rruga e Arbërit



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 7 (87). KORRIK 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

KONTRIBUT

Musa Riçku financon xhaminë e re në Limjan

Nga **AHMET ÇAUSHI** - FAQE 7

TURIZËM

Vargmali i Deshatit, aty ku nis zhvillimi...

Nga **BESNIK ALKU** - FAQE 11

STUDIM

Potencialet e turizmit malor

Nga **FATBARDH CENA** - FAQE 12-13

ARSIM

Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik...

Nga PROF. DR. **NURI ABDIU** - FAQE 9

SHËNIM

Solidarizohuni me rininë dibrane duke nënshkruar peticionin

Nga **Dr.GËZIM ALPION**

Ne, intelektualët dibranë, që po lobojmë për ndërtimin e Rrugës së Arbrit nëpërmjet peticionit online, jemi mrekulluar që në fillim nga reagimi pozitiv i rinisë dibrane. Kemi marrë mesazhe nga një numër i madh të rinjsh dibranë nga disa qytete, si në Shqipëri dhe Maqedoni, ashtu edhe nga disa vende në Evropë, përfshirë edhe Australinë dhe Amerikën e largët.

Ajo që na ka lënë mbresa është jo vetëm gatishmëria e tyre për ta nënshkruar peticionin dhe për të inkurajuar familjet, miqtë dhe kolegët e tyre të bëjnë të njëjtën gjë, por edhe sugjerimet që na kanë bërë se si mund të lobojmë në mënyrë sa me të efektshme për ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Një numër mesazhesh kemi marrë nga të rinj dibranë të mërguar, disa prej të cilëve ose janë larguar nga Dibra në një moshë të re ose nuk janë lindur në Dibër. Ajo që është e përbashkët tek të gjithë, është një përkushtim sa emocionues, aq dhe kuptimplotë ndaj Dibrës.

Dibra, në të dy krahët e kufirit, ka një rini të mrekullueshme, patriote, të etur për dije dhe kulturë, me një krenari të ligjshme për tabanin e tyre dibran dhe një vizion bashkëkohor perëndimor.

Noli dikur i jepte zemër Shqipërisë të mos kishte frikë, pasi kishte djemtë në Amerikë. Diaspora edhe sot po luan një rol të rëndësishëm si në mbrojte të interesave të kombit, ashtu edhe në zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe Kosovë. Megjithatë, tani ka ardhur koha që diaspora, përveç përkushtimit që po tregon ndaj kombit dhe emancipimit demokratik të dy shteteve shqiptare, duhet ta ngrejë zërin edhe në përkrahje të krahinave të 'largëta' në Shqipëri dhe Kosovë të lëna në një mjerim migjenian nga një klasë politike, e cila akoma nuk e kupton se një Tiranë dhe Prishtinë e mbipopulluar janë tregues të një Shqipërie dhe Kosove të pazhvilluar.

Këtë angazhim të rëndësishëm dhe përkushtim të admirueshëm ndaj Shqipërisë së 'skajshme' po e bëjnë shumë mirë nëpërmjet këtij peticioni online të rinjtë dibranë të shpërngulur nga Dibra kryesisht në Tiranë si dhe jashtë Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Këta të rinj dibranë do të jenë intelektualët e së nesërmes dhe ky përkushtim që ata po dëshmojnë që tani në bankat e shkollës së mesme dhe si studentë tregon se si Shqipëria e Nolit, edhe Dibra jonë, kurrë nuk do të hupë me një rini për ta pirë në kupë.

Ne do t'iu bënim thirrje të gjithë të rinjve shqiptarë të solidarizohen me bashkëmoshatarët e tyre dibranë, që ta nënshkruajnë peticionin online për përfundimin sa më parë dhe me standarde të Rrugës së Arbrit.

Dibra, që gjithmonë është sakrifikuar për kombin, do të dijë se si ta shprehë mirënjohjen ndaj atyre që po e përkrahin në një moment kur ajo kërkon ndihmë për një projekt që do t'i shërbejë sa Dibrës në të dy krahët e kufirit dhe kombit shqiptar, ashtu edhe vendeve fqinjë me të cilët kjo arterie e rëndësishme do të sjellë më pranë.

Angli, 29 Korrik 2013

Rruga e Arbrit

Të parandalohen ndryshimet, për të rritur cilësinë e ndërtimit



Nga **PROF. DR. BASHKIM LLESHI**

TUNELI I QAFË BUALLIT

Tuneli i Qafës së Buallit është vendosur në pozicionin më të keq të mundshëm, aty ku kalon prishja e madhe tektonike nga lugina e Planit të Bardhë në Qaf Buall dhe vazhdon në luginën e Vajkalit deri në Fushë Bulqizë... Në kushtet e krijuara për të hapur 400 ml. tunel aty ku kanë filluar përgatitjet, shpenzimet do të shkojnë sa për të hapur 850ml., tunel aty ku duhet të fillojë hapja e tunelit... Ka edhe mendime dashakeqëse që fliten rrugëve, se s'ka nevojë të hapet tuneli, se kalimi i Qafës se Buallit mund të bëhet në formën e një useku etj., kur për hapjen e këtij tuneli si pjesë përbërëse e Rrugës së Arbërit ka një miratim të Këshillit Kombëtar të Rrugëve që në gusht të vitit 2004.

URA E VASHËS

Pas një studimi të tillë gjeologo-inxhinjerik, si ka mundësi që aksi ku do të ndërtohet ura, të mos caktohet aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, për të dalë ura më e shkurtër, pra mbi Urën e vjetër të Vashës, por zbritet më poshtë, aty ku lugina është gati dyfish më e gjerë, duke dyfishuar shpenzimet për ndërtimin e Urës. Për Urën e Vashës ka patur edhe propozime që tek gryka e Urës, në vend të Urës së lartë të ndërtohet një digë me material vendi mbi të cilën të kalojë rruga dhe mbi digën krijohet një liqen artificial, ujët e të cilit do të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

TUNELI I GURIT TË BARDHË

Me paratë e kursyera nga Ura e Vashës, mund të parashikohej që Tuneli i Gurit të Bardhë të ishte më i gjatë, të kalonte në formacione po të qëndrueshme në të cilat punohet më kollaj për hapjen e tunelit, më afër fshatit turistik të Gurit të Bardhë, përball kalasë së Petralbës historike, duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e rrugës.

TUNELI I MURRIZËS

Për tunelin e Murrizës nuk ka asnjë argument teknik që të bëhet pengesë për hapjen e tij. Rreth 80% e gjatësisë së tunelit është e ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinj mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor (Greqia) ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë–Selanik.

LEXONI NË FAQET 2-3

OPINIONE

Rruga e Arbrit do të kontribuojë në unitetin tonë kombëtar

Kinezët shfaqin interesim për ndërtimin me koncesion

LEXONI NË FAQET 4-5


cyan magenta yellow black 1

Dibranët nuk e meritojnë as vonesën në ndërtimin e rrugës
dhe as ndërtimin e një rruge jashtë standardeve të kohës.

Posta e
Rruga e Arbërit
Gazetë e pavarur.
Nr. 7 (87). 1 - 31 Korrik 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim. Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Mustafa Tola, Vesel Hoxha, Naim Selmani, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Bashkim LLESHI
Nuri ABDIU
Gëzim ALPION
Abdurahim ASHIKU
Rexhep TORTE
Ahmet ÇAUSHI
Destan RAMA
Hysen LIKDISHA
Besnik ALKU
Fatbardh CENA
Afrim KAROSHI
Selman MEZIU
Zabit LLESHI
Mevlud BUCI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Rruga e Arbrit

Të parandalohen ndryshimet, për të rritur cilësinë e ndërtimit

Nga Prof. Dr. **BASHKIM LLESHI**

Si bashkautor i Studimit të Fizibilitetit të Rrugës së Arbërit, që në përbërje të Grupit të Studios Infratransproject Ltd, kam kryer pjesën e Studimit "Mbi kushtet gjeologo-inxhinjerike dhe gjeoteknike të rrugës Tiranë-Dibër" kam ndjekur në vazhdimësi punën që po kryhet në këtë rrugë, si në segmentin e përfunduar Bulqizë-Ura e Çerenecit, ashtu dhe vazhdimin nga Bulqiza në drejtim të Urës së Vashës si dhe nga Uzina e Artilerisë në Zall Dajt nga ana e Tiranës.

Nga ecuria e këtyre punimeve kam vërejtur se ne segmentet Bulqizë-Ura e Çerenecit dhe Bulqizë-Ura e Vashës, janë bërë disa shmangie nga aksi i miratuar në Studimin e Fizibilitetit, nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në nëntor të vitit 2003 dhe nga Këshilli Kombëtar i Rrugëve, në korrik të vitit 2004, ku u miratua Studimi i Fizibilitetit të kësaj rruge, ndryshime që për fat të keq deri tani kanë çuar në prishjen e cilësisë së rrugës dhe jo në përmirësimin e saj.

Pas shumë përpjekjesh, në vitin 2007 përfundoi projekti i zbatimit të segmentit "Dalje e Bulqizës-Ura e Çerenecit" dhe në janar të vitit 2008, filloi puna për ndërtimin e këtij segmenti. Mbështetur në ndryshimet që pësoi rruga në këtë aks, për të parandaluar ndryshimet që mund të pësonte aksi i rrugës nga Bulqiza në drejtim të Urës së Vashës, në Gazetën "Rruga e Arbërit" nr.5(25) të muajit Maj të vitit 2008, unë botova artikullin "Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së miratuar në studimin e fizibilitetit në dëm të cilësisë së saj". Megjithëse në fund të vitit 2008 botova edhe librin "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit", ku përshkruhen përpjekjet e mëdha të shumë intelektualëve e studiuesve dibranë e jo dibranë për fillimin e punës për ndërtimin e "Rrugës së Arbërit" dhe tërhiqet vëmendja që të mos bëhen ndryshime nga Studimi i miratuar i Fizibilitetit në drejtim te prishjes së cilësisë së rrugës, por përmirësime në drejtim të rritjes së cilësisë, përsëri rruga në drejtim të Urës së Vashës vazhdoi me ndryshime e mangësi.

Puna e kryer në aksin nga Bulqiza deri tek Ura e Çerenecit, me ndonjë përmirësim të vogël, është pothuajse rikonstruksion i rrugës ekzistuese dhe jo ndërtimi i një aksi të ri të miratuar sipas Studimit të rrugës së Arbërit.

Segmenti nga Dalja e Bulqizës në drejtim të Tunelit të Qaf Buallit, nga nënkalimi tek rruga që lidh qytetin e vjetër të Bulqizës me të riun në vend që të shkonte drejt, në pjesën e poshtëme të ish parkut automobilistik dhe të varrezave në fushë, e të dilte në pjesën veri lindore të Dambës së Fabrikës së Pasurimit, pësoi një ngritje duke krijuar një usek të panevojshëm i cili gjatë dimrit është problematik nga akulli e dëbora. U shtuan mijëra m^3 volume në mes të fushës pa patur asnjë problem gjeologo-inxhinjerik për ta bërë këtë ngritje dhe që nuk ka çuar në ndonjë përmirësim të cilësisë së rrugës, por përkundrazi e ka prishur cilësinë e saj.

Eshtë për të ardhur keq se këto ndryshime nga aksi i miratuari Studimit të Fizibilitetit, nga Ura e Çerenecit deri tek Ura e Vashës janë bërë, ose janë lejuar të bëhen, nga e njëjta Studio që ka kryer këtë studim.

Po mbushen 10 vjet nga përfundimi e miratimi i Studimit të Fizibilitetit dhe rruga e shumë premtuar nga politikanët në të gjitha zgjedhjet vendore e parlamentare nga viti 2005 e deri në vitin 2013 nuk është vënë në rrugën e drejtë të zgjidhjes përfundimtare. Vonesat në ndërtimin e kësaj rruge, këto tre vitet e fundit, shumë politikanë edhe të lartë në biseda e takime të ndryshme dhe në media janë munduar ti justifikojnë, jo me neglizhencat e papërgjegjshmërinë e tyre për sigurimin e fondeve, por me ndonjë arsye gjoja gjeologjike e gjeoteknike, të sugjeruara nga ndonjë specialist jo kompetent e servili të pushtetit.



Gryka e lumit Mat tek Ura e vjetër e Vashës.
Foto © Bashkim Lleshi Shtator 2004

Pas një studimi të tillë gjeologo-inxhinjerik, si ka mundësi që aksi ku do të ndërtohet ura, të mos caktohet aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, për të dalë ura më e shkurtër, pra mbi Urën e vjetër të Vashës, por zbritet më poshtë, aty ku lugina është gati dyfish më e gjerë, duke dyfishuar shpenzimet për ndërtimin e Urës.
Për Urën e Vashës ka patur edhe propozime që tek gryka e Urës, në vend të Urës së lartë të ndërtohet një digë me material vendi mbi të cilën të kalojë rruga dhe mbi digën krijohet një liqen artificial, ujët e të cilit do të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

Puna e bërë deri tani në segmentin Bulqizë–Ura e Çerenecit dhe dalje e Bulqizës Tuneli i Qafë Buallit nuk korrigjohet. Për vazhdimin më tej të ndërtimit të kësaj rruge, objektet kryesore për të cilat duhet të ndërhyhet në projektet e zbatimit për të mos ndryshuar gjatësitë dhe pozicionet e tyre, në drejtim të prishjes së cilësisë së rrugës por përmirësimit të saj janë: Tuneli i Qafë Buallit, Ura e Vashës dhe Tuneli i Murrizës.

TUNELI I QAFË BUALLIT

Në studimin e fizibilitetit për Qafën e Buallit është argumentuar hapja e një tuneli me gjatësi 850m me dalje nga ana e Bulqizës në lartësinë 800m, rreth 5m mbi nivelin maksimal të Dambës se Fabrikës së pasurimit të kromit Bulqizë, në pjesën veri lindore të kësaj dambe. Në këtë studimi theksohet se : *"Tuneli i Qaf Buallit kalon nëpër shkëmbinj të fortë e të qëndrueshëm ultrabazikë me karakteristika fiziko-mekanike shumë të mira"*. (Bashkim Lleshi 2003, 2008).

Ky konkluzion është arritur nga vrojtimet sipërfaqësore në zonën e Qafës së Buallit dhe nga shpimet e kryera nga Gjeologjia e Bulqizës ngjitur me Qafën e Buallit në pjesën veriore të saj. Theksojmë se në të njëjtat formacione gjeologjike janë hapur 12 km. tunel (dy tunele paralel nga 6 km. secili) nga Shëngjuni në drejtim të Bulqizës (Traverbangu Klos-Bulqizë) e me mijëra ml. tunele që lidhin vendburimin e Bulqizës me atë të Batrës, apo se në shkëmbinj të tillë ultrabazikë është hapur tuneli i Kalimashit në rrugën e Kombit. Arsye gjelogo-inxhinjerike që vështirësojnë hapjen e këtij tuneli nuk ka.

Gjatë kohës që vazhdonin projektet e zbatimit në vitet 2007 e 2008 filloi me shpejtësi të zgjerohet Damba e Fabrikës së pasurimit të kromit në ekstremin veri lindor të saj, pikërisht në pozicionin ku do të kalonte rruga dhe do të hapej gryka e tunelit. Si rregull para se të përpilohet projekti teknik i hapjes së tunelit duhet të kryhet studimi gjeologo-inxhinjerik i zonës ku do të hapet tuneli, nëpërmjet të cilit caktohet aksi i hapjes se tunelit, duke përcaktuar koordinatat e lartësitë e grykave të hyrjes dhe daljes së tij. Kryerja e këtij studimi presupozon edhe punime shpimi gjatë aksit të tunelit ku merren kampione për përcaktimin e vetive fiziko-mekanike të shkëmbinjve. Në rast se ekziston një studim i tillë i cili me siguri duhet të jetë kryer, si ka mundësi që tuneli të vendoset në pozicionin më të keq të mundshëm, aty ku kalon prishja e madhe tektonike nga lugina e Planit të Bardhë në Qaf Buall dhe vazhdon në luginën e Vajkalit deri në Fushë Bulqizë që ndan Masivin ultrabazik të Bulqizës në dy pjesë, në atë veriore dhe jugore.

Për çudi grykat e hyrjes dhe daljes së tunelit janë vendosur në aksin e kësaj prishje tektonike, ku shkëmbinjtë janë plotësisht të shkatërruar. Si ka mundësi që për një punim të tillë kapital, përcaktimi i grykave të hyrjes e daljes së tunelit të mos bëhen nëpërmjet një grupi studimor me specialist të aftë, por të bëhen nga diletante. Asnjë specialist i fushës së gjeologjisë, jo më i gjeologjisë inxhinjerike, edhe sikur të mos ketë fare eksperiencë, nuk mund të caktojë, jo me studim, por edhe pa studim, vendosjen e aksit të tunelit aty ku kanë filluar përgatitjet për hapjen e grykave të këtij tuneli.

Nga kompania që ka marrë përsipër hapjen e tunelit janë thirrur specialistë me eksperiencë në fushën e minierave që kanë drejtuar punimet për hapjen e Traverbankut të Klosit dhe janë tërhequr, nuk e kanë marrë përsipër drejtimin teknik për hapjen e këtij tuneli aty ku është vendosur, jo se nuk ka asnjë mundësi teknike për tu hapur, por për tu hapur aty ku është vendosur duhet përdorur teknologji e metoda speciale (me ngrirje) duke dyfishuar shpenzimet për kryerjen e 1 ml (metër linear) tuneli.

Në kushtet e krijuara për të hapur 400 ml. tunel aty ku kanë filluar përgatitjet për hapjen e tunelit, shpenzimet do të shkojnë sa për të hapur 850ml. tunel aty ku duhet të fillojë hapja e tunelit(20 deri 50m më në veri të këtij aksi).

kryesore



Pamje e Qafë Buallit. Në VL të Dampës kalon tuneli. B.Lleshi nëntor 2006

Në rast se nuk do të merren këto masa për korrigjimin e mangësive të vërejtura, brezat nuk do të na e falin ndërtimin e kësaj rruge pa standarde, në një kohë që janë të gjitha mundësitë dhe mjetet për të ndërtuar një rrugë të kohës me standarde europiane. Po të ndërtojmë një rrugë të mirë sot, do të na urojnë brezat nesër, e po të bëjmë një rrugë jo të mirë sot do të na mallkojnë brezat. Le të bashkërendojmë forcat e mendimet që të marrim urimin e brezave.

Tuneli i Qafës së Buallit është vendosur në pozicionin më të keq të mundshëm, aty ku kalon prishja e madhe tektonike nga lugina e Planit të Bardhë në Qaf Buall dhe vazhdon në luginën e Vajkalit deri në Fushë Bulqizë... Në kushtet e krijuara për të hapur 400 ml. tunel aty ku kanë filluar përgatitjet, shpenzimet do të shkojnë sa për të hapur 850ml. tunel aty ku duhet të fillojë hapja e tunelit... Ka edhe mendime dashakeqëse që fliten rrugëve, se s'ka nevojë të hapet tuneli, se kalimi i Qafës se Buallit mund të bëhet në formën e një useku etj. kur për hapjen e këtij tuneli si pjesë përbërëse e Rrugës së Arbërit ka një miratim të Këshillit Kombëtar të Rrugëve që në gusht të vitit 2004.

Ka edhe mendime dashakeqëse që fliten rrugëve, se s'ka nevojë të hapet tuneli, se kalimi i Qafës se Buallit mund të bëhet në formën e një useku etj. kur për hapjen e këtij tuneli si pjesë përbërëse e Rrugës së Arbërit ka një miratim të Këshillit Kombëtar të Rrugëve që në gusht të vitit 2004.

URA E VASHËS DHE TUNELI I GURIT TË BARDHË

Në Studimin e Fizibilitetit është parashikuar që mbi Urën e vjetër të Vashës,aty ku shtrati i këtij lumi është më i ngushtë, me lartësi nga niveli i detit 400 m., të ndërtohet një urë e lartë rreth 120 m. që do të kapërcejë luginën e ngushtë të lumit të Matit nga krahu i Gurit të Bardhë në krahun e Planit të Bardhë.

Për të caktuar aksin ku do të vendoset kjo urë, për projektin teknik të urës, në radhë të parë duhet studimi i detajuar gjeologo-inxhinjerik i bazamentit ku do të vendoset kjo urë. Për vendosjen e kësaj ure kemi bërë debat edhe në grupin e punës, edhe në funksion të tunelit të Gurit të Bardhë që lidhet me këtë urë, ku janë propozuar tre variante, për të lënë variantin më të mirë, pas kryerjes së studimit gjeologo-inxhinjerik për Urën dhe tunelin e Gurit të Bardhë.

Edhe për Urën e Vashës vazhdon çudia. Pas një studimi të tillë gjeologo-inxhinjerik, si ka mundësi që aksi ku do të ndërtohet ura, të mos caktohet aty ku lugina e lumit është më e ngushtë, për të dalë ura më e shkurtër, pra mbi Urën e vjetër të Vashës, por zbritet më poshtë, aty ku lugina është gati dyfish më e gjerë, duke dyfishuar shpenzimet për ndërtimin e Urës. Aq më keq që rruga zbret më poshtë si lartësi duke ulur dhe cilësinë e saj, me pretendimin se i afrohet më shumë Klosit, sikur kjo rrugë po bëhet për të lidhur Dibrën me Klosin e jo me Tiranën e Durrësin. Klosi e ka degëzimin për tu lidhur me këtë rrugë, aty ku ndërpritet aksi i Rrugës së Arbërit me Rugën Klos- Guri i Bardhë.

Për Urën e Vashës ka patur edhe propozime të tjera. Pas miratimit të Studimit të Fizibilitetit në shtator të vitit 2004, gjeologët e vjetër të zonës së Matit, Flamur Çollaku e Haki Disha, pasi janë njohur me Studimin e Fizibilitetit të Rrugës së Arbërit, kanë propozuar që tek gryka e Urës së Vashës në vend të Urës së lartë të ndërtohet një digë me material vendi mbi të cilën të kalojë rruga dhe mbi digën krijohet një liqen artificial, ujët e të cilit do të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike.

Për vënien në jetë të kësaj ideje të gjeologëve të vjetër të kësaj zone, të mbështetur edhe nga Prof. Dr. Bashkim Lleshi, autor në grupin e Studimit të Fizibilitetit të Rrugës së Arbërit, një grup studiuesish me në krye Anëtarin e Akademisë së Shkencave, Prof.Dr. Farudin Hoxha së bashku me specialistët Bashkim Lleshi, Flamur Çollaku, Haki Disha, Ramazan Ceni e Salvador Bushati të shoqëruar dhe nga Kryetari i Bashkisë së Klosit, Bedri Hoxha, në shtator të vitit 2004 kryen vrojtime në terren në grykën e ngushtë të Urës së Vashës ku parashikohet të ndërtohet Ura, e cila propozohet të zëvendësohet me digë, që do të kryejë të dy funksionet, të Urës dhe të Rezervuarit të ardhshëm të Hidrocentralit që do të prodhojë energji. (Bashkim Lleshi, 2004)

Grupi që kreu vrojtimet në terren krijoi bindjen që ky propozim është me leverdi dhe për këtë duhet të kryhet një studim i veçantë, i cili do të shoqërojë projektin e zbatimit të rrugës, ose do të bëhet projekt më vete, duke bashkëpunuar me projektuesit e rrugës që të eliminohet Ura dhe Diga e Rezervuarit të kryejë funksion të dyfishtë, të rrugës dhe të pritës së ujit të rezervuarit të ardhshëm.

Nga viti 2005 e deri në vitin në vazhdim janë dhënë me qindra leje për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, janë bërë shumë diskutime se kjo urë është e shtrenjtë, por askush nga organet shtetërore nuk mendoi të japë një leje për studimin dhe ndërtimin e një hidrocentrali të tillë. Ura e shtrenjtë e Vashës, do të ndërtohej me fondet e hidrocentralit dhe do të kurseheshin fondet për të kryer në kohë dhe me cilësi objektet e tjera të rrugës. Me paratë e kursyera mund të parashikohej që Tuneli i Gurit të Bardhë të ishte më i gjatë, të kalonte në formacione po të qëndrueshme në të cilat punohet më kollaj për hapjen e tunelit, më afër fshatit turistik të Gurit të Bardhë, përball kalasë së Petralbës historike, duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e rrugës. (Bashkim Lleshi, 2007)

TUNELI I MURRIZËS

Tuneli i Murizës fillon nga km 25 + 200 m në lagjen Bastar (Kaçu) në përroin e Kaçujt, ku në lartësinë 850 m. është parashikuar të jetë hyrja e tunelit nga ana e Tiranës dhe del në km 28 + 200 m në përroin zalli i Mashnorit në Xibër Murizë afër shkollës fillore, në lartësinë 915 m me gjatësi 3 km. Lidhur me depozitimet që përshkon ky tunel në Studimin e Fizibilitetit shkruhet:

"Tuneli fillon në depozitimet flishore ranoro alevrolitore me ndërshtresa gëlqerore të Paleogjenit dhe pas 400-500m kalon në pakon e flishit kalimtar me trashësi 20-30m. Duke vazhduar më tej në pakon e flishit karbonatik të kuq me alterime të pakos së flishit gri të përfaqësuara nga ndërthurje të shkëmbinjve gëlqerorë mikrokokrizorë shtresë hollë, ngjyrë hiri të çelur me gëlqerorë mikrobrekçiorë shtresë mesëm dhe shtresë trashë. Në dalje të tunelit të Murrizës kemi përsëri pakon e flishit të kuq me rënje veriperëndimore dhe në 50–60m. e fundit tuneli del në shkëmbinjtë flishorë ranoro alevrolitorë të Paleogjenit. Formacionet në të cilat kalon tuneli janë të qëndrueshme, nuk paraqesin rreziqe ose pengesa nga ujrat nëntokësore sepse gëlqerorët kanë ndërtim pllakor dhe nuk kanë të zhvilluar fenomenet e karstit."

(Bashkim Lleshi 2003, 2008)

Edhe për tunelin e Murrizës është folur poshtë e lart nga politikanë të ndryshëm në biseda me elektorate zgjedhjesh e në media, se po vonohet projekti i tunelit të Murrizës se kanë dalë disa probleme gjeologjike, se mund të ketë probleme të prurjeve të mëdha te ujit të cilat nuk janë parashikuar etj. duke na detyruar të ngremë lartësinë e

Me paratë e kursyera nga Ura e Vashës, mund të parashikohej që Tuneli i Gurit të Bardhë të ishte më i gjatë, të kalonte në formacione po të qëndrueshme në të cilat punohet më kollaj për hapjen e tunelit, më afër fshatit turistik të Gurit të Bardhë, përball kalasë së Petralbës historike, duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e rrugës.

***

Për tunelin e Murrizës nuk ka asnjë argument teknik që të bëhet pengesë për hapjen e tij. Rreth 80% e gjatësisë së tunelit është e ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinj mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor (Greqia) ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë–Selanik.

tunelit etj. justifikime të pa argumentuara teknikisht, por të hedhura për konsum publik, për të justifikuar zvarritjet e punimeve të kësaj rruge, gjoja nga pengesa objektive të paparashikuara.

Siç e kam përshkruar më lart, fjalë për fjalë, në Studimin e Fizibilitetit, për tunelin e Murrizës nuk ka asnjë argument teknik që të bëhet pengesë për hapjen e tij. Rreth 80% e gjatësisë së tunelit është e ndërtuar nga shkëmbinj gëlqerorë pllakorë, me pak ose pa ujë, me formacione më të qëndrueshme se ato të tuneleve që kemi hapur në Kalimash e në Krrabë, ndërsa vetëm 20% e gjatësisë, në hyrje nga ana e Tiranës, ndërtohen nga shkëmbinj mesatarisht të qëndrueshëm në të cilat fqinji jonë jugor (Greqia) ka ndërtuar mijëra metër lineare tunele në rrugën Janinë–Selanik.

Mbështetur në këto të dhëna as që duhet bërë fjalë për të ngritur lartësinë e hapjes së tunelit të Murrizës, gjoja për arsye teknike, rrjedhimisht për të shkurtuar gjatësinë e tunelit e për të shtuar ngjitjet e zbritjet në të dy anët, duke shtuar edhe disa km. rrugë shtesë, por të mendohet po të ketë mundësi për uljen e lartësisë, mundësisht në 800m. mbi nivelin e detit, duke shtuar vetëm 400 deri 500ml. tunel, por duke përmirësuar në mënyrë të ndjeshme cilësinë e rrugës.

Të gjendur para kësaj situate, unë propozoj që të ngrihet një grup pune me specialistë të fushës në përbërje të të cilit të jenë edhe autorët e studimeve gjeologo-inxhinjerike të kryer në kuadrin e përpilimit të projektit teknike të zbatimit të këtyre objekteve dhe mbështetur në këto studime gjeologo-inxhinjerike të caktojnë në vend akset e tuneleve të Qafë Buallit, Gurit të Bardhë e Murrizës dhe aksin ku do të ndërtohet Ura e Vashës.

Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme të komunitetit dibran, e premtimet e qeveritarëve qendrorë e vendorë, ndërtimi i Rrugës së Arbërit u fillua keq. Në vitin 2005, një javë para zgjedhjeve të 3 Korrikut, nga ish kryeministri Nano, për shoë politik u pre një shirit për fillimin gjoja të Rrugës së Arbërit, afër Gurëve të Skënderbeut, kur aksi i rrugës së re të miratuar, duhet të kalonte në krahun tjetër të luginës. Në këtë vend të gabuar 3 vite më vonë qeveria e Berishës, filloi në vitin 2008, ndërtimin e segmentit të Rrugës së Arbërit, "Dalje e Bulqizës-Ura e Cerenecit" që nuk ishte Rruga e Arbërit, por rikonstruksioni i rrugës ekzistuese. Me mangësi e të meta ka vazhduar segmenti në drejtim të Urës së Vashës, duke bërë ndryshime, duke dhënë e hequr fonde sipas dëshirës dhe duke e zgjatur ndërtimin e rrugës për në kalendat greke.

Rruga e Arbërit, u vonua që u vonua, por në rast se shteti ka dëshirë ta vazhdojë ndërtimin e kësaj rruge me parametrat e rrugëve që ndërtohen në ditët e sotme, me organet shtetërore që merren me këto probleme (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve që miraton këto projekte dhe Ministria e Transporteve) të marrë masa për korrigjimin e këtyre mangësive e të vazhdojë ndërtimi i rrugës me parametra të kohës, në rast të kundërt të heqë dorë nga kjo sipërmarrje dhe të lejojë që ndërtimin e rrugës ta marrë përsipër ndonjë kompani private me koncension.

Në rast se nuk do të merren këto masa për korrigjimin e mangësive të vërejtura, brezat nuk do të na e falin ndërtimin e kësaj rruge pa standarde, në një kohë që janë të gjitha mundësitë dhe mjetet për të ndërtuar një rrugë të kohës me standarde europiane. Po të ndërtojmë një rrugë të mirë sot, do të na urojnë brezat nesër, e po të bëjmë një rrugë jo të mirë sot do të na mallkojnë brezat. Le të bashkërendojmë forcat e mendimet që të marrim urimin e brezave.

Dibranët nuk e meritojnë as vonesën në ndërtimin e rrugës dhe as ndërtimin e një rruge jashtë standardeve të kohës.

Tiranë korrik 2013

REFERIMET

Bashkim Lleshi (2003) Raport mbi kushtet gjeologo inxhinjerike dhe gjeoteknike të rrugës Tiranë–Dibër.
(Për studimin e Fizibilitetit) Tiranë 2003.
Bashkim Lleshi (2004) Nuk ka pengesa për financimin e Rrugës së Arbërit. Ka përfunduar Studimi iFizibilitetit.
Gazeta "Dibra" Nr.68, prill 2004
Bashkim Lleshi (2006) Pushtetarë dhe Opozitarë, edhe sa kohë do të vazhdoni të mos e mbani premtimin e dhënë
për ndërtimin e rrugës së re të Dibrës, Rrugës së Arbërit ?Gazeta "Rruga e Arbërit" nr.2, qershor 2006
Bashkim Lleshi (2006) Rruga e Arbërit i shërben edhe zhvillimit më të shpejtë te turizmit malor dhe njohjes së
mëtejshme të historisë. Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 6, tetor 2006
Bashkim Lleshi, Avni Dibra (2007) Rruga e Arbërit premisë për zhvillimin e turizmit. Kuvendi Tekniko Shkencor
për Rrugën e Arbërit. Tiranë Maj 2007
Bashkim Lleshi (2008) Pse lejohet të bëhen ndryshime të aksit të rrugës së Arbërit në dëm të cilësisë së saj.
Gazeta "Rruga e Arbërit" Maj 2008
Bashkim Lleshi (2008) Gjeologjia e Rrugës së Arbërit, libër. Tiranë nëntor 2008

ADRESA E PETICIONIT ONLINE:
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

FINANCIMI PËR RRUGËN E ARBRIT

Kinezët shfaqin interesim për ndërtimin me **koncesion**

Rruga e Arbrit u bë një pikë e rëndësishme e fushatës elektorale të dy kampeve kryesore politike, por në heshtje është pranuar nga dy palët se financimi i saj do të ishte një sforco e madhe për buxhetin e shtetit. Partia Demokratike iu desh të gjente justifikime për mosmbajtjen e premtimeve për rrugën, ndërsa Partia Socialiste premtoi gjatë fushatës së jo vetëm që do ndërtonte rrugën, por se ajo do të ishte një shembull i paparë në standardet e ndërtimit të rrugëve në Shqipëri. Ndërsa opinioni publik i ka parë më shumë pesimizëm premtimet, duke pasur parasysh vështirësitë financiare që po kalon këtë vit buxheti i shtetit.

Por menjëherë pas zgjedhjeve, në faqen zyrtare të Këshillit të Ministrave dhe në faqen e tij personale në Facebook, kryeministri i Shqipërisë Sali Berisha shpalli se "është zgjidhur financimi për ndërtimin e plotë të Rrugës së Arbërit". Ky deklarim i kryeministrit ngjalli një habi në publik, për faktin se kur paska qenë kaq e thjeshtë pse nuk e tha këtë gjatë fushatës elektorale? Megjithatë, kjo është një pyetje që për momentin vetëm ai e di.

Siç njoftoi edhe zyra e Shtypit e Kryeministrit, Berisha e bëri deklaratën e tij pas një takimi që pati me një delegacion të Partisë Komuniste të Kinës, i kryesuar nga Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Europën Lindore dhe Azinë Qendrore, z. Tian Yongxiang. Zyra e Shtypit e Këshillit të Ministrave, mes të tjerash theksoi se "Kryeministri Berisha vlerësoi edhe bashkëpunimin në lidhje me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, si një projekt madhor jo vetëm për vendin por edhe për rajonin. Ai falënderoi kompaninë e madhe Kineze CSCEC (China State Construction Engineering Corp.ltd) dhe qeverinë Kineze për ofertën realisht të leverdishme që kanë bërë para zgjedhjeve për rrugën e Arbrit me zero ndikim ose ndikim të parëndësishëm, sipas variantit mbi borxhin publik".

Ndërsa në faqen e tij personale në FB, Berisha shkruan se "pas mbi një vit tratativash me autoritetet kineze, kompania e ndërtimit nr.1 në Kinë por dhe në botë CSCEC paraqiti një ofertë për ndërtimin e plotë të 27 km të rrugës së Arbrit që kanë mbetur pa ndërtuar përfshirë këtu tunelin e Qafë Murrizit dhe Urën e Vashës. Kompania do bëjë vetë financimin e plotë (koncension) ose të pjesshëm të ndërtimit të rrugës me një kredi që qeveria kineze i akordon asaj për këtë vepër. Sipas një opsioni tjetër, qeveria shqiptare mund të bëhet bashkëfinancuese me shumën 70 milionë Euro".

Zyra e Shtypit e Kryeministrit dhe vetë Berisha në faqen e tij në FB nuk kanë dhënë më shumë të dhëna lidhur me financimin e rrugës. Një burim nga Dhoma e Tregtisë në Tiranë i tha korrespondentit të gazetës, se në "fund të tetorit 2009 në Tiranë, në kuadrin e Forumit Ekonomik të Biznesit Kinë – Shqipëri, ka pasur një interesim të biznesit kinez për investime në Shqipëri. Në këtë forum, tha ai, kanë qenë përfaqësues të më shumë se 70 bizneseve kineze të industrisë së energjetikës, minierave, metalurgjisë, ndërtimit dhe mes të tjerash, bizneset kineze kanë shfaqur interes për investime në Shqipëri. Në këtë forum ekonomik ka marrë pjesë edhe Kryeministri Berisha dhe Zhang Dejiang, zëvendës kryeministri i Republikës Popullore të Kinës". Po ashtu, thekson burimi, në një vit më parë, në Maj 2012, në Tiranë është zhvilluar Forumi Ekonomik Shqipëri-Kinë, me pjesëmarrjen e drejtuesve të 67 sipërmarrjeve kineze të Bashkisë së Nanjing-ut, por për financime konkrete për Rrugën e Arbrit nuk është folur".

Sidoqoftë, në qoftë se oferta kineze ekziston, i mbetet qeverisë së re që do formohet në shtator të vendosë për procesin e mëtejshëm. Sipas ligjit, duhet një tender i hapur ndërkombëtar në këtë rast dhe firma kineze futet në këtë tender më një bonus, si rezultat i interesimit të saj paraprak.

BUJAR KAROSHI

Rruga e Arbrit do të kontribuojë në unitetin tonë kombëtar

Mjaft qytetarë që kanë firmosur peticionin për rrugën e Arbërit, kanë nënshkruar edhe mendimet e tyre se pse ndërtimi i saj është i rëndësishëm për ta. Opinionet janë të hapura në faqen e web "change.org" dhe shumë prej tyre janë në gjuhën angleze. Opinionet do të bëhen publike numër pas numri, duke mbledhur kështu argumentet që do të botohen në një botim të posaçëm, që do t'i bashkëngjitet peticionit.

Redaksia nuk boton opinionet e shprehura në faqen e FB të gazetës apo rrjetet e tjera sociale, përveç rasteve kur ato përcillen me email për botim në adresën e gazetës.

Redaksia do të mirëpresë në vazhdim edhe opinione e studime specialistësh, me argumente të tjera "pro" ndërtimit të rrugës dhe avantazhet që ajo sjell për ekonominë kombëtare.



Foto © B Karoshi.

Ilirian Laci, GURË-LURË, ALBANIA: Rruga e Arbrit do ti japë zhvillim gjithë Dibrës dhe krahinave të saj prandaj është shumë e domosdoshme për ne dibranët

Tani Gurra, OSLO, NORWAY: Sepse unë vij nga Dibra dhe çdo vit e përshkoj atë rrugë

Bukurije Gashi, GOSTIVAR, MACEDONIA: Për shkak se shkurtohet shumë rruga për në Tiranë

Zylfi Skepi, TIRANE, ALBANIA: Është mënyra më e mirë për të vizituar familjen.

Qazim Perkola, PESHKOPI, ALBANIA: Do ishte një kryevepër nëse arrihet që të bëhet kjo rrugë që është nisur

Ilirjan Doda, TIRANE, ALBANIA: Sepse mund të shkoj në vendlindjen time përditë, tani më merr 5 orë për të shkuar.

Hafiz Perzhilla, WALTHAMSTOW, UNITED KINGDOM: Është e rëndësishme për shqiptarët.

Alkida Thana, TIRANË, ALBANIA: Origjina ime është në Dibër!

Edmond Reçi, TIRANE, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra dhe kam interes për këtë rrugë që lidh kryeqytetin me lindjen e vendit.

Kladiola Dervishi, TIRANE, ALBANIA: Që të jem shqiptaro-europian krenar.

Liridona Raza, PESHKOPI, ALBANIA: Është lidhja kryesore mes qytetit tonë dhe kryeqytetit të Shqipërisë, Tiranës.

Andrin Trupja, PESHKOPI, ALBANIA: Për çdo gjë

Semie Manjani, TIRANE, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua sepse kam shtëpinë e vjetër në Shupenzë. Faleminderit.

Burim Kaziu, DIBER, MACEDONIA: Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbrit - shpresën e krahinës së Dibrës.

Kujtim Begaj, STATEN ISLAND, NY: Vizitë në vendlindjen Dibër dhe mëmëdheun Shqipëri

Ramiz Lushaj, TIRANË, ALBANIA: Mos përfundimi i Rrugës së Arbrit është antikombëtarizëm, prosllavizëm, shkombëtarizim.

Robert Kosova, DURRËS, ALBANIA: Sepse është i rëndësishëm për dibranet.

Fatmir Dernova, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbrit është jetike për popullsinë e Dibrës

Anisa Basha, TIRANË, ALBANIA: Sepse Shqipëria vërtet duhet të RILINDË

Gerald Xhafa, BULQIZË, ALBANIA: Sepse është një rrugë e rëndësishme.

Eranda Cenga, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse tani për tani është rruga më e keqe në gjithë Shqipërinë.

Ylber Kurti, STOCKHOLM, SËDEN: Shumë me rëndësi sepse unë jam lindur e rritur në Dibër dhe e di që ne ishim/jemi të izoluar për shkak të rrugës. Unë dua të shkoj më shpejt në kryeqytet, plazh familjar apo të shes të mbjellat e mia që po më kalben për arsye të transportit.

Aldo Tibiej, TIRANA, ALBANIA: Sepse arrijmë më shpejt të kursejmë më shumë.

Aldo Nelollari, TIRANA, ALBANIA: Sepse arrijmë më shpejt kursejmë më shumë.

Fatjona Hysenaj, PESHKOPI, ALBANIA: Mendoj se është e nevojshme dhe e domosdoshme. Duhet bërë për shumë arsye

Alkena Murati, TIRANA, ALBANIA: Kursen kohë, jeton më mirë.

Ndricim Strazimiri, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse dua të shkoj në Peshkopi për një kohë të shkurtër.

Enkela Elezi, PESHKOPI, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për sigurinë tonë.

Rubin Zollumi, PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi i Rrugës së Arbrit do të ishte një mrekulli për Dibrën, e cila do të sillte shumë të mira për Dibrën dhe gjithë pjesën veriore të Shqipërisë. Po ashtu dhe do ndihmonte shkëmbimin e mallrave midis dy shteteve kufitare Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë pas 23 qershorit.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Dëshirojmë të theksojmë përsëri se peticioni nuk përfundon më 23 qershor; ky peticion do të mbyllet vetëm kur të inaugurohet rruga Tiranë-Dibër.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!



Foto © B Karoshi.

Kjo rrugë do i sjellë shqiptarët më afër dhe do të kontribuojë në unitetin tonë kombëtar
Adri Nurellari, TIRANA, ALBANIA

Çfarë është e rëndësishme për atdheun tim, është e rëndësishme edhe për mua.
Aried Dida, DURRËS, ALBANIA

Sepse është një gjë shumë e mirë për banorët e zonës dhe për ekonominë.
Ditjon Murati, TIRANA, ALBANIA

Anderjon Nazifi, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra

Lubjana Karasani, PESHKOPI, ALBANIA: Së pari, një rrugë brenda standardeve do të ishte më e sigurt për lëvizjen e njerëzve. Së dyti, që është me rëndësi jo vetëm për ne dibranët por dhe për krahinat e tjera; lidhja me Maqedoninë, shkëmbimi i mallrave import-eksporti do të ishin në të mirë të të gjithë shqiptareve. Së treti do të na jepte ne dibranëve mundësinë për të qenë të lidhur me pjesën tjetër të vendit, duke zhvilluar ekonominë dhe rritur standardin e jetesës.

Ferizat Haxhirexha, DIBER, MACEDONIA: Sepse kjo rrugë do të shkurtojë largësinë mes Tiranës dhe gjithë shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni.

Engjell Kurti, BULQIZA, ALBANIA: Sepse mund të nxisë zhvillimin ekonomik të vendit.

Ina Cami, BULQIZË, ALBANIA: sepse shkojmë me shpejt në distinacionin që duam

Arbi Bulku, TIRANE, ALBANIA: Sepse është vendlindja ime.

Dhurata Thanasi, TIRANA, ALBANIA: Për zhvillimin e njërës prej krahinave më të rëndësishme për sa i përket, historisë, ekonomisë dhe burimeve njerëzore të Shqipërisë. Dibranët e meritojnë kaherë të jetojnë njerëzishëm.

Namik Mehmeti, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Peshkopia

Melihate Etemi, TETOVE, MACEDONIA: Për shumë arsye, më e rëndësishmja për shkak të bashkimit tonë.

Alket Arapaj, TIRANA, ALBANIA: Të kompletohet e gjithë Shqipëria me rrugë dhe të përfitojmë mirësitë e kësaj rrugë që shkurtohet goxha

Ismije Saiti, TETOVO, MACEDONIA: Për t'i dhënë shtytje ekonomisë

Fidan Limani, KUMANOVO, MACEDONIA: Do të doja të shikoja njerëzit e asaj krahine që të kishin një infrastrukturë ndërlidhëse më të mirë.

Rik Ndreu, LONDON, UNITED KINGDOM: Është shumë me rëndësi për zhvillimin e zonës dhe shkurtimin e kohës. Të ndërtohet sa më shpejt.

Kodra Endrit, TIRANA, ITALY: Si çdo Dibran jashtë dhe brenda vendit edhe unë dua me gjithë zemër që rruga e Arbrit të ndërtohet sa më shpejt dhe me standarde europiane...

Lejdi Prifti, FIER, ALBANIA: Është vërtetë e rëndësishme që një projekt madhor siç është rruga e Arbërit të përfundohet. Ajo do të afrojë akoma dhe më tepër shqiptarët me njëri-tjetrin.

Bekim C, NUTLEY, NJ: Është një rrugë historike domethënëse. Zhvillimi i saj do të sjellë zhvillimin e arterieve infrastrukturore të të gjithë rajonit.

Albert Maqellara, DEBAR, MACEDONIA: Është e vetmja zgjidhje dhe shpresë për ne, qytetarët e Dibrës, për zhvillim.

Izer Maksuti, TETOVO, MACEDONIA: I afron më shumë shqiptarët!

Neri Koltraka, TIRANA, ALBANIA: E rëndësishme së pari që këto qeveri të mos luajnë me Dibranet, porse duhet t'i konsiderojnë si një ajkë e mendimit në Shqipëri... Dibra është krahinë me historik të pasur dhe një e tashmë e varfëruar, rruga patjetër që do ta integrojë në lobin e metropolit dhe Dibranet do dinë ta tregojnë veten. Arsye ekonomike për Dibranet dhe Turistike për Shqipërinë.

Adri Nurellari, TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë do i sjellë shqiptarët më afër dhe do të kontribuojë në unitetin tonë kombëtar

Visar Cibaku, PESHK, ALBANIA: Të bëhet rruga Arbrit për një të ardhme më të mirë për banorët e Dibrës.

Mustaf Jonuzi, TETOVË, MACEDONIA: Rrugët e reja janë të rëndësishme jo vetëm për mua por për gjithkë në botë.

Erzen Disha, DEBAR, MACEDONIA: Sepse është vendlindja ime.

Sander Fisniku, TIRANA, ALBANIA: pse është e rëndësishme? Shumë e thjeshtë, që të jemi më afër me njerëzit tanë që jetojnë dhe veprojnë në Dibër.

Lejdi Prifti, FIER, ALBANIA: Shqipëria ka nevojë për këtë rrugë.

Albjol Meça, TIRANA, ALBANIA: Jam nga Klosi, dhe me rrugën e Arbrit do të arrij më shpejt në Tiranë.

Bajram Rexhepi, TETOVO, MACEDONIA: Udhëtoj shpesh për Tiranë.

Mali Deda, BRISTOL, UNITED KINGDOM: Rëndësi kombëtare dhe ekonomike.

Nexhmedin Avdiu, SKOPJE, MACEDONIA: Arsye ekonomike.

SAMET HAMZAI, BRONZOLO, ITALY: Shpresoj një ditë e më parë të përfundojë

Odeta Drici, TIRANA, ALBANIA: Shumë e rëndësishme.

Rexhep LATIFI, BRUXELLES, BELGIUM: Jemi një grup bashkatdhetarësh me qëndrim të përkohshëm në Belgjikë Bruksel jemi nga Kumanova dhe dëshirojmë që Rruga e Arbrit të vazhdojë në përfundim sa më parë e përshëndesim Presidencën, Qeverinë, Parlamentin dhe gjithë populli Shqiptar për akte të mëdha shumë Kombëtare...

Kaloshi Pëllumb, PERUGIA, ITALY: Rruga e Arbrit nuk është vetëm për Dibrënpor për gjithë Shqipërinë... Është rrugë që lidh shqiptarët e Maqedonisë me Tiranën... është e nevojshme për transportin publik... për bizneset për investime për bujqësinë për blegtorinë... se Dibra i ka këto e me rrugën do rriteshin akoma për të furnizuar TIRANËN...Boll me rrenat e politikanëve... por të nisë puna seriozisht për mbarimin e saj sa më shpejt dhe me standarde europiane...e jo me 2 fadroma, 2 kamiona e 10 punëtore... sa për të nxjerrë foto e video...që gjoja po punohet në Rrugën e Arbrit.....

Mersel Sadiku, GOSTIVAR, MACEDONIA: Komunikim më të mirë.

Ariola Beqiri, TIRANË, ALBANIA: Të ndihemi krenarë për Dibrën!

Fisnik Mela, DEBAR, MACEDONIA: Ëndrra jonë.

Kujtim Sulejmani, GOSTIVAR, MACEDONIA: Është e rëndësishme, gjatësia e rrugës do të jetë sa 1/3 e rrugës ekzistuese për Tiranë.

Jeton Dauti, KËRÇOVA, SËITZERLAND: Sepse shkurtohet rruga për në Shqipëri dhe jep një mundësi të re ekonomike për rajonet e pazhvilluare si Dibra dhe Kërçova.

Ardonit Ismaili, TETOVA, ALBANIA: Shkurtesa e largësisë Tetovë-Tiranë

Erenis Ramadani, TETOVO, MACEDONIA: Çdo gjë që bashkon shqiptarët është e rëndësishme për mua.

Dan Disha, CAMP BONDSTEEL, MACEDONIA: Do të jetë një lidhje shumë e rëndësishme tregtarë dhe shpirtërore mes shqiptarëve të ndarë në të dy anët e kufirit.

Arbër Keshi, DIBRA, ALBANIA: Ndërtimi i Rrugës së Arbrit është shumë e rëndësishme...

Kastriot Osmani, KUMANOVO, MACEDONIA: Sepse duan gjithë Shqiptarët që të ndërtohet.

Almir Dauti, GOSTIVAR, MACEDONIA: Për udhëtim.

Arbër Ademi, STRUGA, MACEDONIA: për një rrugë sa më të shpejtë

Besnik Ademi, TETOVO, MACEDONIA: Po e nënshkruaj këtë peticion për shkak të perspektivës ekonomike të kësaj rruge. Mendoj që është shumë e rëndësishme që kjo rrugë të ndërtohet për arsye ekonomike, sociale, kulturore etj.

Bashkim Idrizi, TETOVO, MACEDONIA: Do të shkurtojë shumë kohë për të shkuar në Shqipëri.

Sabri Saliu, GOSTIVAR, MACEDONIA: Është e një rëndësie madhore për shumë arsye; e para do ndryshojë dhe zhvillojë dukshëm këtë zonë e cila prej shumë vitesh është e braktisur në kuptimin e mos investimeve infrastrukturore do jetë edhe një rrugë e 2 e kombit për ne shqiptarët e pjesës shqiptare në Maqedoni. Do sjellë zhvillim ekonomik do mundësojë shkurtimin e distancave ndërmjet shqiptarëve thjesht e domosdoshme për shqiptarinë. Ju përgëzoj për këtë vepër. Dashtë Zoti të përfundojë sa më shpejt me një urim për vazhdueshmërinë e rrugëve që do të lidhin shqiptarët e ndare.

Sabit Xhaferri, TETOVO, MACEDONIA: Përkrahje për ndërtimin e Rrugës së Arbrit

Arif Selami, TETOVO, MACEDONIA: Është pjesa e fundit e Shqipërisë që duhet të lidhet me pjesën tjetër në mënyrë më të drejtë.

Bajram Curri, SKOPJE, MACEDONIA: Jeta do të ishte ndryshe, dhe ndoshta me shume probleme, pa këto gjëra. Por infrastruktura ka më shumë rëndësi sesa thjesht përmirësimi i jetës së përditshme.

Genta Fortuzi, ALBANIA: Afron shqiptarët me njëri tjetrin dhe do sjellë rritje ekonomike

Mergim Reci, MACEDONIA: Është me rëndësi strategjike.

Edvin Zeqja, ITALY: Shton komunikimin me shqiptarët e Maqedonisë

Ruzhdi Matoshi, TETOVO, MACEDONIA: Po është patjetër të lidhen tokat tona?

Jetmir Bajrami, GOSTIVAR, MACEDONIA: Rrugët bashkojnë, bashkimi bën fuqi ...

Edian Mece, TIRANA, ALBANIA: Ndihmon zhvillimin e rajonit Veri-Lindor të vendit. Mund të nxisë shumë zhvillimin e ekonomisë lokale.

Admir Hylviu, KAVAJË, ALBANIA: Pasi ripërmasimi i raportit qendër-periferi lokale do krijonte hapësira të reja komunikimi e do mundësonte rinjohjen (e munguar) ndërshqiptare.

Fatmir Xheleshi, BULQIZË, ALBANIA: E meriton

Ditjon Murati, TIRANA, ALBANIA: Sepse është një gjë shumë e mirë për banorët e zonës dhe për ekonominë

Muhamet HAXHIYMERI, PESHKOPI, ALBANIA: Ka ardhur koha që si në çdo qytet të Shqipërisë dhe Peshkopisë me rrethinat e saja t'i shtohet ajo rrugë e shumë pritur. Nuk kanë pse dibranet të sorollaten 3 orë e 30 min për të vajtur në Tiranë duke qenë se ajo mund të bëhet për vetëm një orë e gjysmë pra na duhet ajo rrugë jo vetëm për këtë gjë, por dhe për zhvillimin e turizmit të gjelbër gjë për të cilën Dibrës nuk i mungojnë resurset. Apo dhe turizmin dimëror që në dimër do të mund të bëhej më mirë se në çdo vend tjetër të Shqipërisë apo dhe do t'u jepte mundësinë shqiptarëve që të kishin më afër një pikë shumë të vizituar siç është Mavrova. Pastaj dhe për zhvillimin e ekonomisë ku dihet se Dibra ka pasuri shumë të mëdha gipsi të cilat mund të shfrytëzohen dhe rruga do t'i jepte më shumë treg-shitje ashtu si dhe produkteve të bujqësisë Dibrave ku duhen veçuar kumbullat, mollët, patatet apo dhe misri dhe gruri, e shumë gjëra të tjera që Dibra i ka traditë. Uroj që diçka e tillë të realizohet sa më shpejt... Është domosdoshmëri.

Aried Dida, DURRES, ALBANIA: Çfarë është e rëndësishme për atdheun tim, është e rëndësishme edhe për mua.

Armand Mani, TIRANE, ALBANIA: Do të kursejë kohë, shpenzime udhëtimi, siguri dhe më e rëndësishmja do të lidhë shkurt Tiranën me qytetin e Ohrit në Maqedoni.

Endrit Kasemi, TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua dhe për njerëzit që jetojnë aty që të kenë një jetë normale në shek. e 21. Mos pyesni për rëndësinë, vetëm ndërtojeni.

Fatbardh Cena, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse jemi vendi me infrastrukturën më të dobët në vend

Zoltan Zakota, ORADEA, ROMANIA: Dua të udhëtoj më shpesh në atë rajon.

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

SHËNIM I REDAKSISË: Komentet janë të pacensuruara. Redaksia ka ndërhyrë në komente vetëm për korrigjime drejtshkrimore. Gjithashtu, në këtë përmbledhje janë përfshira vetëm komentet e shënuara në faqen e peticionit në change.org.

Myfit Duriçi: *Jam kryetar i të gjithëve, jo vetëm i socialistëve*



Në bashkinë Bulqizë është mandatuar kryetari i ri i kësaj bashkie, i dalë nga zgjedhjet e pjesshme të 23 qershorit. Siç dhe është bërë me dije, për banorët e këtij qyteti ka patur dy votime më 23 qershor, ku veç zgjedhjeve të përgjithshme u zhvilluan edhe ata lokale për kryetar të bashkisë, pasi ish kryetari i kësaj bashkie, Roland Keta dha dorëheqje duke kandiduar për deputet të PD-së në qarkun e Dibrës.

Kështu sot në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak Bulqizë, është zhvilluar mbledhja e këtij këshilli, ku është bërë konstituimi i marrjes së mandatit të kryetarit të ri të Bashkisë Bulqizë, zotit Myfit Duriçi, i cili konkuroi dhe fitoi për PS-në në zgjedhjet e 23 qershorit. Mori pjesë në këtë ceremoni Prefekti i Qarkut të Dibrës, Genci Sharku, si dhe deputeti i sapozgjedhur më 23 qershor i këtij qarku, Shkëlqim Cani. Pas betimit të kryetarit të ri, u bë akti formal i firmosjes së kalimit të postit të kryetarit të bështkisë nga kryetari në detyrë Arian Tollja tek kryetari i zgjedhur me votën e 23 qershorit, Myfit Duriçi.

Me këtë rast në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i bashkisë, Myfit Duriçi, pasi falenderoi banorët e Bulqizës për kulturën qytetare që treguan në zgjedhjet e 23 qershorit, premtoi se do të bëjë gjithçka për të plotësuar të gjitha premtimet e dhëna gjatë fushatës elektorale, për të ndryshuar pozitivisht Bulqizën dhe jetën e banorëve të saj.

Unë, vijoi në fjalën e tij, kryebashkiaku Duriçi, nuk do jem kryetar vetëm i socialistëve, por i të gjithë banorëve, ndaj le të bëhemi të gjithë bashkë për ta ndryshuar për mirë qytetin tonë të dashur që është lënë pas dore deri më tani. Le të bëhemi pra të gjithë së bashku, e përfundoi mesazhin e tij për banorët, kryebashkiaku i ri i Bulqizës, Myfit Duriçi, për ta nxjerrë Bulqizën nga shkatërrimi ku është zhytur.

Por ndërkohë, pak ditë pas marrjes së detyrës, kryetari i ri i Bashkisë së Bulqizës është akuzuar nga ish –kryetari dhe tani Deputet në parlamentin shqiptar, Roland Keta, se "ka larguar nga puna shumicën e punonjësve të administratës së mëparshme".

"Largimi i 6 punonjësve të kësaj bashkie është bërë pasi ata kanë dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga detyra", ka pohuar për gazetën Duriçi. "Përsa u përket 4 punonjësve të tjerë sqarojmë se largimi i tyre nga puna është bërë sepse nuk kishin arsimin e duhur për të patur ato vende pune. Zëvendësimi i tyre është bërë me persona me arsimin përkatës, sipas profilit të vendit të punës. Të gjitha këta lëvizje ishin të detyruara dhe jo në shkelje të ligjit siç pretendon ish kryetari i bashkisë" - deklaron kryetari i Bulqizës.

Kryetari i ri i Bashkisë ka theksuar se pas marrjes së detyrës ka konstatuar shumë shkelje ligjore dhe abuzime në bashkinë e Bulqizës dhe për të gjitha këto shkelje, ne do ti drejtohemi organit të akuzës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të zbardhur abuzimet në këtë njësi vendore".

H.Likdisha/ H.Pasha

BULQIZË, SHKARKOHEN DREJTUESIT E MINIERËS

Federata e sindikatave: *Morën ndëshkimin e merituar*

Balfin Grup, që aktualisht administron minierën e Bulqizës pas dështimit të Albanian Chrome ACR, ka shkarkuar nga detyra drejtuesit lokalë të kësaj miniere, drejtorin Medat Zogu dhe kryeinxhinierin Fadil Cani. Burime nga kjo minierë, pasi konfirmojnë këto shkarkime, bëjnë me dije se në vend të tyre janë emëruar, Edmond Xhafa dhe Bardhul Rama.

Sipas këtyre burimeve nuk bëhet i qartë zyrtarisht motivi i këtyre shkarkimeve, gjë që çon në komente e hamendësime të ndryshme për ta.

Kështu në masën e minatorëve, këto shkarkime i lidhin me aksidentin e fundit të ndodhur në minierë ku humbi jetën në nivelin e 5-të të pusit nr.1. 50 vjeçari, Bujar Suroçi, i cili ra nga ashensori i vagonave. Ky aksident i rëndë tragjik u shoqërua me arrestimin nga ana e policisë të tre punonjësve të kësaj miniere me akuzën për shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë.



Ndërkohë kryetari i Federatës së Sindikatave të Industrisë së Shqipërisë, Taf Koleci, i kontaktuar me telefon nga për këtë problem, thotë se zyrtarisht shkarkimi ka ardhur si pasojë e performancës së ulët që këta drejtues kanë treguar këto kohët e fundit në administrimin e minierës, sidomos në realizimin e planit të prodhimit të mineralit që ka rënë në kuota shumë të ulta.

Por, veç kësaj padyshim që shkarkimi i tyre lidhet edhe me aksidentet e ndodhura këto kohët e fundit në minierë.

Këta drejtues, vijon Koleci, prej kohësh kishin humbur të bënin edhe organizimin e vogël të punës në minierë, duke pretenduar se merren me punë "të mëdha".

Pikërisht kjo neglizhencë e tyre, në organizimin e vogël të punës, solli edhe aksidentin tragjik të ndodhur pak ditë më parë ku humbi jetën, Bujar Suroçi, gjë për të cilën këta drejtues mbajnë përgjegjësi.

Ndaj dhe shkarkimi i tyre është plotësisht një ndëshkim i merituar për ta e mbyll fjalën e tij kryesindikalisti Koleci.

H.L

200 punonjës të hec-ve Ulëz dhe Shkopet, *3 muaj pa marrë pagat*

Duket se nxitimi i qeverisë në ikje për privatizimin e dy hidrocentraleve mbi lumin e Matit, Ulëz dhe Shkopet, ka rezultuar jo efiçent. Efektet negative të këtij privatizimi, I cili u kundërshtua me protesta të punonjësve të këtyre hidrocentraleve, janë provuar shumë shpejt. Janë pikërisht rreth 200 punonjësit e këtyre hidrocentraleve, që I druheshin këtij privatizimi, ata që po ndeshen me pasojat negative të tij, pasi prej 3 muajsh nuk kanë mundur të marrin pagat me të cilat siç dhe shprehen vetë ata mbajnë me bukë familjet e tyre. Atyre në momentin e privatizimit, u ishte premtuar nga firma turke "KURUM", që punonjësit nuk do hiqen nga puna dhe se rrogat do të kalojnë për ta në afatin e caktuar. Por, një gjë e tillë nuk ka ndodhur pasi prej tre muajsh punonjësit nuk kanë marrë pagat.

Specialistët e këtyre hidrocentraleve, thonë për "Rruga e Arbërit", se firma "KURUM" e cila ka fituar tenderin për administrimin e këtyre hidrocentraleve, nuk ka mbajtur asnjë premtim konform kontratës së nënshkruar, përfshirë edhe atë të mospagimit të punonjësve prej 3 muajsh.

Në të tilla kushte punonjësit kërkojnë nga shteti që të marrë masa, si për kalimin e rrogave të tyre me të cilat ata ushqejnë veten dhe fëmijët, ashtu edhe për plotësimin e kushteve të nënshkruara në kontratë për nisjen e investimeve, ku deri më tani nuk vërehet asnjë lëvizje në këtë drejtim.

Ne i bejme thirrje kryeministrit në detyrë dhe atij në pritshmëri, thonë punonjësit, që ta vlerësojnë këtë problem. Kjo edhe për faktin se HEC-et e Ulzës dhe Shkopetit, ndodhen në tokat tona ku ne nuk jemi dëmshpërblyer për përmbytjen e tyre.

Ndërkohë 200 punonjësit e këtyre hidrocentraleve, tepër të revoltuar për mos marrjen e pagave prej 3 muajsh, kërcënojnë se do bllokojnë punën normale në këto dy HEC-e.

H.L.

Ndërtohet xhami e re në Limjan, me kontributin familjar të Musa Riçkut

Xhamia është shkollë



Xhamia e vjetër e ndërtuar në vitin 1724, rreth 300 vjet më parë e me mure prej qerpiçi, po shembej. Ajo ishte ndërtuar mbi themelet e një xhamie akoma më të vjetër e që tani mund të numëronte 400 vjet.



Në foto: Familja e Musa Riçkut. Nga e majta në të djathtë: Klodiani, Hasija, Musai, Nimeti dhe Erjoni.

Nga **AHMET ÇAUSHI**
Myftinia Dibër

Më 7 korrik 2013, në prani të banorëve të fshatit Limjan, burra e gra, të rinj e të reja dhe fëmijë, në një atmosferë të plotë festive, bënë përurimin e xhamisë së re. Ndërtimi i saj filloi vetëm një muaj më parë. Kishte kohë që imami i fshatit, Mexhid Shehu, kishte trokitur në dyer shoqatash që ndërtojnë xhami. Për arsye të ndryshme nuk qe pranuar kërkesa e tij. Xhamia e vjetër e ndërtuar në vitin 1724, rreth 300 vjet më parë e me mure prej qerpiçi (plita), po shembej. Ajo ishte ndërtuar mbi themelet e një xhamie akoma më të vjetër e që tani mund të numëronte 400 vjet.

Musa Riçku, ish banor i këtij fshati dhe tani banor i Tiranës, bën një vizitë në fshat. Kur sheh xhaminë në gjendje shembjeje, i duket sikur tërë fshati po rrëzohej, andaj bisedon me imamin e i premton ndërtimin e një xhamie të re. Po në atë vend shumë shpejt nis puna. Dërgon një grup specialistësh, të cilët shembin muret e vjetra, nis gërmimi i themeleve të reja për xhaminë e re. Pa u mbushur muaji, më 7 korrik 2013, dy ditë para fillimit të agjërimit të Ramazanit, u inagurua xhamia e re. Musai gjatë gjithë muajit jetoi në fshatin e tij për të ndjekur punimet. Ai shijoi ëmbëlsinë e ujit të ftohtë, të hijeve të freskëta dhe të muhabetit e respektit me tërë fshatarët. Në mjediset e jashtme të xhamisë që në mëngjes filloi festa. Gëzonte i tërë fshati. Lodra, që dikur kishte thirrur e mbledhur banorë e miq të fshatit për dasma, lodra, që dikur kishte mbledhur banorët e fshatit për t'i dalë zot vendit të tyre e për pajtim gjaqesh, lodra, që i kishte lajmëruar këto malësorë për t'u ngritur në syfyr apo për mbarimin e kohës së agjërimit, atë ditë i thirrte në festën mbarë popullore, në festën e përurimit të xhamisë së re, të cilën e ndërtonte banori i këtij fshati, Musa Riçku. Sheshi u mbush shumë shpejt. Të tërë ishin të gëzuar, buzëqeshnin e uronin me gjithë zemër: "Gëzuar xhaminë e re!", kurse Musait i thonin "Faleminderit!", "Zoti të shpërbleftë!".

Xhamia e re në atë shesh të rrethuar me gjelbërim e të mbushur me banorët e fshatit dhe musafirë të shumtë nga Tirana, Gostivari e fshatrat përreth, rrezatonte dritë, kënaqësi e krenari dhe, i ftonte e do të ftonte brezat në të ardhmen për dije, për punë të mira e të dobishme, thërriste për bashkëjetesë, respekt e ndihmë për njëri-tjetrin. Të tërë ishin të gëzuar, u qeshnin sytë dhe pamja e tyre e gëzuar pasqyrohej në mure dhe në brendësinë e xhamisë, e cila ua kthente kënaqësinë përsëri në zemrat e tyre. Tani xhamia e re e zbukuron më tej sheshin, i cili freskohet me ujin e kulluar që udhëton nga rrafshet e



Mesazhi im është: Vazhdoni traditën, mësoni fëmijët me dije fetare Islame, se kështu do t'i bëni të lumtur fëmijët dhe veten tuaj! Këto mësime do te krijojnë bindje te brezat e rinj për të vazhduar shkollat, për të marrë dije pa kufij dhe për të qenë njerëz të mirë".

Korabit për t'u dhënë shëndet e begati këtyre banorëve, që kurrë nuk janë ndarë nga rruga e Zotit, që edhe xhaminë e teqen i ruajtën si sytë e ballit. Puna e kujdesshme dhe materialet cilësore të përdorura për ndërtim, shtojnë më tej kureshtjen e çdo njeriu që futet brenda në ambientet e xhamisë. Ajo është e bollshme, vendi i grave është i ndarë, ndërsa tavani dhe dyshemeja janë të shtruara me dërrasë pishe- zonjë e këtyre maleve, u zgjeron mushkëritë e u jep kënaqësi të veçantë atyre që kryejnë shërbesat fetare dhe bëjnë vizita në këtë xhami.

Pas përurimit, ku përshëndetën imami i fshatit Mexhid Shehu e kuadro të tjerë fetarë, përgëzoi në emër të familjes Musa Rriçku, i cili nuk la pa përmendur një mesazh të fuqishëm: "Në këtë fshat ka patur një mejtep, ku tërë fëmijët e fshatit mësonin për fenë Islame, për moralin Islam, për edukatën Islame e, prandaj, banorët e fshatit shquheshin për një bashkëjetesë shembullore në fshat e më tej. Mejtepi drejtohej nga imami. Xhamia ishte shkolla. Atje është mësuar edhe alfabeti shqip e janë marrë njohuri të tjera. Mesazhi im -tha Musai, është: Vazhdoni traditën, mësoni fëmijët me dije fetare Islame, se kështu do t'i bëni të lumtur fëmijët dhe veten tuaj! Këto mësime do te krijojnë bindje te brezat e rinj për të vazhduar shkollat, për të marrë dije pa kufij dhe për të qenë njerëz të mirë".

Pas përurimit festa vazhdoi në shtëpinë e Musait, ishin të mbushura disa dhoma me burra dhe të tjera me gra. Në konak u diskutuan probleme fetare për agjërimin, zekatin dhe, në veçanti, sadekanë rrjedhëse, ku profeti sjell mesazhin e fuqishëm "Ai që mbjell një pemë, ndërton një çezmë, hap një rrugë të re për lëvizjen e lirshme të njerëzve, kush le një fëmijë të edukuar mirë, apo një libër të vlefshëm, shpërblimi i Allahut për atë njeri vazhdon në këtë jetë e në jetën tjetër, vazhdon të rritet sa kohë që këto vepra u shërbejnë njerëzve dhe tërë qenieve të gjalla". Fshati pritet të gëzojë edhe hapjen e dy rrugëve të reja që hyjnë në këtë fshat, për t'u sjellë banorëve lehtësi e mirësi.

Në konak u bisedua edhe për të kaluarën, si për imamët: Sheh Musa, Sheh Ismaili, Sheh Shabani, Hajriu, Ibrahimi, Rexhepi, Zabiti, Besniku etj., të cilët shërbyen në fshatrat e Çidhnës, Fushë Alies, Sllovës, Kastriotit etj., shumë të respektuar nga i gjithë populli, që dhanë kontribut të çmuar për bashkëjetesën, për pajtim gjaqesh, për arsimimin e fëmijëve, për luftën kundër të keqes. Edhe në periudha kur nuk kishte shtet, fjala e tyre ishte udhëheqëse në jetë e popullit dibran.

Xhamia e re e Limjanit është e pesëdhjeta e ndërtuar në 17 vitet e fundit. Thuajse të gjitha xhamitë janë ndërtuar me kontributin e popullit dibran. Pas pak ditësh do të përurohet edhe një tjetër xhami e re në fshatin Kandërr. Ajo është filluar para 10 vjetësh. Për suvatimin, ndërtimin e mjediseve të tjera, çatinë e të tjera, kontribuoi Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, e drejtuar nga dr. Ramiz Zeka. Tokën e kësaj xhamie e dhuroi ish kryetari i shoqatës së Muslimanëve të Amerikës, Abdulla Kaloshi – dikur banor i fshatit të Kandrrit.

Musa Rriçku lindi e u rrit në fshatin Limjan. Gjatë tranzicionit u mor me biznes. Kontributi i tij ka qenë i gjithanshëm. Disa vjet më parë, në Laprakë, një sallë të madhe të tijën e ktheu në xhami për të falur namazin e xhumasë dhe kështu vazhdon. Ai shprehu dëshirën dhe vullnetin për të ndërtuar një xhami të re në Laprakë të Tiranës. Pasi u bisedua me kryetarin e KMSH-së, zotni Selim Muça, për xhaminë e re e, u miratua, u sigurua edhe leja nga bashkia nëpërmjet deputetit Sadri Abazi, Musai vendosi ta ndërtojë këtë xhami. Mungesa e vendit dhe pamundësia për ta siguruar atë e bënë të pamundur ndërtimin e xhamisë në Laprakë. Kjo ndihmë kishte qenë kismet i fshatit të tij, Limjanit. Në sheshin në mes të fshatit ngrihet kjo xhami e bukur, e pastër dhe shumë e dëshiruar për fshatarët.

Kontributi qe i tërë familjes së Musait, Hasijes dhe djemve të tyre. Ky nuk është kontributi i vetëm i Musait dhe i familjes së tij. Ata kanë kontribuar për të ndihmuar të varfër, për gazetën "Rruga e Arbrit" dhe shoqatën e Intelektualëve Dibranë në Tiranë, që me përkushtim pasqyrojnë vlerat e popullit dibran në histori si: besa, ndershmëria, guximi, atdhedashuria, trimëria, të cilat kanë qenë mënyrë e jetesës së popullit tonë në shekuj. Ai çdo vit prodhon dhe shpërndan falas kalendarë, në faqet e të cilëve zë vend edhe xhamia si pjesë e rëndësishme e jetës dhe e vlerave jetike të popullit tonë. Musai e ka vënë pasurinë me djersë e punë të ndershme, ku angazhohen tërë pjesëtarët e familjes dhe shpenzohet në të mirë të familjes dhe të njerëzimit. Kjo pasuri i sjell respekt e mbarësi familjes në vazhdimësi.

Rruga e Arbërit nr. 87

Mr.Ruzhdi Lata kryetar i Dibrës së Madhe
u takua me gazetarët

qeverisje

Jemi në shërbim të qytetarit

Nga **REXHEP TORTE**

Mr.Ruzhdi Lata, kryetar i Dibrës së Madhe në takimin që pati ditë më parë me gazetarët,, deklaroi se:" Është obligim moral dhe tradicional që kur mbushen 100 ditë aktivitet jepet një prezentim për aktivitetet e bëra dhe për mundësitë e realizuara dhe të pa realizuara që kur unë gjendem në postin e kryetarit të komunës së Dibrës.

Në fillim dëshiroj të gjithë besimtarëve tua uroj muajin e shenjtë të Ramazanit, sepse ata edhe më votuan. Falënderoj përzemërsisht të gjithë qytetarët, të cilët në mënyrë tejet serioze dhe me një aktivitet plot shpresë ma dhanë votën me bindje për një ardhmëri më të mirë. Unë në Dibër pata votat absolutisht të pa arritura deri më sot. Ky besim i atyre që përkrahën BDI-në, me pranimin e postit jam i vetëdijshëm dhe kam marrë si obligim që të jem kryetar i tërë banorëve dibranë, pa marrë parasysh përkatësin e tyre partiake, nacionale e fetare. Me votën e lirë dhe demokratike u dëshmua se Dibra është një qytet fisnik, i urtë dhe me plot kulturë, ishte dëshmi e qytetarëve se duan të jetojnë në një Dibër më të bukur, më të mirë, më të pastër e më të rregulluar që mbetet obligim i imi.

Dëshiroj të falënderoj të punësuarit në Komunën e Dibrës, të cilët më pranuan në mënyrë shumë njerëzore, në mënyrë dhe me sjellje të kulturuar. Nuk u ndjeva aspak i huaj apo antitrup, por u ndjeva pjesë përbërëse e tyre që kishin shpresë se do të vijnë ditë më të mira edhe për ata. Ky pranim ishte sipas traditës dibrane.

Falënderoj udhëheqësit e sektorëve që funksionojnë në komunë, si ata të urbanizmit, financave, arsimit, jurisprudencës, resurseve njerëzore me të cilët vazhdoj bashkëpunim, që më shtoj bindjen dibrane që të mos bëj asnjë ndërrim të këtyre udhëheqësve. Ky është rast unikal në tërë Maqedoninë siç ishte dita e votimit pa asnjë problem dhe të vazhdojmë punën pa asnjë ndërim kadrovik brenda në komunë dhe në institucionet që i ka në kompetencë kryetari i komunës, siç ka ndodhur në komunat tjera. Edhe gjatë fushatës parazgjedhore nuk mora asnjë obligim personal prej dikujt, nuk pranova asnjë donacion prej dikujt tjetër dhe nuk punësova asnjë militant të partisë, siç është vepruar më parë, sepse do të kishim kokëdhembje të mëdha në këto vite dhe kohëra të krizës së përgjithshme ekonomike që më së shumti reflekton në qytetin tonë. Më përcolli edhe një fatmirësi tjetër që ishte themelimi i Këshillit Komunal, që u realizua në afat rekord pa as një lloj problemi. Në një Maqedoni krejtësisht të trazuar kemi një Dibër absolutisht të qetë. Kjo më bën që të jem më i lirë, më aktiv, më i disponuar që të veprojmë në të mirë të Dibrës dhe dibranëve. Sëbashku me bashkëpunëtorët e mi, por duke mos harruar edhe prezentimin real nga ana e mjeteve të informimit. Vlen të përmendet edhe mirëkuptimi i eprorëve dhe drejtorëve të emëruar nga ministritë e ndryshme që funksionojnë në Dibër me të cilët jam në kontakte të përditshme për të arritur rezultate më të mira të ndërsjella. Vetë jeta e vërteton se me çdo dibran mund të punohet, gjë që këtë e kanë dëshmuar mërgimtarët dibranë me suksese të arritura në shtetet ku jetojnë e punojnë. Kjo do të thotë se lypset të gjenden metodat e punës.



Dibra është një qytet fisnik, i urtë dhe me plot kulturë, ishte dëshmi e qytetarëve se duan të jetojnë në një Dibër më të bukur, më të mirë, më të pastër e më të rregulluar që mbetet obligim i imi.

KTHIMI I BORXHEVE, RRITJE E DISIPLINËS DHE ANGAZHIMIT NË PUNË

Duke folur për fillimin e aktiviteteve si kryetar i komunës, Mr.Ruzhdi Lata, theksoi se "Puna e parë me fillimin e mandatit tim ishte sistemimi dhe rregullimi i mjeteve materiale që komuna ua kishte borxh të tjerëve. Borxhe që nuk ishin të vogla. Por me një mirëkuptim të atyre subjekteve që kishin punuar në Dibër, duke e kuptuar edhe ata mentalitetin dibran, ne arritëm t'i sistemojmë këto borxhe në mirëkuptim, arritëm të fillojmë të realizojmë edhe pagesën e borxheve, por jo siç ishin paraparë të menjëhershme, sepse nuk ekzistonte mundësia. Ky bashkëpunim dhe mirëkuptim me ata që u kemi borxh na mundësoi që ne të jemi aktiv në punët tjera për nevojat e qytetit. Po të mos ishte ky mirëkuptim mund të ndodhte edhe mbyllja e llogarisë rrjedhëse dhe të paralizohemi në veprim. Kështu për shembull ndërmarrja "Progres" për asfaltim nga Gostivari, të cilës i kishim 80 mijë euro borxh pa ia kthyer borxhin ajo fillon të investojë, ndërsa ne do t'ia kthejmë borxhin dalëngadalë.

Puna tjetër që bëra është se të gjithë të punësuarve u dhashë vendime pune në vend të kontratave për punë që i kishin gjer më sot. Këtë e bëra që këta të punësuar pa vendime pune, ti largoj nga stresi që kishin për vendet e punës.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve Ali Ahmeti, kryetari i BDI-së më tha se tashmë Dibrën e kanë nxjerrë nga agjenda. Kjo do të thotë se mi ka lënë duart e lira, por kjo mua më ka bërë edhe më të përgjegjshëm. Arritëm ta bëjmë riorganizimin e administratës duke aplikuar disiplinën rendin, dëgjueshmërinë, pa sanksione, pa urdhër dhe pa presione. Unë dhe tërë të punësuarit në komune vëmendje të veçantë i kemi vënë bashkëpunimit dhe mirëkuptimit me qytetarët, sepse ne këtu jemi për ti respektuar dhe shërbyer qytetarët. Qytetari gjithmonë të jetë i privilegjuar nga ne, e jo ne nga qytetari. Kjo është metoda më efikase e punës e këtij shekulli, e kësaj toke, e kësaj periudhe historike që ne duhet ta kultivojmë në qytetin tonë.

Duke folur për punët që janë kryer deri tani, kryetari Ruzhdi Lata, tha se "Këto punë janë bërë me mjetet tona të ndërtimit, me pllakat e betonit, rërën, çimento, tubot, për punën e kanë bërë vetë qytetarët. Punët tona i kemi filluar në ato pjesë të qytetit ku banorët nuk kanë qenë të përfillur, në të kaluarën dhe që e kishin humbur shpresën se dikush do t'i ndihmojë. Filluam në lagjen e sipërme në "Varosh" ku ndërtuam gjashtë rrugica me 2500 m2 pllaka betoni 150m kanalizim fekal me f-160 dhe 50 metër ujësjellës. Pastaj bëmë pllakëzimin me 800m2 afër xhamisë së Hynqarit, bëmë kanalizim fekal prej 120m me tubo f200 dhe 50 m ujësjellës. Bëmë rrugën në lagjen "Dervish Mustafa", ku lëvizin shumica e nxënësve të shkollës "Said Najdeni", ku pllakëzuam, bëmë kanalizimin dhe ujë sjellësin. Kjo rrugë nuk ishte rregulluar që prej 200 viteve. Në rrugën" 22 Dhjetori" te posta e vjetër u shtruan 230m2 pllakëzime. Në lagjen Kojnarë dhe rrugën "Xhavit Ushtelenca" u shtruan rrugica dhe trotuare 580m2, si edhe 120m kanalizime dhe ujësjellës. Të gjitha këto me materialet tona, ndërsa me krahë pune te vetë banorëve. Në lagjen "Tabakane" pllakëzuam 370m2 me kanalizim dhe ujësjellës. Në lagjen e "Bomovës" shtruam 500m2 i asfaltuam rrugët e dëmtuara ku shtruam 250 tonelata asfalt ose 1200 m2 me trashësi prej 7 cm. Në fshatin Kosovrast i Eperm kemi bërë kanalizim për vaditjen në 100 m gjatësi, në fshatin Shullan 60m gjatësi.

Po bëjmë përgatitjet edhe disa rrugë e trotuare në fshatin Banisht 800m2 në lagjen "Qernanic" 1000m2 dhe pllakëzimi I trotuareve deri te spitali dhe Shkolla "Penestia".

Me një mirëkuptim shumë njerëzor përmirësuam rrugën për në vendkalimin e "Bllatës"që nuk është një investim i komunës. Drejtori i Ndërmarrjes "Rrugët e Maqedonisë" ndihmoi që të bëhet asfaltimi i 1100m2 në hyrje të Dibrës, kemi lobuar edhe për asfaltimin e rrugës Dibër-Strugë.

Dua të përmendi edhe ndërtimin e shkollës së re të Gjimnazit në fshatin Mogorçë dhe në qytetin e Dibrës. Arsimtarët Dibranë të Gjimnazit paratë e kursyera me vite i investuan në fillimin e ndërtimit së shkollës së re, duke hequr dorë nga aktivitetet e tjera. Kjo është traditë dibrane që vazhdon që nga viti 1960 kur filloi të funksionojë Gjimnazi në Dibër, kur profesorët Muhamed Paçuku, Nehat Bellçishta, Mahmud Hysa, Irfan Oruçi, Sherif Lleshi, Irfan Jahjaga etj., asokohe punuan 6 muaj pa pagesë ndërsa donator ishte Haki Papraniku, i cili bamirësin e tij e dëshmoi edhe me dhurimin e tokës Myftinisë së Dibrës ku 50 vite janë duke u varrosur dibranët që ndërrojnë jetë. Të gjithë këta persona që kanë sakrifikuar meritojnë mirënjohje.

HARTOHEN PROJEKTE PËR TË ARDHMEN

Janë duke u hartuar plane detale urbanistike, shtoi Lata, "për qendrën e qytetit, lagjen Tylbe, bllokun te Pallati të Kulturës dhe Bregu i Liqenit, plani detal te ura e Boshkut ku pritet të ndërtohet një hidrocentral, tashmë pritet fillim i ndërtimit të fabrikës Kroate për ambalazhimin e ujit te Lugina e Përroit të Gajres, projekti i rrugëve së Banishtit dhe Krifcës".

Duke folur për rikonstruimin e pusetave të ujësjellësit, që do të arrijë vlerën 400 mijë euro, me çka do të bëhet sistemimi më i mirë i furnizimit me ujë, Kryetari Lata shtoi se: "Në Dibër arrin 120 m3 ujë në sekondë, për me gjithë atë mungon uji i pijshëm. Kjo don të thotë se uji i pijshëm keqpërdoret për larje oborresh, rrugësh, për ujitjen e kopshteve dhe të tokës bujqësore. Do të jemi të detyruar që së shpejti ti publikojmë emrat e keqpërdoruesve, të cilët edhe abuzojnë me ujin, por edhe nuk paguajnë. Ne do të detyrohemi që këtyre personave tua ndërpresim edhe furnizimin me ujë të pijshëm.

Në ambientet e komunës kemi bërë shumë takime me funksionarë dhe akademikë. Kemi marrë pjesë në shumë aktivitete të zhvilluara në Kosovë, siç ishte pjesëmarrja jonë në 135 vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Shqipëri, me rastin e shënimit të 100 vjetorit të eksodit dibran në Tiranë, në Turqi, vizita me rastin e vëllazërimit me komunën Kapakllë, kemi patur edhe shumë takime me funksionarë të lartë nga Maqedonia, si edhe pjesëmarrja e jonë në Ambasadën e SHBA-ve në Shkup, me rastin e shënimit të Pavarësisë", tha në fund Mr.Ruzhdi Lata para gazetarëve.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik të trevave të Dibrës është një ndër segmentet themelore të historisë së kulturës dhe të qytetërimit të popullit shqiptar në përgjithësi.

Historia e zhvillimit të shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në Dibër



Nga Prof. Dr. **NURI ABDIU**

Shënim:

Në gazetën Rruga e Arbërit, nr 5(85), Maj 2013 në faqen 18, është botuar shkrimi "Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik", me autor Prof.Dr. Nuri Abdiu. Ky shkrim është botuar i paplotë dhe me gabime. Përgjegjesia për këtë është e imja si redaktor i gazetës, dhe duke i kërkuar ndjesë Autorit dhe lexuesit, po e ribotojmë edhe njëherë, siç është lexuar në prezantimin e librit. Faleminderit për mirëkuptimin!

Bujar Karoshi



Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik të trevave të Dibrës është një ndër segmentet themelore të historisë së kulturës dhe të qytetërimit të popullit shqiptar në përgjithësi.

Hulumtimet e mirëfillta shkencore në historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar kanë nisur relativisht vonë. Megjithatë, puna kërkimore-shkencore e studiuesve shqiptarë, studimet dhe monografitë e tyre, sidomos pas viteve '60 të shek. XX, hedhin dritë në një traditë të pasur dhe në shumë aspekte të saj.

Kjo traditë e pasur dhe nga më të shquarat në historinë shumëshekullore të kombit tonë, është e hidhur me tiparin e theksuar arsimdashës të popullit shqiptar dhe të dibranëve në mënyrë të veçantë. Kjo traditë është e lidhur me jetën dhe veprën e përkushtuar të bijve të tij të ndritur që e bënë arsimin pishtar për liri, zhvillim e dituri. Për këtë arsye dhe "Dibra në hulli të historisë", është vepër dinjitoze që përfaqëson një nga botimet më fondamentale, më të plota dhe që jep për herë të parë dhe në mënyrë të dokumentuar historinë e arsimit të shkollave dhe të mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj.

Kjo vepër mendojmë se mbart vlera me rëndësi historike, jo vetëm për rrethin e qarkun e Dibrës, por edhe më gjerë.

Kanë trajtuar probleme që lidhen me zhvillimin e shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj disa studiues, ndër të cilët duhen përmendur: Fatos Daci, Dr. Hysni Myzyri, Gafur Zoto, Hysni Çipuri, Dritan Murrja etj.

Vlerat e veprës spikasin në shumë drejtime, por unë do të ndalem vetëm në disa prej tyre.

Autori i saj me përgjegjësi shkencore dhe qytetare ka nxjerrë në pah me sens prej pasionanti trashëgiminë kulturore dhe arsimore të Dibrës.

Sistemimi dhe përgjithësimi i materialit është mjaft i arritur, po të marrim parasysh se tema është shumë e gjerë dhe e shtrirë, si në kohë ashtu dhe në problematikë. Në kohë: shtrihet nga lashtësia deri më 1912 (vëll. I, prej 342 faqesh). Nga 1912 deri më 1944 (vëll. II prej 367 faqesh) dhe nga 1944 deri më 1990 (vëll. III, prej 385 faqesh). Ndërsa në problematikë: në këtë vepër rroken dhe trajtohen, natyrisht mbi bazën e legjislacionit dhe dokumenteve njëpartiake të kohës dhe rregulloreve e normave përkatëse një gamë problemesh, nga më të ndryshmet, që lidheshin me sfidat nga më të mprehtat të kohës, sfidat e hapjes dhe rritjes së numrit të shkollave dhe të nxënësve, përgatitjes së mësuesve e shumë e shumë të tjera.

Zhvillimi i shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik edhe në Dibër është parë në lidhje të ngushtë dhe është mbështetur në mendësinë dhe mendimin filozofik e shoqëror dibranë, në zhvillimin politik të vendit si dhe në gjendjen ekonomike, shoqërore e kulturore të Dibrës.

Nga kjo pikëpamje studimi ka qenë shumë i mundimshëm, megjithatë autori ka treguar aftësitë e veta shkencore, jo vetëm për të gjetur boshtet e duhura, por edhe për ta kompaktësuar lëndën rreth këtyre boshteve.

Autori Xhemal Domi, si hulumtues i mirënjohur, që nga viti 1972, (këtu e 40 vjet më parë) ka kërkuar, gjetur, evidentuar, klasifikuar, periodizuar, studiuar e sistemuar gjithë trashëgiminë kulturore që lidhet me historinë e shkollës, arsimit dhe të mendimit pedagogjik në trevat dibrane dhe rreth saj.

Autori ka shfrytëzuar burime të shumta, material dokumentar arkivor e bibliografik, botime të ndryshme të vendit, të Prishtinës, të shqiptarëve të Maqedonisë, Shkupit, Malit të Zi, kujtime etj.

Vepra në tërësinë e saj përmban 1419 fusnota, që do të thotë se u referohet shumë e shumë burimeve. Një tregues i tillë e rrit më shumë vlerën shkencore të saj.

Zhvillimi i shkollave, arsimit dhe mendimit pedagogjik edhe në Dibër është parë në lidhje të ngushtë dhe është mbështetur në mendësinë dhe mendimin filozofik e shoqëror dibranë, në zhvillimin politik të vendit si dhe në gjendjen ekonomike, shoqërore e kulturore të Dibrës.

Në hapjen e shkollave dhe zhvillimin e arsimit në Dibër, veçmas në emërimin e kuadrit, ka ndikuar ndjeshëm dhe Paria vendase, sipas interesave, ndarjes gjeografike dhe zonave të influencës.

Si shembull vlejnë të përmenden edhe tri shkollat e para shtetërore, të cilat autori me të drejtë i quan "Tri dallëndyshet e para", që u hapën në Peshkopi, në Trojak (Sllovë) dhe në Trebisht në prill të vitit 1914.

Me hapjen e tyre në Dibër fillon arsimi kombëtar i drejtuar nga shteti si dhe roli i Haki Sharofit që e përkrahu prefekti i Durrësit Mehdi Frashëri për t'u caktuar mësues në Peshkopi në qendrën e Prefekturës, dhe Fetah Ajdinit – (Hafuz Fetahu) që u caktua në shkollën e Trojakut që ishte nën kujdesin e Elez Isufit dhe, Ramiz Qatjas që hapi shkollën e parë shqipe në Trebisht më 15 prill 1914.

Pas tyre janë hapur edhe disa shkolla të tjera që kanë lënë emër të mirë në historinë e arsimit të Dibrës. Ndër to duhet përmendur Shkolla Internat e Kastriotit, që në popull thirret me emrin "Internati i Kastriotit". Por dihet tanimë se internati është konvikt, nuk është shkollë. Ky emërtim duhet rregulluar.

Ndikimi i Parisë në zhvillimin e arsimit në Dibër u shfaq dukshëm edhe në faktin se disa shkolla filluan të emërtoheshin si shkolla e Sulë Shehut, Fiqiri Dines, Dine Demës, Ali Maliqit, Elez Isufit etj.

Në këtë vepër rroken dhe trajtohen, natyrisht mbi bazën e legjislacionit dhe dokumenteve njëpartiake të kohës dhe rregulloreve e normave përkatëse, një gamë problemesh nga më të ndryshmet, që lidheshin me sfidat nga më të mprehtat të kohës, sfidat e hapjes dhe rritjes së numrit të shkollave dhe të nxënësve, përgatitjes së mësuesve e shumë e shumë të tjera. Nga kjo pikëpamje studimi ka qenë shumë i mundimshëm, megjithatë autori ka treguar aftësitë e veta shkencore, jo vetëm për të gjetur boshtet e duhura, por edhe për ta kompaktësuar lëndën rreth këtyre boshteve.

Nuk mundem të mos i kujtoj këtij auditori të nderuar edhe disa nga momentet kyçe që theksohen dhe në veprën e Xhemal Domit:

- Tri shkollat e para shtetërore që u hapën në Peshkopi, në Trojak dhe në Trebisht më 14-15 prill 1914.
- Shkolla internat "Dibra" në peshkopi në dhjetor 1923 dhe që transferohet në Kastriot në nëntor 1925.
- Shkolla e parë e mesme (unike) në Peshkopi që u hap më 1945 (në Dobrovë) me drejtor Edip Tërshanën nga Dibra e Madhe.
- Konvikti i saj më 1 dhjetor 1946, në shtëpinë e Abdulla Beut në Dobrovë, me drejtor Nuri Prrenjasin nga Korça.
- Shkolla Pedagogjike u hap më 1948, me drejtor Rexhep Kadzadein nga Elbasani.
- Qendra e konsultimit dhe provimeve e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës që u hap më 1971, me përgjegjës Defrim Trepçën nga Peshkopia etj.

Me këtë rast më lejoni që të shpreh përnderimin tim dhe Tuajin për të gjithë atë plejadë arsimtarësh, që u bënë pishtarë të vërtetë të arsimit në Dibër dhe që hodhën farën e dijes në hullinë e historisë së saj.

Fjalë e mbajtur në prezantimin e librit të studiuesit Xhemal Domi "Dibra në hulli të historisë", Tiranë, vëll. I, 2012, vëll II dhe III, 2013, Botimet "M&B"

2 Mars 2013

"Biblioteka e autorëve dibranë"



Rruga e Arbërit nr. 87
kujtesë

Komuna Qendër dhe Komuna Maqellarë
nderojnë dy dëshmorë të Atdheut

Pilotët **Sefedin Tomçini** dhe **Sabri Toçi** shpallen "Qytetarë Nderi"

Ditën e hënë, datë 17 qershor, në sallën e Shtëpisë së Kulturës Peshkopi u organizua një ceremoni me rastin e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" dy ish pilotëve të Forcave tona të Armatosura, dëshmorëve të Atdheut, Sefedin Hasan Tomçinit dhe Sabri Shefki Toçit. Salla ishte mbushur plot e përplot nga të afërmit e dy aviatorëve të rënë në krye të detyrës dhe shumë bashkëfshatarë e bashkëqytetarë të tyre.

Kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë ceremoni edhe përfaqësues të Armës së Aviacionit Kombëtar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shoqatës së Aviatorëve të Rënë në krye të detyrës. Kishte ardhur për të nderuar ish kolegët e tij edhe piloti i parë i rrethit të Peshkopisë, z. Allaman Isaku. Ishin të pranishëm gjithashtu edhe kryetari i Bashkisë së Peshkopisë z. Ilir Krosi, kandidatët për deputetë zotërinjtë Sherefedin Shehu dhe Sali Shehu etj.

Ceremonia u hap me ekzekutimin e Hymit Kombëtar. Pastaj e mori fjalën kryetari i Komunës Tomin, Z. Sadik Cena, i cili lexoi motivacioni, me të cilin kjo Komunë i jepte titullin "Qytetarë Nderi" ish pilotit Sefedin Tomçini dhe i dorëzoi diplomën përkatëse të shoqes, zonjës Suzana Tomçini. Pas tij në tribune doli kryetari i Komunës së Maqellarës, z. Bardhyl Agolli, i cili lexoi motivacionin për ish pilotin Sabri Toçi dhe i dorëzoi diplomën përkatëse bashkëshortes së tij.

Duke falënderuar për këtë nder që i bëhet bashkëshortit të saj pas rënies në krye të detyrës, z. Suzana Tomçini majti një fjalë shumë të ndjerë dhe prekëse. Midis të tjerash,ajo tha:

"Ju falënderoj me gjithë zemër për këtë vlerësim që i bëhet Sefedinit, pas titullit të lartë "Dëshmor i Atdheut". Megjithëse kanë kaluar shumë vite nga dita e rënies, vendi i lindjes, vendi ku u rrit, u shkollua dhe ku pati shumë shokë e miq, jo vetëm që nuk e ka harruar, por e nderon me këtë titull të lartë. Ju falënderoj nga zemra të gjithëve.

Në këtë çast kaq prekës dua të përulem para kujtimit të babë Hasanit, burrë i shquar e trim, dhe nënës Shime, gruas gojëmbël e të palodhur, qe lindi e rriti 9 fëmijë- shtatë djem e dy vajza, ndër të cilët edhe Sefedinin

Sefa ishte një djalë me virtyte të rralla. Ishte i dashur, i respektueshëm, punëtor i palodhur, i thjeshtë, i mençur, shakaxhi, poet dhe krijues. Ishte baba shembullor. E donte jetën, por Atdheun e donte edhe më shumë. Tek Atdheu ishte jeta e tij, të cilin nuk hezitoi t'ia falte atë në mënyrën më heroike…

Në çdo çast të jetës sime jam ndjerë krenare që kamë qenë nuse në familjen e Hasan Tomçinit, me tradita patriotike e vlera të larta, me të cilat unë krenohem kudo që ndodhem.Unë vetë jam me origjinë nga Libohova, por gjysma ime tashmë është kthyer dibrane. Unë me Sefedinin jetova 8 vjet, pra shumë pak, pasi rënia e tij në krye të detyrës, na ndau. Jam munduar të rris dy vajzat e mia Eldën dhe Arlindën, vetëm dhjetëmuajshe, duke patur si busull Sefedinin në çdo çap që bëja e hidhnja. Doja që ato të rriteshin e ti ngjanin babait të tyre, të mençura e punëtore. Dhe sot mund të them se ia arrita qëllimit për betimin në heshtje që kisha bërë. Por, këtu nuk mund të lejë pa përmendur ndihmën e pakursyer që kanë treguar për neve vëllezërit e Sefes: Sula, Nexha, Seiti, Përparimi, Fatosi, Safeti dhe Drita e Bidja, shokët e tij si Safet Zhulali dhe të gjithë dibranët zemërmirë.

Kur vij në Peshkopi, tek çdo dibran që takoj, shoh sikur takoj një pjesë të Sefedinit. Këtu në Peshkopi, unë ndjehem si në shtëpinë time.





> Megjithëse kanë kaluar shumë vite nga dita e rënies, vendi i lindjes, vendi ku u rrit, u shkollua dhe ku pati shumë shokë e miq, jo vetëm që nuk e ka harruar, por e nderon me këtë titull të lartë. Ju falënderoj nga zemra të gjithëve.

Për Sefedinin kam kujtime të bukura, të paharruara e mund te flas me orë të tëra, por sot dua të kujtoj diçka: E pyesja shpesh: "Dine! Ç'farë do të bësh kur të dalësh në pension?"Ai më përgjigjej me plotë gojën: "Do të shkojë në Pollozhan, ku kam lindur, se më merr shumë malli jo vetëm për shokët, miqtë por edhe për gurët e rrugës se fshatit dhe bulevardin e bukur të Peshkopisë…."

Edhe një herë ju falënderoj të gjithëve që po kujtoni këta dy bijë të shquar të Dibrës heroike: Sefedinin dhe Sabriun. Dy djem te rinj, që punuan e vigjëluan në radhët e Ushtrisë me nder dhe që ranë në krye të detyrës për Atdhe. Kurse bashkëshortja e dëshmorit Sabri Toçi,Teuta, pasi falënderoi për titullin që Komuna e Maqëllarës i dha bashkëshortit të saj, duke iu drejtuar familjarëve të burrit të saj, u shpreh: "Unë zgjodha të jem pjesë e familjes tuaj fisnike dhe jam e lumtur për këtë.

Edhe pse fati nuk deshi që Sabriu të ishte përkrahë meje, unë asnjëherë nuk jam ndjerë e vetme, sepse kam gjetur kurdoherë ngrohtësinë, mirëkuptimin dhe ndihmën tuaj. Edhe pse i rritur pa baba, djali im asnjëherë nuk është ndjerë si jetim, pasi ju vëllezërit, motrat dhe ju kushërinjtë e Sabriut i dhuruat ngrohtësi, afrimitet dhe shumë dashuri. Një falënderim të veçantë edhe për ju dhe gjithë familjet tuaja."

Ajo foli edhe për Sefedinin, duke thënë se ai mungon sot në këtë atmosferë kaq të bukur e prekëse, por unë e shoh atë në fytyrat tuaja, e shoh atë në sytë tuaj, në sytë e vajzave të tij Eldës dhe Arlindës si dhe të bashkëshortes së tij Zanës. Unë, për aq pakë kohë që munda ta njohë, e konsiderova atë një vëlla tjetër të Sabriut."

Pastaj e morën fjalën përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Organizatës së Aviatorëve të Rënë në krye të detyrës.

Një fjalë mjaftë vlerësuese mbajti edhe kryetari i Bashkisë së Peshkopisë Z.Ilir Krosi. Ai, duke evokuar jetën dhe trimërinë e dy Dëshmorëve të Atdheut, Sefedin Tomçinin e Sabri Toçit, theksoi se "Dibrës në historinë e saj kurrë nuk i kanë munguar trimat dhe patriotët, që për tokë e Atdhe nuk kanë kursyer as pasuri, as jetën dhe asgjë tjetër".

Në fund për të pranishmit u dha një koncert nga grupi i Shtëpisë së Kulturës. Për të pranishmit këndoi edhe këngëtari i njohur nga Kosova Ilir Shaqiri, i cili këndoi me shumë shpirt e pasion një këngë kushtuar shqiponjave shqiptare të ajrit, të kompozuar nga kompozitori i njohur dibran Përparim Tomçini, duke emocionuar e përlotur të pranishmit e sidomos të afërmit e dëshmorëve.

Në fund nga të afërmit e dy dëshmorëve u dha një koktej, që u karakterizua nga po ajo fryme që karakterizoi gjithë ceremoninë.

Korresp. "Rr.A"

TENT-A-TIVE

Unë, polici dhe dibranët në mes

Nga **AFRIM KAROSHI**

Shënim paraprak: U tundova të shkruaj një përshkrim hyrës për Dibranët që do të lexojnë historinë e mëposhtme, por pastaj hoqa dorë. Dibranët s'kanë nevojë për sqarime paraprake për historitë… Le të hyjmë në temë.

Dola me një mik për të gjetur një mbajtëse pasqyre. Pas sorollatjeve në trafikun e Tiranës, nën përvëlimin e vapës tretëse, më në fund e gjetëm atë që po kërkonim. Të gëzuar, po ktheheshim në shtëpi. Në një nga kryqëzimet më ndaloi një polic rrugor.

Polici më përshëndeti.

- Ju lutem më tregoni dokumentet.

- Më falni, – i thashë, – cili ishte problemi?

- Keni shkelur semaforin.

- Nëse unë mendoj që s'kam kryer shkelje, si i bëhet?

- Mund të shkosh te komisioni që mblidhet të hënën, – më tha polici rrugor, – dhe pastaj ata do ta vërtetojnë shkeljen.

- Pse do të më besojnë mua ata? Natyrshëm, – i thashë, – do t'ju besojnë ju sepse ju jeni zyrtari.

- E shikojnë në kamera. Është shumë e lehtë.

Kamerat m'u duk argument shumë i mirë.

- Megjithatë, – e vazhdova argumentin unë, – jam i sigurt që semafori ishte ngjyrë e verdhë.

- E drejtë, – më tha. – Semafori ishte i verdhë. Por kodi rrugor e ndalon hyrjen në kryqëzim kur semafori është me ngjyrë të verdhë.

Zotëria më citoi nenin e kodit rrugor, nen i cili nuk më kujtohet tani, por do ta kërkoj dikur.

- Faleminderit, – i thashë, – që më në fund, një polic më arsyeton për semaforin e verdhë në vend që të ngulë këmbë që kam hyrë me të kuqe në kryqëzim.

E ndërpremë bisedën pak. U gëzova që po merreshim vesh siç duhet, por fillova të mërzitem që do të marr një gjobë, që më dukej e panevojshme. Ai vazhdoi punën e tij duke parë dokumentet.

- Z. Afrim, – më tha, – do të marrësh një gjobë minimale, më të ultën që mund t'ju jap.

- Faleminderit, – i thashë.

Unë u ktheva duke vazhduar bisedën me mikun tim, që më shoqëronte në makinë.

- A ke gjobë tjetër? – më pyeti zyrtari.

- Jo!

Pas disa sekondash, zotëria me uniformë, më dorëzoi dokumentet edhe tha:

- Afrim, nga Dibra je?

- Po, – iu përgjigja.

- Nuk po të vendos gjobë sot. Për dy arsye: E para sepse je shumë i komunikueshëm. Dhe e dyta, sepse je i pari dibran, që nuk me jep në telefon një mik, sapo e ndaloj.

- Dibranët kështu?

- Të gjithë dibranët që kam ndaluar, madje përpara se t'ju them arsyet se pse i kam ndaluar, më thonë: "Foli pak këtij mikut tim në telefon!"

Qesha. Përpos mendimit që dibranët kanë shumë shoqëri me njëri-tjetrin, dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin kur janë në hall, dhe përtej gëzimit që nuk më duhet të paguaj një gjobë, mendova që më në fund, kam takuar edhe unë një polic rrugor krejt ndryshe nga të tjerët…

Titulli është i redaksisë. Titulli origjinal "Një dibran ndryshe dhe një polic ndryshe" www.kuturu.org

Starton projekti i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit rural dhe malor në vargmalin e Deshatit

Vargmali i Deshatit, *aty ku nis zhvillimi i* **turizmit**



Bjeshket e Rabdishtit. Foto © B Karoshi.

Nga **BESNIK ALKU**

Vargmali i Deshatit, është një nga perlat më të bukura malore të Shqipërisë. Ai shtrihet në pjesën lindore të rrethit të Dibrës, duke përshkuar gjithë pjesën kufitare të Shqipërisë me Maqedoninë. Ky vargmal është më i veçanti në Shqipëri dhe në Maqedoni pasi ka majat më të larta të maleve—Korabin dhe Kërcinin në Shqipëri dhe Valivarin në Maqedoni. Bukuritë natyrore janë mahnitëse dhe të shumëllojshme. Ato fillojnë me shkëmbinjtë e malit të Korabit dhe Kërcinit, vazhdojnë me bjeshkët e fushës së Korabit, Gramës, Skërtecit, Hinoskës e Kërcinit, me liqenin e zi në Korab dhe liqenin e Gramës, me burimet ujore termale të llixhave të Peshkopisë, burimet e ujit të ftohtë të Vleshës, burimet e bjeshkës së Shehut dhe ujin e Preshit, dhe vazhdojnë me ujëvarat e Radomirës, Bahutës, Pocestit dhe shumë e shumë bukuri të tjera natyrore të cilat padiskutim i ngjajnë një mozaiku të perlave natyrore malore. Ato përbëjnë një potencial kryesor për zhvillimin e turizmit rural dhe malor.

Megjithëse ka potencial natyrore për zhvillimin e turizmit malor, ky sektor është pak, për të mos thënë aspak, i zhvilluar në këtë zonë. Banorët e Maqellarës, Melanit, Peshkopisë, Tominit, Kastriotit, Çidhnës, Sllovës dhe Kalasë së Dodës, shumë pak i shfrytëzojnë këto burime për rritjen e të ardhurave të familjeve të tyre nga turizmi. Ka disa nisma për shfrytëzimin e ujerave termale të llixhave për turizëm kurativ në Peshkopi dhe në disa shtëpi pritëse në Hinoskë, Rabdisht dhe Kala e Dodës të cilat janë sporadike dhe të pa-organizuara. Pushteti lokal nuk është i angazhuar sa duhet në bërjen e politikave zhvilluese për turizmin, në bashkërendimin e punës së strukturave të administratës së tyre në nxitjen dhe promovimin e zhvillimit të turizmit. Sektori privat nuk i ka hedhur sa duhet sytë nga turizmi dhe cilësia e shërbimit turistik dhe në ato mjedise që janë krijuar, le shumë për të dëshiruar. Edhe sektori jofitimprurës është i fragmentuar dhe sporadik në përpjekjet e tij, duke qenë më shumë një zë i heshtur dhe me pak influencë në zhvillimin e këtij sektori.

> Ndryshimi rrënjësor nuk mund të bëhet brenda natës apo vitit. Sidoqoftë, grupet lokale të veprimit mund të jetë pionieri dhe promotori i aktorëve lokalë që me kalimin e kohës do të shumëfishohen në numër dhe influencë dhe do të investojnë, organizojnë, kontribuojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe malor në vargmalin e Deshatit. Në një të ardhme të afërt, ne besojmë se do të shkelim shtigjet turistike në vargmalin e Deshatit, ngremë kampingje në bjeshkët e tij, kalojmë netët në shtëpitë pritëse të Radomirës apo Rabdishtit, shijojmë gatimet e shumta tradicionale dibrane, marrim pjesë në festat folklorike dhe të Odës Dibrane, bëjmë edhe ski në qendrat e skive që do të ngrihen në këto male.



Uji i Ftohte - Vleshe. Foto © Bujar Karoshi.

Tendencat e zhvillimit të sektorit të turizmit në Shqipëri, por dhe eksperienca e mirë e zhvillimit të turizmit në pjesën kufitare të Maqedonisë (krahasuar me vendin tonë) si në Mavrovë, Rostushë, Dibër e Madhe janë modele dhe shembuj nxitës për zhvillimin e turizmit rural dhe malor në zonën e vargmalit të Deshatit në Dibër. Kështu, si pasojë dhe e shtimit të investimeve private që janë bërë nga vetë banorët dibranë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale dhe krijimi i agjencive turistike lokale, janë krijuar modele dhe aktorë të cilët po e orientojnë zhvillimin e sektorit të turizmit edhe në këtë zonë. Një kontribut në këtë fushë, sidomos përsa i përket modeleve, po japin dhe programet ndër-kufitare IPA me Maqedoninë, siç është edhe projekti i financuar nga Komuniteti Europian "Zhvillimi i qëndrueshëm rural në zonën e vargmalit të Deshatit: Grupi i Veprimit Lokal i Deshatit" që zbatohet nga Qendra Kombëtare Burimore për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ANTTARC) në partneritet me Fondacionin Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF). Ky projekt po zbatohet edhe në zonën e Deshatit në Maqedoni ku partnerët e ANTTARC/ALCDF janë Fondacioni i Zhvillimit te Komuniteteve Lokale (LCDF) dhe Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit (CDSCD).

Grupet lokale të veprimit janë krijuar në Peshkopi dhe në Dibër të Madhe. Ata do të koordinojnë veprimet për zhvillimin e turizmit rural dhe malor në zonën e vargmalit të Deshatit. Grupi lokal i veprimit (GLV) është themeluar nga përfaqësues të Njësive Vendore, sektorit privat dhe sektorit të shoqërisë civile nga rajoni. Me mbështetjen e projekti, Grupi do të zhvillojë kapacitetin e tij dhe përfshihet në aktivitete ë rëndësishme përfshirë zhvillimin e strategjisë rajonale për zhvillimin e turizmit, promovimin e potencialit turistik, përmirësimin e infrastrukturës turistike përfshirë shtegun turistik dhe tabelat informuese, panairet me produkte tradicionale lokale, etj.

Ndryshimi rrënjësor nuk mund të bëhet brenda natës apo vitit. Sidoqoftë, grupet lokale të veprimit mund të jetë pionieri dhe promotori i aktorëve lokalë që me kalimin e kohës do të shumëfishohen në numër dhe influencë dhe do të investojnë, organizojnë, kontribuojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe malor në vargmalin e Deshatit. Në një të ardhme të afërt, ne besojmë se do të shkelim shtigjet turistike në vargmalin e Deshatit, ngremë kampingje në bjeshkët e tij, kalojmë netët në shtëpitë pritëse të Radomirës apo Rabdishtit, shijojmë gatimet e shumta tradicionale dibrane, marrim pjesë në festat folklorike dhe të Odës Dibrane, bëjmë edhe ski në qendrat e skive që do të ngrihen në këto male.

Ne besojmë që grupi i veprimit lokal i Deshatit do të jetë ndër pionerët e këtij zhvillimi.



Bjeshkët e Gramës.
Foto © Nexhbedin Karoshi

turizëm

Potencialet e turizmit malor

Një vështrim mbi turizmin dhe efektet e tij në zhvillimin e Dibrës

Nga **FATBARDH CENA**

Dibra ofron shumë resurse turistike, me një shtrirje të gjerë pothuajse në gjithë rrethin: Parkun Kombëtar të Lurës me liqenet e mrekullueshme e të rrallë, masivin malor të Korabit, hapësirën e bjeshkëve nga Grama në Ilnicë, liqenet e Balgjajt, pyjet e Pratit, rrjedhën e Drinit të Zi e plot resurse të tjera turistike të fshehura në çdo luginë e kodër. Oferta gjeografiko-natyrore është një nga elementët e rëndësishëm të zhvillim turistik. Potenciali natyror i një zone të caktuar gjeografike përbën bazën e ofertës turistike primare pasi ai ka të bëjë me faktin si dhe në çfarë mënyre mjedidi gjeografik natyror ndikon në zhvillimin e turizmit në hapësirën e caktuar gjeografike. Për të vlerësuar sa më mirë ofertën gjeografike të rrethit, do të marrim në trajtim analizues të gjithë elementët natyrorë të tij.

NDIKIMI I VEÇORIVE FIZIKO-GJEOGRAFIKE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT MALOR NË DIBËR

Pozita fiziko- gjeografike

Ky rreth shtrihet në verilindje të Shqipërisë në dy anët e luginës së Drinit të Zi duke u kufizuar në lindje nga vargmali i Korabit dhe në perëndim nga vargmalet e Lurës. Qendra e rrethit është Peshkopia që shtrihet 185 km nga kryeqyteti dhe 21 km largësi nga pika e doganës së Bllatës në Maqellarë. Nga pikëpamja administrative ky rreth ka në përbërjen e tij 1 bashki dhe 14 komuna. Sipërfaqja e rrethit është 1010 km2 ndërsa popullsia në fillim të vitit 2013 numëron 82 668 banorë (Drejtoria e zhvillimit rajonal, Keshilli I Qarkut Diber, 2013).

Asfaltimi i segmentit Kukës-Peshkopi po i rikthen rëndësinë e pozitës gjeografikë këtij rrethi dhe së bashku me burimet që përmban, pritet ta kthejë në një qendër të eurorajonit ndërkufitar. Kjo bën që pozita të bëhët faktor zhvillimi ekonomik dhe turistik për banorët e zonës dhe me gjerë. Heqja e doganave ka qenë faktor nxitës në bashkëpunimin mes dy Dibrave të cilat nuk i kanë ndërprerë asnjeherë marrëdhëniet e tyre të ngushta. Gjithashtu përfundimi i Rrugës së Arbërit pritet që t'i japë gjithë zonës një zhvillim të madh ekonomik dhe turistik.

Ndërtimi gjeologjik dhe relievi

Relievi i zonës është kodrinor-malor dhe dallohet për karakterin kompleks. Në përbërje të tij gjejmë: kurrize malore, pllaja, gropa, fusha karstike si dhe malësi e lugina. Mbizotëruese janë malësitë mbi 700-900m që ulen gradualisht në drejtim të perëndimit. Takohen tipa të relievit strukturor, eroziv, eroziv, dedunues, karstik apo akullnajor.

Gjejmë edhe forma nëntokësore si shpella, boshllëqe e lugina nëntokësore që paraqiten mjaft të larmishme në aspektin turistik. Relievi akullnajor ka shtrirje të konsiderueshme të cilin e gjejmë në pjesë te larta si majat e maleve që kanë përberje gëlqeroresh. Gjejmë edhe lëndina me peisazhe piktoreske si fusha e Korabit, bjeshkët e Shehut qe janë të rralla për nga vlerat ekonomike dhe turistike. (*"Rruga e Arbërit", Botim i LID*, 2007).[]

Klima

Klima ofron mundësi të shumta për zhvillimin turistik të Rrethit Dibër në të gjithë stinët e vitit. Reshjet e shumta të dëbores gjatë gjithë dimrit të lidhur ngushtë edhe me trashësinë e shtresës së dëborës që shkon deri në 130-178 cm në Fushë-Lurë dhe më tepër në Korab kanë krijuar mundësi që me peizazhin e bukur që krijohet, të tërheqin turistë të shumtë, amatorë të turizmit dimëror që shfrytëzojnë mundësitë për ushtrimin e sporteve zbavitëse dimërore.

Rol të rëndësishëm në tërheqjen e pushuesve luan klima e freskët që vihet re gjatë stinës së verës. Freskia e klimës e ndërthurur me hijet e shumta që krijohen si rezultat i pranisë së madhe dhe të kudondodhur të pyjeve prej ahu e pishe, krijojnë mundësi për çlodhje e pushim. Gjithashtu livadhet e shumta në zonat malore ofrojnë potenciale të mëdha për zhvillimin turistik.

Hidrografia

Rrethi i Dibrës ka një rrjet hidrografik shumë të pasur që përbëhet nga lumenj, liqene, përrej, burime nëntokesore dhe sipërfaqësore. Lumi kryesor është Drini i Zi që merr me vete disa degë të tjera si: Malla, Seta, Veleshica, Murra etj. Këta degë kanë karakter të vrullshëm dhe me prurje të mëdha në kohën e shkrirjes së borës. Gjithashtu paraqiten me mjaft interes në aspektin turistik pasi dallohen për ujin e tyre të pastër e të ftohtë. Burimet e freskëta të Bjeshkës së Preshit, Shehut, Gramës, Saponikës etj përbëjnë drejtimin kryesor të përmirësimit të furnizimit me ujë të freskët e cilësor. Gjithashtu vlera të mëdha për tërheqjen e turistëvë paraqesin liqenet akullnajorë të Lurës, liqeni i Gramës, liqenet e Kacnisë etj. që janë shpallur si monumente natyre.

Tokat dhe bujqësia

Dibra na paraqitet si një zonë e rëndësishme e zhvillimit bujqësor ne vend. Kryesisht ekonomia bujqësore është e përqendruar në pellgun e Drinit të Zi prandaj dhe kjo luginë quhet "Hambari" i Dibrës. Rajoni i Dibrës dallohet për prodhim të lartë të pemëvë frutore si mollë, qershi, kumbulla etj. E lidhur me prodhimtari të larta si dhe cilësore ne qytetin e Peshkopisë organizohen panaire të ndryshme si Panairi i Qershive në muajin Qershor, Festa e të Vjelave në Shtator etj.

Bota bimore

E lidhur me shtrirjen e lartë hipsometrike rrethi i Dibrës mbulohet nga 4 katet bimore. Duke qenë se kemi në studim turizmin malor, na interesojnë kati i ahut dhe halorëve dhe kati i kullotave alpine. Një pasuri e madhe e kësaj krahine janë livadhet dhe kullotat alpine. Shtrihen në lartësitë mbi 1500m të cilat zënë sipërfaqe shumë të gjerë prej 16.5% e të gjithë sipërfaqes së rrethit, ose 153 km katrorë. Më të njohura janë Bjeshka e Shehut, e Hynoskës, livadhet në parkun natyror Korab-Koritnik etj. Cilësia e lartë e kësaj flore ka bërë që të kemi prodhime blegtorale me emër si djathi i bjeshkëve të Korabit, Lumës, Gramës dhe Hinoskës për vetë cilësitë e larta që ka me shumëllojshmërinë, shijen dhe aromën, është shumë i kërkuar si në tregun vendas ashtu dhe për eksport. Turistët tërhiqen nga këto peizazhe nga ajri i pastër , shumëllojshmëria e botës bimore, uji i pastër dhe i ftohtë apo edhe sporte si gjuetia apo alpinizmi.

Bota shtazore

E lidhur me botën shtazore, turizmi konsiston në tërheqjen e të apasionuarve për sportin e gjuetisë. Kështu kjo zonë paraqet kushte të favorshme për gjuetinë e kafshëve të egra kryesisht në zonat malore ku aty kanë mundësi më të shumta për gjueti qoftë të kafshëve apo dhe shpendëve si thëllëza apo rosa të egra. Gjithashtu edhe pse është dëmtuar në masë, gjuetia e peshkut paraqitet si një sport zbavitës për të apasionuarit e tij, që mund të zhvillohet si në Drinin e Zi dhe degët e tij. Gjithashtu me mjaft interes është edhe trofta e malit e cila dallohet për mishin e saj të shijshëm.

ANALIZA E SITUATËS

Dibra na paraqitet si një krahinë mjaft interesante dhe tërheqëse për zhvillimin e turizmit malor. Oferta turistike na paraqitet mjaft e larmishme e cila përbëhet nga park kombëtar, park natyror, zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara, monumente të shumta të natyrës etj. Ndër zonat që paraqesin një diversitet të madh të këtyre burimeve natyrore mjaft tërheqëse për turistët janë Parku Kombëtar i Lurës dhe Parku Natyror i Korabit. Gjithashtu nuk ngelen prapa edhe liqenet e shumta akullnajore, luginat dhe kanionet e shumta apo livadhet dhe bjeshkët e shumta që ndodhen në krahinën e Dibrës.

Guidat më të zakonshme që përdoren nga turistët janë në Lurë dhe në malin e Korabit. Por, janë bërë dhe bëhen guida edhe jashtë këtyre dy zonave shumë të bukura turistike, si lugina e Setës, bjeshkët e Gramës, Ilnicës e Zagradit, duke u ofruar turistëve vendas e të huaj mundësinë për të shijuar bukuritë natyrore që ofron rajoni i Dibrës.

Pjesa më e madhe e vizitorëve të Lurës dhe Korabit janë turistë të vendit, ndërsa po zhvillohet shumë edhe turizmi ditor i favorizuar nga ndërtimi i rrugës Peshkopi-Kukës. Megjithatë është e domosdoshme nëse duam të zhvillojmë turizmin në këto zona që të rriten e modernizohen kapacitet e akomodimit, të hartohet plani urbanistik për këto zona dhe të këtë një parapërgatitje teknike-teknologjike për shërbimin në restorante.

Turet turistike më të zakonshme janë ato tre ditore, që zakonisht zhvillohen në fundjavë. Një tur i tillë drejt Lurës zakonisht fillon me qytetin e Peshkopisë. Të nesërmen bëhet nisja me makinë drejt Sinës, ku pasi vizitohet Muzeu i Skënderbeut, drekohet te lokali që kultivohet troftë artificiale në rezervatet me ujë të ftohtë nga burimet e Setës në fshatin Arras. Më pas vizitohet luginën e Setës drejt kishës së Don Markut, ku duket shpella e Sopanikës dhe bukuritë natyrore të lumit të Setës. Pastaj bëhet kthimi dhe flehet një natë në Arras dhe të nesërmen herët nisja për në Lurë. Turistët më të zakonshëm janë nga Çekia, Franca, Zvicra, Gjermania. Ata mahniten shumë nga natyra, nga bukuritë natyrore. Por, ato janë shumë të zhgënjyer nga infrastruktura rrugore. Rrugët që të çojnë drejt këtyre destinacioneve turistike lënë shumë për të dëshiruar.

Ushqimet zakonisht janë tradicionale. Buka është e gatuar në kushtet e shtëpisë si dhe gjithë produktet që ofrohen janë bio. Një drekë është pranë lokalit të peshkut në Arras, ku ofrohet peshk i freskët, troftë, si dhe sallata të stinës. Pastaj, sipas vaktit, ofrohet pulë me koranajk, turshi natyrale, djath dhie, fruta të stinës (mana, qershi), raki fshati, verë fshati dhe shumë produkte të tjera të cilat shumë nga vizitorët i provojnë për herë të parë. Mëngjesi është shumë i bollshëm: bukë çerepi me saç, qumësht, çaj mali, gjalpë, reçelra të ndryshme, mjalt i sapo vjelur. Dreka, po ashtu është tradicionale: mish qengji ose keci të skuqur, në hell ose në zgare, sipas dëshirave të personave.

- Parku Kombëtar i Lurës

Lura me relievin e saj të larmishëm, monumentet e shumta të natyrës, shumëllojshmërinë e klimës dhe pasurinë e ujërave ofron mundësi të shumta për zhvillim në plan turistik. Resurse të shumta turistike mbart në vetvete në mënyrë të veçantë hidrografia. Ajo dallohet për pasuri të shumta ujore ku dallohen veçanërisht Liqenet e Lurës të cilat përfaqësojnë një nga bukuritë e natyrës shqiptare.

Ky park kombëtar shtrihet në faqen lindore të masivit " Kunora e Lurës" me një gjatësi 9.6 km. Lartësia minimale nga niveli i detit arrin 1375 m , kurse ajo maksimale 1919m (Kunora e Lurës). Sipërfaqja e parkut është 1280 Ha, nga e cila 1100 ha janë pyje, 50 ha livadhe, 30 ha pasqyra e ujit të liqeneve dhe 100 ha sipërfaqe shkëmbore. Lura është rreth 30 km nga Peshkopia, nga qyteti Kurbneshit rreth 30 km, afro 70 km nga qyteti i Burrelit dhe 160 km nga Tirana duke ndjekur aksin rrugor për nga Mirdita.

Padyshim që elementi gjeografik që e bën më të njohur këtë zonë janë liqenet akullnajore. Liqenet e Lurës janë një grup liqenesh akullnajore, shumë piktoreskë, të përhapur në një territor me siperfaqe 30 km^2, në zonën me formacione të papërshkueshme.

Zona ku janë të përhapur Liqenet e Lures shtrihet në lartësinë nga 1500-1800m mbi nivelin e detit. Liqenet kanë forma të rrumbullakosura, më i madhi nga të cilët është Liqeni i Madh me sipërfaqe afro 0.32 km2, pas tij vjen Liqeni i Pishave me sipërfaqe 0.13 km2, Liqeni i Zi 0.8 km2, Liqeni i Luleve 0.4km2, Liqeni i Gallabes, i Hotit, i Thatë , i Bruçit etj.

Për të përshkruar bukuritë që ofron kjo zonë turistike kemi përzgjedhur thënie të disa personaliteteve të shquara: *Kush nuk ka parë Lurën, nuk ka parë Shqipërinë"* kështu do ta vlerësonte bukurinë e kësaj zone At Gjergj Fishta. Studiuesja Edit Durham do ta cilësonte si *"Një ndër zonat më të bukura në Ballkan"*.

Reshjet e shumta të dëborës gjatë dimrit ku nga 100-136 ditë janë me reshje dëbore lidhur ngushte edhe me trashësinë e shtresës së dëborës që shkon nga 20-30 cm e deri në 130-178 cm në Fushë Lurë kanë krijuar mundësi që me peizazhin e bukur që krijohet te tërheqin turistë të shumtë, amatorë të turizmit dimëror që shfrytëzojnë mundësitë për ushtrimin e sporteve zbavitëse dimërore.

Freskia e klimës gjatë verës e ndërthurur me hijet e shumta që krijohen si rezultat i pranisë së madhe dhe të kudondodhur të pyjeve prej ahu e pishe, krijojnë mundësi për çlodhje e pushim. Në të njëjtën kohë në zonat përreth liqeneve krijohen kushte për turistët për të realizuar banjo dielli. Pra Lura mund të vizitohet në çdo kohë e çdo stinë.

Me gjithë bukuritë që i ka falur natyra, Parku Kombëtar i Lurës preket nga shumë problem kryesisht me natyrë humane. Tepër të shpeshta janë ndërhyrjet pa kriter të njeriut, veçanërisht në prerjen e drurëve të ndryshëm. Kjo ka çuar në dëmtimin dhe humbjen e territoreve prej ahu e dushku. Një problem shumë i madh mbeten zjarret kryesisht me origjinë humane, ku vetëm ato te vitit 2007 dhe 2012 kanë humbur rreth 30% e pyjeve në Lurë.

Një situatë e rëndë ekologjike, ku në qoftë se nuk do të ndërhyhet e të merren masa, është krijuar pranë liqeneve. Ndërtimi i digave e kanaleve ujëmbledhëse kanë krijuar mundësi që të favorizohen proceset e denudimit, që kanë çuar deri diku në humbjen e origjinalitetit të tyre. Fundi i liqeneve ka filluar të mbushet me materiale denuduese si dhe me drurë të rrëzuar dhe të prerë pa kriter në afërsi të liqeneve. Prerja e tyre në rrethinat bregore liqenore ka filluar që të jua prishë deri dikpamjen atyre.

Gjithashtu papastërtitë dhe mbeturinat e shumta të lëna nga vizitoret e ndryshëm që vijnë këtu ka krijuar probleme ekologjike për liqenet, pasi ato kanë filluar të prishin e cenojnë sipërfaqet e tyre ujore dhe ambjentet rrethuese.



Liqeni i luleve.
Foto © Gazmend Kërkuti, 2008.

cyan magenta yellow black



Pamje nga Kalaja e Dodës, vend ku janë shtuar dukshëm turistët gjatë vitit të fundit.
Foto © Bujar Karoshi.

- **Parku Natyror Korab-Koritnik**

Me vendim të Këshillit të Ministrave me datë 21/12/2011, vendoset shpallja e ekosistemit natyror malor Korab - Koritnik "Park Natyror". Ky park ka një sipërfaqe të përgjithshme 55 550.2 ha, nga të cilat në rrethin e Kukësit janë 34 886.8 ha dhe në rrethin e Dibrës janë 20 663.4 ha. Autoriteti shtetëror që ngarkohet me administrimin e zonës së mbrojtur, janë strukturat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe administratat ekzistuese të sektorëve pyjorë (Kukës e Dibër), që përfshihen brenda sipërfaqes së parkut natyror.

Pjesën kryesore të territorit e zënë sipërfaqet me kullota e livadhe, të ndjekura nga sipërfaqet pyjore e me bimësi pyjore, sipërfaqet joprodhuese, sipërfaqet bujqësore, si dhe sipërfaqet urbane e troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore.

Ky territor karakterizohet nga një shumëllojshmëri formash të relievit të shoqëruara me formacione të mëdha shkëmbore, pjesa më interesante e të cilave janë formacionet e gjipsit mbi të cilët është instaluar bimësia pyjore në kushte relativisht të vështira, duke krijuar në këtë mënyrë një ansambël magjepsës natyror me efekte të mëdha panoramike

Sipërfaqja paraqet një larmi formash të terrenit me shpate të thepisura, lugina dhe kanione të thella, me fomacione gjipsesh të dala në sipërfaqe si edhe rrafshnalta të vogla të pasura me bimësi barishtore e bimë shumëngjyrëshe, në trajtën e bjeshkëve. Lartësia minimale është 850m mbi nivelin e detit dhe ajo maksimale 2751m (maja e Korabit). Një konfiguracion i tillë i relievit mundëson zhvillimin e turizmit elitar malor dhe alpin. Për këtë do të ishte i domosdoshëm zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme si pjesë integrale e një plani të përgjithshëm menaxhimi pas shpalljes si zonë e mbrojtur.

Sezoni kryesor turistik në Korab fillon nga mesi i muajit Qershor dhe zgjat deri në fund të muajit Gusht. Turizmi familjar në këtë komunë ka tendenca të zhvillimit por duhet të krijohen kushte për zhvillimin e tij. Shfrytëzimi turistik rreth zonës së malit të Korabit ka pasur karakter privat e individual. Komuna Kala e Dodës është destinacion turistik që posedon vlera turistike të afirmuara, të cilat paraqesin potencial të rëndesishëm turistik dhe aktivizimi i tyre duhet të jetë njëri nga imperativët e zhvillimit të përgjithshëm në periudhën e ardhshme.

Asetet më të mëdha të kesaj komune, sa i përket zhvillimit të turizmit janë pasi zona shquhet për pozitën e shkëlqyer gjeografike, me klimën e shëndetshme, fondin e pasur me florë dhe faunën, sipërfaqet me ambient natyror të ruajtura dhe ushqim të shëndetshëm, masivet malore me kushte të përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore, traditën e mikpritjes dhe folklorit etj.

PERSPEKTIVAT E TURIZMIT

Turizmi konsiderohet kudo si një nga veprimtaritë me zhvillim dinamik, pasi në përgjithësi për të ka një treg me kërkesa mjaft të larta gjithmonë në rritje duke përbërë njëherësh edhe një burim të ardhurash dhe punësimi.

Vitet e demokracisë nuk është vënë dorë për problemet e turizmit, nuk ka patur asnjë lloj investimi ku gjithçka i është lënë spontalitetit. Në sajë të ndryshimeve të fundit të kryera si në infrastrukturë rrugore apo në hoteleri dhe shërbime po vihet re një rritje e ndjeshme e numrit të turistëve

Me mundësitë e shumta që i ofrohen këtij rrethi perspektivat e turizmit paraqiten mjaft interesante. Peizazhi gjeografik na paraqitet mjafi i larmishëm. Kështu relievi me format e tij të larmishme ofron mundësi të shumta për alpinizëm dhe turizëm aventurier. Ky lloj turizmi mund të zhvillohet pothuajse në të gjithë zonën pasi Dibra është një zonë kodrinore-malore e rrethuar me male nga të gjithë anët.

Që rrethi i Dibrës të kthehet në një destinacion të rëndësishëm turistik do të duheshin të merren disa masa konkrete dhe të mënjëhershme si: pregatitja e guidave turistike nga specialistët e fushës duke bërë që ato të jenë sa më cilësore, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, furnizimi me energji elektike dhe ujë të pijshëm në mënyrë të vazhdueshme si dhe shtimi i kapaciteteve si në cilësi ashtu edhe në sasi. Masë tjetër që duhet marrë domosdoshmërisht është vendosja e tabelave qe të tregohet destinacioni turistik si dhe largësia nga pika e nisjes

Por që të zhvillohet turizmi, që resurset e mrekullueshme të jenë efektiva për banorët e rrethit apo më gjerë, duhet një investim në të gjitha drejtimet, veçanërisht në infrastrukturë. Si parantezë shtrojmë pyetjen: Kush është ai dibran, banues në qytetin e Peshkopisë apo fshtarat rreth tij që nuk do të shkonte në liqenet e Lurës nëse rruga do të ishte e shtruar?! Që turizmi të mos kthehet në një "ëndërr" të humbur të zhvillimit ekonomik, duhet menduar dhe vepruar për një strategji të prezantimit të resurseve turistike por edhe një prezantim të banorëve mikpritës e guidave në terren, në mënyrë që turistët që udhëtojnë mijëra kilometra larg, të mos bien viktimë.

Kapacitetet pritëse

Zona e Dibrës ofron mundësi për akomodim që nga hotelet modern deri në ato familjare. Këto hotele ofrojnë shërbime të ndryshme si: ekskursione turistike të drejtuara nga persona (me makinë ose kafshë), ekspedita gjuetie dhe transport. Shumica e këtyre hoteleve kanë restorante që përdorin kuzhinën tradicionale shqiptare (dibrane) dhe shërbejnë ushqime nga produktet që kultivojnë vetë dibranët. Shumë të kërkuara nga turistët jane prodhimet blegtorale që prodhohen nëpër stane si djathë i bardhë, gjizë apo gjalpi.

Nga të gjithë kartëvizitat e mbledhura të hoteleve rezulton se çmimet mesatare për një person janë rreth 10 000- 15 000 mijë lekë të vjetra për familje. Keshtu vetëm ne qytetin e Peshkopisë janë të liçensuar për këtë aktivitet ku përmenden Hotel Veri, Alpin, Ballkan, Korabi, Natyra e Qete, Zerja, Brazili, Klajdi etj. Gjithashtu janë ndërtuar vitet e fundit hotele luksoze në Lurë si dhe afër Bushtricës në rrugën nacionale Peshkopi-Kukës.

Gjithashtu janë ndërtuar dhe 5 shtëpi alpine në Bjeshkët e Hynoskes ku çmimi është 10 000 mijë lekë për person. Ndërsa pushuesit që vijnë për tu kuruar në Llixhat e Peshkopisë rreth 95% e tyre akomodohen nëpër shtëpitë e banorëve të zonës përreth me çmime të arsyeshme rreth 10 000 lekë nata ku përfshihen ushqimi, fjetja dhe transporti brenda kësaj pakete.

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Që rrethi i Dibrës të kthehet një qendër e rëndësishme e turizmit ku nga vetë fakti që dhe terreni i saj është kryesisht malor, përparësi merr turizmi malor dhe ai aventurier. Prandaj që turizmi të rritet ndjeshëm duke u bërë kështu edhe një burim të ardhurash për banorët e këtyre zonave turistike dhe më gjerë, po paraqesim disa rekomandime për një turizëm malor më të zhvilluar në vitet në vazhdim:

- Ndërtimi sa më shpejtë i Rrugës së Arbërit do të zgjojë interes për zhvillimin e turizmit për shkak të afërsisë me kryeqytetin me mundësi lëvizjeje më të shpejtë e kosto më të ulët. Një pjesë e mirë e banorëve të zonës metropolit Tiranë-Durrës janë ish banorë të kësaj zone dhe do jenë të interesuar të jenë vizitorë të saj.

- Ndërhyrja sa më shpejtë në infastrukturën rrugore ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja. Të paktën duhet të jenë të asfaltuara rrugët që lidhin qendrat e komunave me qytetin e Peshkopisë. Gjithashtu duhen bërë përmirësime sidomos në ujin e pijshëm dhe sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Përgatitja e një guide turistike cilësore ku të bëhet propaganda për vlerat turistike të zonës. Të kryhet ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet flet-palosjes, medias së shkruar dhe elektronike për rëndësinë e pasurive natyrore dhe ndalimi rreptësisht i zhdukjes së specieve të rrezikuara apo dëmtimi i mjedisit.

- Trajnimi i kapaciteteve njerëzore në pritje të turistëve. Informimi i publikut me të adhurat dhe efektet që sjell zhvillimi i sektorit të turizmit.

- Të hartohen politika të qarta në mbështetje të këtij sektori dhe plane për shfrytëzimin sa më të mirë të këtyre burimeve. Por zgjidhja e këtyre problemeve do të kërkonte investime të mëdha monetare dhe një bashkëpunim te mire midis aktoreve brenda dhe jashtë vendit

- Promovimi i vendeve turistike nëpërmjet reklamave. Do ishte shumë efektive krijimi i ofertave dhe uljeve me çmime të arsyeshme për turistët në kohët që kërkesa turistike është në nivel të ulët.

- Përmirësimi i kushteve të banesave e kampeve ekzistuese, gjithashtu duhet të bëhen investime edhe për ndërtimin e banesave të reja me kushte komode duke iu përshtatur standardeve ndërkombëtare. Këto ndërtime duhet të përmbajnë edhe në plotësimin e kushteve të tjera për argëtimin e pushuesve si pista per rrëshqitje me ski, ndërtimi i teleferikeve, ambiente për ushtrimin e aktiviteteve sportive etj.

- Kualifikimi në kurse dhe shkolla verore pë personat që do te shërbejnë në industrine turistike të zonës duhet të përfshihet në planet investuese per zhvillimin turistik të kësaj zone. Gjithashtu duhet të mësojnë edhe gjuhën e huaj për komunikimin me turistët.

Që turizmi të mos kthehet në një "ëndërr" të humbur të zhvillimit ekonomik, duhet menduar dhe vepruar për një strategji të prezantimit të resurseve turistike. Por edhe një prezantim të banorëve mikpritës e guidave në terren, në mënyrë që turistët që udhëtojnë mijëra kilometra larg, të mos bien viktimë.

Nga një analizë e faktorëve dhe elementëve që kane ndikuar në turizëm ne zonën tonë të studimit, kemi dalë në disa përfundime paraprake:

- Turizmi malor në Dibër na paraqitet i larmishëm me format e tij si: aventurier, sportiv, balnear, agroturizmi, rural dhe religjioz.

- Dallohet për një trashëgimi mjaft të pasur natyrore ku më të kërkuara nga turistët janë Parku Kombëtar i Lurës dhe Masivi i Korabit. Me gjithë dëmtimet e shumta që kanë pësuar përsëri paraqiten si destinacione turistike mjaft interesante dhe të kërkuara.

- Një pasuri me potenciale të mëdha janë livadhet dhe kullotat alpine. Më të njohura janë Bjeshka e Shehut, e Hynoskës, livadhet në parkun natyror Korab-Koritnik etj. Turistët tërhiqen nga këto peizazhe nga ajri i pastër , shumëllojshmëria e botës bimore, uji i pastër dhe i ftohtë apo edhe sporte si gjetia apo alpinizmi.

- Rol në madh në ofertën turistike luan klima dimrit. Reshjet e shumta të dëborës krijojnë mundësi që me peizazhin që ofrohet të tërheqin amatore të turizmit dimëror për ushtrimin e sporteve zbavitese.

- Periudha që është më e frekuentuar nga turistët është kryesisht gjate verës kryesisht në muajt Qershor-Shtator. Kjo për vetë faktin se gjatë dimrit është e veshtirë arritja në këto destinacione malore.

- Për numrin e madh të turistë të huaj mbizotërojnë ato të nga Çekia, Austria, Hollanda, Italia etj. Pjesa më e madhe e tyre vijnë nga itinerari Kukës-Peshkopi nga ndërtimi i rrugës së re automobilistike.

- Oferta turistike nuk shfrytëzohet siç duhet dhe sa duhet. Në mjaft zona problem mbetet gjendja e infrastrukturës rrugore, akomodimi i turistëve, plotësimi i nevojave të tjera si ushqime, energji elektrike e dobët ose mungon fare, mungesa e ujit të pijshëm, kërcënimi i turistëve nga banorët e zonës.

- Shumica e turistëve janë të kënaqur nga ushqimet tradicionale të zonës. Kryesisht ato kërkojnë ushqime blegtorale të freskëta nga stanet e shumta të Dibrës.

- Mungesa e aftësive profesionale dhe e burimeve njerëzore të kualifikuara ndikon që një përqindje turistësh nuk janë të kënaqur me shërbimet e ofruara. Kjo ka bërë që këto destinacione të mos jenë më në preferencat e tyre.

- Resurset humane janë një faktor i cili ndikon negativisht në zhvillimin turistik pasi është një zonë e prekur mjaft nga shpopullimi apo migrimi i popullsisë në moshë të re.



Liqeni i Dibrës së Madhe.
Foto © Tiron Dika.

Burimet e shfrytëzuara

AECID: *"Potencialet dhe tendencat e zhvillimit bujqësor të Dibrës"*, Peshkopi 2009.

Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: *"Gjeografia Fizike e Shqipërisë"*, Vëllimi I dhe II, Tiranë 1991.

Ashiku, Abdurahim: *"Po Dibrës! Jo Skavicës!"*, Botimet M&B, Tiranë 2010.

Axhemi, Sokol: *"Lura-Morfologjia dhe morfogjeneza e pjesës qëndrore"*, Camaj-Pipa 1997.

Bashkia Peshkopi *"Peshkopia"*, Guidë turistike, Tiranë 2010.

Bashkia Peshkopi: *"Plani lokal i veprimit për biodiversitetin"*, Peshkopi 2010.

Daci, Fatos: *"Enciklopedia e Dibrës"*, Vol.I, AlbGraf, Maj 2006.

Doka, Dhimitër dhe Draçi, Bilal: *"Gjeografia e Turizmit"*, Tiranë 2006.

Dollma, Merita dhe Pazari, Florina: *"Potenciali turistik në Qarkun Dibër dhe menaxhimi i tij"*. Tiranë 2010.

Federate e pyjeve dhe kullotave komunal, Qarku Dibër: *"Visit in the crown of Peshkopi"*, 21 October 2011.

Lidhja e Historianëve Shqiptarë Dibranë: *"Dibra dhe etnokultura e saj"*, Vëllimi I dhe II, Dibër e Madhe 1995.

Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 *për "zonat e mbrojtura"*.

Ligji Nr. 9734, datë 15.05.2007 për *"turizmin"*.

Materiale të marra në Këshillin e Qarkut Dibër në Drejtorinë e Zhvillimit Rajonal. Maj 2013.

Materiale të marra nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Dibër, Shtator 2012.

Plani i Zhvillimit Strategjik: *Bashkia Peshkopi dhe 14 komunat e Rrethit Dibër"*.

Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë: *"Rruga e Arbërit"*, Dita 2000, Tiranë 2007.

UNDP: *"Nxitja e zhvillimit rajonal nëpërmjet objektivave të mijëvjeçarit. Qarku Dibër"*.

UNDP: *"Shqipëria, kapacitetet për zhvillimin rajonal në terren"*, Dhjetor 2011.

Vendim Nr.898, datë 21.12.2011 *"Për shpalljen e ekosistemit natyror malor Korab-Koritnik: Park Natyror"*.

cyan magenta yellow black



Radomirë, Radomirë, peng në zemër më ke mbetë...

Nga JAHJA DELIA-SELMANI

Ngjan ky titull me vargun e këngës për Radomirën të kënduar me aq ëmbëlsi e jo pa nostalgji nga Arif Madana, por ajo thotë:"Siç ke qenë, ashtu ke mbetë". Ndofta do të ishte më me vend të thuhej siç e thashë në titull, por atë e di vetë autori dhe, e dini pse? Përgjigja do të ishte se Radomira e bukur atje në shpatet e Korabit ka mbetur ashtu e dashur në zemrat e të gjithëve dhe jo në kuptimin se ajo nuk ka ndryshuar këto vite kur shumë janë larguar nga ajo. Përkundrazi, ajo po ndryshon çdo ditë, bjeshkët e **Radomirës e të Kalasë së Dodës** po mbushen çdo vit me mijëra krerë dele më shumë, bizneset po shtohen, baxhot nuk po arrijnë të plotësojnë kërkesat e tregut në Tiranë, numri i turistëve nga brenda e jashtë po shtohet dhe kushtet për t'i pritur po vihen në udhën e zgjidhjes. Kush ka udhëtuar në Radomirë, ka parë lokalet që po bëhen më të kërkueshëm, se në to po rritet kultura e shërbimit. Shërbehet me çdo gjë dhe, në lokalin e Sutki Ahmatit e të Haxhi Himës, nuk mungon kurrë dhe pjata me djathin e freskët të sapo prodhuar nga mjeshtrat **Hysen Tabulli e Sulë Ahmati**. Le që të bësh vizitë në baxhot e tyre ku çdo ditë grumbullohen mbi 60 kv. qumësht delje, as mos e mendo se mund të dalësh pa e provuar djathin e Korabit. Trashëgohet tradita, se në **stanet** e Radomirës e të Kalasë së Dodës nuk kalonte udhëtar, i njohur e i panjohur, pa u gostitur me kaçamakun me kos dele që duhej prere me thikë, me kajmakun që nuk ishte vetëm ushqim, por dhe ilaç, se kishte brenda nektarin e bjeshkëve të Korabit

Shumë mund të flasim për Kalanë e Dodës, por le të shkrujmë kësaj herë për festën e përvitshme të Radomirës, ***Festën e Korabit*.**

NISJA

Gjithkush e vu re se nisja këtë vit qe më e thjeshtë, jo me grumbullim në orën e caktuar në Paskuqan. Kjo u vendos nga kryesia e Shoqatës "Korabi-Radomirë", pasi nuk ishte shumë e domosdoshme, tani data dihej dhe u ndryshua vjet me qëllim që të mos ndeshemi me të ftohtin e borën e dy viteve të para. Shumë pjesëmarrës mund të vijnë dhe pasdite ose dhe në mëngjesin e datës **7 korrik,** se për tri orë arrin në Radomirë.

Por shumë u grumbulluan përsëri në Paskuqan te lokalet e Lavdrim Ahmatit e të Abdyl Kupës. Dhe, pas kafesë që na dha Fejzullah Ahmati, bëjmë dhe nisjen. **Rruga e Kombit** i shkurtoi distancat, por, po pate bashkudhëtar Fejzullain, ajo shkurtohet dhe më shumë. Shumë i këndshëm, shumë shakaxhi e plot kujtesë.

Në **Kukës** gjejmë Hajredin e Arif Madanën me Fatmir Dakun, kanë udhëtuar bashkë dhe te tavolina e tyre pushuam afro gjysmë ore ku Fatmiri me shakatë e kripura, por dhe me një gotë raki përpara, na kënaqi.

Tani udha drejt Kalasë nuk është si një vit më parë kur pjesë të shumta në vendet më të vështira nuk kishin përfunduar, tani makinat ecin lirshëm. Por kthesat e kësaj rruge pak janë eliminuar duke e kthyer shpesh ecjen në monotoni.

- Ne kërkojmë shumë,- bëjmë shaka me njëri-tjetrin,- tani që vijmë për tri orë në Radomirë, bëjmë dhe llafe. A ju kujtohen këto udhë kur i bënim në këmbë dhe duheshin 8 orë të mira për të ardhur në Kukës?

Ky argument të ul menjëherë, por njeriu kërkon gjithmonë, ne tani kërkojmë **Rrugën e Arbrit,** që të vijmë në Kalanë e Dodës për dy orë. Sa çudi, për dy orë!... Dhe të mendosh se për dy orë ishte e vështirë ta bëje udhëtimin nga Radomira në Bushtricë apo në Sllovë... Por kohët ndryshuan, dhe ndoshta premtimet nuk do mbeten vetëm elektorale...

Me këto muhabete e pamë veten në **Vasie,** fshati i parë i Kalasë që ndiqet pastaj nga **Poshtani,Dodet, Shullani** që i fshihet shikimit i mbuluar nga rrëpirat e dushqet, për të vijuar me **Cerenin a Carenin**, se kështu është thirrur në shekuj. Seç kemi një mani apo vartësi të pashpjegueshmë për të kthyer në "**standard"** edhe toponimet që janë dëshmia më e parë e origjinës sonë... I kemi kuptuar mbrapsh disa gjëra. Nejse.. Në Vasie ta "zë rrugën" lokali "Lamallari" që me mishin e qëngjit të pjekur në saç të bën rob të një dreke të paharrueshme.

"TË MË QESË ZOTI TE QAFË E KALASË..."

Mu kujtua vargu i parë i një këngë të zonës që e kishim dhe në repertorin e festivaleve që bënim dikur. Dhe na qiti Zoti te kjo Qafë me plot histori, plot kujtime e plot këngë. Fusha e Kalasë, Qafa e Kalasë, Tabja e Nizamëve, Fusha e Dode e vetë Kalaja na shfaqen si surprizë e këndshme. Te **Qafa e Kalasë** menjëherë të shfaqet Korabi e fort pak fshati Rade që, së largu njëjtëzohet me malin ngjyrë errët. **Bjeshka e Preshit** sikur nuk e ka ndier se ka ardhur korriku, thuajse 1/3 e saj është plot borë. Ne që jemi rritur në këto vise nuk na bën përshtypje, por disa miqve të ardhur nga Tirane, Durrësi etj u duket habi. Sa i bukur duket **Korabi** me borë, atij i ka hije dhe tani bora. E, fatkeqësisht kësaj here nuk e mbajtëm fjalën për ta bërë Festën në Preshin madhështor me ato guvat plot borë, me ato liqenet me moshë milionavjeçare, me ato burimet e kristalta që sivjet gurgullonin si asnjëherë dhe tani në korrik, me ato... po e lë numeracionin se lista do të ishte shumë e gjatë. Nuk e bëmë në **Presh,** por, me shumë të drejtë reaguan Zenuni, Ibrahimi, Shkëlqimi, Fatmiri etj., se ata për aty ishin përgatitur. U kërkova falje, deri diku më kuptuan, por ky duhet të jetë mësim për herë të tjera, vendimi që merret, duhet të zbatohet, se **Radomira** për këto gjëra ka qenë e para, kështu do të vazhdojë, se bijtë e saj, kudo që janë, në këtë udhë po ecin.

Kjaveci ose **Kiaveci** që duhet ta ketë prejardhjen nga brumi i vetë shqipes: nga fjala qa (me qa, me ka, me alternimine k në q, se në të folmen e Kalasë thuhet dhe **Qaveci**) na shfaqet me një bukuri të pashoqe. Thirret kështu se, përveç kodrës së thatë e të mbushur me mështeknën e bardhë ruse të mbjellë mbi 70 vite më parë, rrotull ka shumë burimë, toka "qan" kudo.

Syri udhëton para këmbëve, në këto vise gjëmon historia, lashtësia e këtij toponimi **"Kala"**i kalon të dhënat historike, të paktën ato që njohim deri sot. "Kala e Qafës","Qafa Bilbil", "Kala e Dodës", tri emërtime që ngjallin diskutime, por që argumentojnë mendimin më të përgjithshëm se këtu ishte një Kala, ndofta me përmasa të vogla, por jo me histori të vogël. Themi kështu se thuhet se kush merrte këtë vend strategjik, i kishte nën vete Dibrën e Lumën, për vetë pozicionin. E këtë e vëren dhe njeriu më i thjeshtë, këtë e provuan dhe mbretërit që nga lashtësia, këtë e provon dhe toponimi" **Tabja e nizamëve"** jo shumë larg vendit që quhet Kalaja e Dodës. Bjeshka e Carakolit që ngrihet si një fortesë natyrore ka qenë jo vetëm vend ku kjo krahinë u ndesh me armiq të ndryshëm, por dhe një udhë kalimi për ushtritë e pushtuesve të ndryshëm që nga lashtësia. Nuk janë pa domethënie toponimet**"Kroi i Mbretit", "Rrasa e Mbretit**" etj.

Bri kodrës së Kiavecit deri para ca vitesh ishte shkolla e Ploshtanit, tani e transferuar pak më afër fshatit në një godinë të re e me kushte të mira.Shkolla e dikurshme qe krenare për ata brez nxënësish që u edukuan aty nga mësues mjaft të përkushtuar që bënin disa orë udhëtimi në ditë, në verë e në dimër. Tradita e kësaj shkolle shkon thellë ne dhjetravjeçarë kur në shtator të vitit **1922** u hap e para shkollë në Ploshtan me fëmijë të ardhur nga Kalisi,Bushtrica, e deri në Çajë e Buzmadhe. Një mësues i përkushtuar, **Besim Dalliu** nga Tirana dha mësim për t'u ndjekur nga një brez i tërë mësuesish nga Elbasani, Shkodra, Dibra,Kukësi etj për të ardhur te mësuesi i paharruar **Qamil Hoxha** që, deri sa vdiq, nuk linte rast pa e vizituar.E sheh sot vendin ku ishte godina e vjetër e djegur para disa vitesh dhe na kalojnë para syve e na duket se u dëgjojmë zërin një brezi të tërë mësuesish që profesionin e kthyen në art të të dhënit mësim e edukim si të ndjerët *Maliq Lika, Shemsi Hysa, Xhemal Cala, Ismet Sinani, Sulejman Istrefi,Rramiz Shehu, Nezim Deda e Ramadan Gjorllaku* emrin e të cilit e mban shkolla sot.Këte e shumë të tjerë që sot punojnë apo janë në pension, në Kala apo ne Tiranë e Durrës kujtohen me një respekt të merituar nga ishnxënësit e komuniteti.

Ploshtanasit na shohin e na përshëndesin me respekt, janë një popull shumë dashamirës e punëtor, kjo duket dhe nga ajo punë plot sistem që bëjnë në arat e tyre. Janë shpërndarë nëpër livadhet, që këtë vit po japin një prodhim të mbarë,gjë që u garanton një dimërim pa telashe. Sa popull me sedër ky populli i Kalasë së Dodës! Nuk dua ta mburr, pse jam lindur e rritur aty, por faktet flasin. Dimrat më të ashpër e të gjatë bëjnë në Kala ku Korabi bën gjëmën në ditët e veta, por a keni ndier ndonjëherë të ankohen e të kërkojnë furnizim nga shteti në ditët kur bllokohen rrugët? Para dy vitesh kur ishte një dimër i madh dhe u dërguan pako me ushqime me helikopterët e ushtrisë, asnjë nuk i merrte dhe pyesnin:"Kush ju ka kërkuar ushqime, ne i kemi siguruar ato gjatë verës, se dimri është i përhershëm te ne e nuk ra borë në gusht". Mezi u gjet një përfaqësues i pushtetit vendor për t'i marrë në dorëzim.

U ndalëm pak në **Ploshtan** ku kujtimet janë të shumta e duhet shumë letër për t'i shkruar, por, parase të vijojmë udhën për në Radomirë, besoj se do të më falni për rreshtat që po shënojmë e kohën që po ju humbas për ta devijuar pak rrugën nga ***Kodra e Kalasë. . . .***

NË "PALLAZGE"...



Ndonjeri do të kalojë në habi, por mos u çuditni për këtë emër. Edhe unë nuk e kisha ditur, por në bisedë me shokun e kolegun **Beqir Shehu, bashkëpunëtor i vjetër shkencor,** që është i pasionuar pas historisë e, sidomos, pas asaj të Kalasë, ma përmendi këtë fakt. Ky toponim krejt interesant, është mes lagjes **Beshe** të Shullanit e varreve vjetra të Ploshtanit. Nuk duhet të pyesim veten pse e si ka mbetur ky emër, se populli nuk gabon, por duhet ta pyesim pse ka kaluar ky emër në heshtje? Tani e dimë të gjithë se pellazgët, ky **popull hyjnor,** janë të parët tanë të drejtpërdrejtë, se ata janë **Ilirët**, se ata janë shqiptarët e lashtë, se ata i dhanë këtë gjuhë hyjnore **Racës së Bardhë** etj. etj. Sa do të krenohej një vend tjetër me këtë emër! Por ne shqiptarët jemi modestë, nuk kemi nevojë të identifikohemi të tillë, se jemi të tillë. Ata që duan të na fshehin origjinën, le të flasin, le të shpenzojnë miliarda dollarë për t'u quajtur më të vjetrit e Ballkanit apo të Evropës. Shkenca gjuhësore dhe historia e kanë thënë e vazhdojnë ta thonë fjalën e tyre. E ky emër i thjeshtë thotë shumë, ndofta thotë më shumë se shumë vëllime, ndofta ky emër do t'ia lehtësonte punën **Tunmanit, Hahnit** që për Kalanë e Radomirën shpreh të vërtetat e simpatitë e veta, **D'Anzhelysë** që aq shumë bëri për tezën e shqipes si gjuha e Racës së bardhë, **Matias Arefit** (Arifit nga Mati) etj.

Po sa fakte fshihen ne të folmen e **Kalasë,Lumës, Dibrës** etj. në **leksik, në fonetikë** etj., që flasin për lashtësinë e kësaj gjuhe e ne akoma u kalojmë anash? Në këtë kohë globalizmi të gjithë duhet të jemi më të ndieshëm ndaj hulumtimit të çdo shkëndije që ndriçon sadopak lashtësinë e kësaj gjuhe që është vetë lashtësia e historia e këtij populli.

Me këto mendime dhe mes zhurmës që bëjnë makinat që parakalojnë njëra-tjetrën arrijmë në Ceren, ata përrënjtë e dikurshëm që ishin tmerri i makinave, kalohen pa asnjë vështirësi prej asfaltit që ngjan si një shtresë e butë dhe e zezë. Cereni i dikurshëm që ishte dhe qendra administrative e Kalasë, nuk e ka zhurmën e gjallërinë e dikurshme, shumica e njerëzve kanë ikur në Tiranë e Durrës, bile në Rrushkull,Sukth kanë krijuar një Ceren të dytë, me vlera të shumta ku kanë fituar një respekt të madh te vendasit. Në sipërfaqet e mëdha të tokave që kanë blerë, prodhojnë shumë dhe mbajnë shumë bagëti. Por dhe cerenasit tani po bëjnë traditë atë që bën Radomira, vijnë të organizuar në Sorokol apo **Carakol**, siç e thotë populli e që duket se ka një rrënjë me emrin **Caren.**

→



CEREN-RADOMIRË OSE ZHGËNJIMI I NJË RRUGE

Asfaltit të ri që vijon për Peshkopi i vjen fundi, se ne marrim kthesën për Radomirë. Te shtëpia e Avzi Vishës, rruga tjetërsohet. Sa shumë premtime u dhanë, bile Kryeministri Berisha e përmendi jo vetëm në Kala, por dhe në takime të tjera në zona të tjera. Duket si një peng i mbetur, nuk dimë si do të jetë e ardhmja e rrugës, por shpresojmë shumë që dhe ky degëzim aq jetik për Radomirën do të bëhet, nuk janë shumë kilometra, rruga do të shtojë numrin e turistëve që, sa e marrin këtë degëzim, u ik dhe entuziazmi që i ka shoqëruar gjatë Rrugës së Kombit dhe asaj Kukës-Bushtricë..

Nga **Gjuri i Gjatë** që ndan dhe Carenin me Radomirën hapet një panoramë e papërsëritshme, duket Shullani, Kalisi, Reçi, Dardha e Malet e Lurës, më afër, mes dushkut të harlisur e gjelbërimit, **thanat e Reçe** që pas pak kohe do ta skuqin e ëmbëlsojnë vendin me shijen e tyre. Ndalemi pak që të sodisim, kohën e kemi pa racion.

- Ç'po shikon? - dëgjoj zërin e Fezullait pas shpine.

- Shumë gjëra e ngjarje më dalin para syve kur jam apo sodis **Çernjevën**,- i them.- E sheh pjesën e Gipsit me atë udhën tërthore?

- E ka fjalën për **Vaçkën e Musdake** ku para disa qindra vjetësh u strehuan njerëzit prej Murtajës?

- Po,- i them kur dëgjova sa shumë ishte i informuar,- por para syve kam atë vendin ku usta Njazi Ferati kishte ata dy mullinjtë që punonin si sahat, se flori i kishte duart.. Kishte dhe **vavicën** ku shkeleshin qashnat me lesh delje (kashnajket). Sa keq, ku janë tani ato vlera? Brezi i ri nuk i njeh. Djali Njaziut, **Kujtimi** e vijoi zanatin e babës, por në drejtim tjetër. Në Tiranë ka biznesin e tij me dru për mobilie e është shumë i kërkuar.

- Ndofta pak veta e dinë që ajo shprehja: "Mos e grraj (gërruej, kërko) ma poshtë, se të del gjizë" e ka burimin këtu. Shumë të rinj u çuditën kur morën vesh se dikur në Çernjevë, andej nga kalon dhe rruga, bëhej pazar dhe vetë emrin e ka "**Fusha e pazarit**".Sigurisht ndonjë shitës bulmeti ka dashur ta shesë gjizën për gjalp.

Syri kënaqet me këto pamje që duan kohë për t'i përshkruar, por duhet theksuar se sa shumë ka dhënë Çernjeva për intifakun e Radomirës e se ka pas burra me vlera si vëllezërit **Vehbi e Tahir Ferati**, teologë me vlera jo vetëm krahinore e nga kjo familje përsëri vazhdon tradita me **Imerin e Besimin** deri te brezi i tretë, **Rushitin** me shkollim të plotë fetar, **Basri Selmanin** që e mbajti gjallë, bile e ushtronte dhe në vitet e diktaturës. E shumë burra e intelektualë me vlera nxori Çernjeva si Selim Daku, Isuf Ferati, Mehmet Kupa, Sefedin Daku, Rifat Selmani, Vehap e Lefter Daku, Kalosh Ferati, Ajet Selmani etj.

Vrajza është vendi ku shtrihen plot parcela me bar e jonxhë që këtë vit kanë prodhim të mbarë. Pas asaj urës që çuditërisht u ka rezistuar stuhive, vjen **Derbaçi** me një shtrirje nga ultësira e Veleshicës që dikur vlonte e gjallëronte nga mullinjtë e vavicat e shumta, deri te **Gjuri i Llangit** që është mes pishave të Tejsit. Shtëpitë e lagjes së epërme nuk janë bosh dhe mbulohen nga gjelbërimi i pemëve që bëhet njësh me atë të pishave plot bukuri. Një fakt interesant m'u kujtua kur hodha sytë nga shtëpia e **Fetah Domit**. Ishte afër shekullit dhe një problem kufijsh mes fshatrave po degjeneronte në grindje. Fetahi i dinte shumë mirë kufijt, por ai tani e kishte humbur krejt shikimin. Por njeriu me vlera i ruan ato dhe në atë gjendje.

- Më vini në kalë, - u tha djemve, - se e tregoj unë kufirin. Ashtu vepruan. -Më çoni te guri. . . Më ktheni në drejtimin nga Carakoli. . . "Nga ky vend duhet të duket ky vend, në të djathtë ky vend, në të majtë vendi tjetër etj. Të tjerët me sy ia vërtetonin pa asnjë ndryshim. S'pati as fjalë, as grindje. Sytë e mendjes. . .

Kujtesa të çon dhe te ata burra që nderuan Radomirën si **Mustafë Baloshi** që thuhet se ishte përkrah Brahim Gjorgjit kur u vra dhe mori flamurin nga duart e tij dhe u plagos dhe vetë. Qe i përmendur dhe fisi **Shavelli**, apo Masllam Domi e më vonë të tjerë si Hysen Domi, Adem Domi që i shërbeu 30 vjet natë-ditë jo vetëm Radomirës, dr.Hasan Domi, Hafuz Domi me gradë Dr. dhe plot të ardhme në punën shkencore etj.

Te bërryli që quhet **Kutell** shihet në pëllëmbë të dorës fshati **Rade** që i ngjan një gadishulli mes Veleshicës e **Rekës**, përballë shtrihet mali me pisha që ruhet me fanatizëm. Shtëpitë e grupuara, rrugicat e pastra, pemët e shumta e tregojnë si një pikë turistike mes gjelbërimit. Njerëz shakaxhi e punëtorë, emra që mbeten të nderuar nga e kaluara si Emin Salia i shkolluar në Stamboll, Cane Dahari, Ali Jakupi etj. Por si në legjendë vijnë kujtimet për **Luftën e Bjeshkës** ku u vra **Hebib Kupa**. Këtu **Galip Hoxha** ndryshoi fatin e luftës. Ai mes plumbave, në këmbë e zuri taben i pari e u bë pozicion i pamposhtur duke mbetur për Radomirën shembull i nderuar. Këta banorë janë mjeshtër në punimin e drurit, dhe në Tiranë e ushtrojnë si rasti i **Jonuz Dakur** në **Çerkezë** që "Çfarë i sheh syri, ia bën dora" dhe ua trashëgon dhe djemve siç ia trashëgoi atij babai, Fejzullai ,që mbetet mjeshtër në çdo fushë të ndërtimit. Që fëmijë e filloi Jonuzi në Rade e përsëri në Rade vijon ky zanat nga Xhemali Demallari me plot sukses. Djali i vogël i Fejzës ngriti një biznes të fuqishëm të Ura e Institutit ku porositë nuk reshtin, se besimi te ai është i plotë. Kur pi kafe te klubi plot shije te biznesi i tij të duket vetja si në Rade duke soditur ato vise të bukura. Me vlerat e këtij fshati njihesh dhe më mirë kur bisedon me intelektualin korrekt e plot të ardhme **Saimir Hima** i respektuar nga të gjithë në dikasterin ku punon. Meqë ra fjala: U bë një dokumentar për Radomirën, u promovuan vlera, por sa gjëra mbetën pa u bërë . . Si nuk u dërgua kamera te **Sokoli** , te ky dashamirës i Radomirës? Si u anashkaluan vetëm të **Ura e Institutit** bizneset e **Halil Selmanit** me gjithë ato dyqane, si u harrua biznesi i **Man Kupës**,si u kaluan aq zbehtë bizneset e fuqishme të **Hakik Dakut**? Po në Paskuqan si u anashkaluan ato lokale që të mrekullojnë të **Hajredin** e **Lavdrim Ahmatit**, të **Abdyl Kupës** apo ***QTA*** moderne e **Nexhip Ahmatit**? Të na falë lexuesi, por dëshira e mirë për ta paraqitur Radomirën nuk u realizua mirë. U përfshinë me të drejtë shumë njerëz të nderuar, por sa mbetën? Nuk u fol për pasurinë shpirtërore më të madhe që është **Intifaku**, nuk u fol për Çernjevën si lagjja më vitale, nuk u fol për Kishën e famshme të **Tallamazit**, për djemtë e Radomirës që çanë më parët mes plumbave në vitin 1988 duke kaluar nëpër kalvarin e vuajtjeve në Jugosllavi derisa arritën në Amerikë si **Qazim, Kalosh,Mefail e Hamit Kupa, Gani Daku,** më vonë shumë të tjerë që sot "kanë zaptuar" **Filadelfian**. Jemi dëshmitarë të atyre persekutimeve që hoqën Esat e Qamil Kupa për djemtë që u arratisën, të parët, por qëndruan kryelartë derisa erdhën dhe ndryshimet demokratike. Përballë Tesiy, Stërdoku i lashtë, i bukur i bamirësit Haxhi Hasanit, i Shehu Islamit të Perandorisë,Hysen Gjonikut,trimit Brahim Gjorgji e burra të tjerë të nderuar. Shumë djem morën udhët e mërgimit nga Europa në Amerikë e ndërtuan biznese të shkëpqyeshme si:Ramadan Hima,Daut Hima e plot të tjerë. Intelektualët e devotshëm e kanë nderuar fshatin :si Shazivar Koka, mjeku dhe kryetari komunës Bajram Hima, kurse Dr.Petrit Gjorgji rrezaton profesionalizëm e kulturë pune e komunikimi jo vetëm në Qendrën spitalore "Nënë Tereza" por dhe orët e ditët e pushimit i shfrytëzon në dobi dhe shërbim të komunitetit të Paskuqanit. Duhet ta pranojmë se u anashkaluan pa qëllim shumë ngjarje e figura që duhet të na falin që s'mund t'i përmendim brenda caqeve të këtij reportazhi, por, çdo pësim është mësim dhe gjithçka do të rregullohet.

MYSAFIRËT E NATËS SË PARË

Makinat parkohen një nga një nga **Kraiti** deri te **Ura e Krreçe**, njerëzit zbresin, përshëndeten, bisedojnë. Të gjithë të ftojnë për kafe, për darkë. Fillojnë të mbushen klubët, zërat e lartë te lokalet e Sutkiut e Haxhiut nuk e mbysin dot ulërimën e Veleshicës që, dhe pse korrik, shkumëzon si në pranverë. Se Korabi akoma ka shumë borë. Kjo i mrekullon të ardhurit që nuk janë vetëm radomiras, por dhe të tjerë. Se tani interesimi i të tjerëve po rritet, media e ka thyer heshtjen, Rruga e Kombit i shkurtoi distancat. Por shumë mbetet për të bërë, udha **Caren-Radomirë** mbetet problem jo i vogël. Një njeri qëndron disi i veçuar. - Është italian, - thotë Haxhiu,- ka disa ditë që qëndron në hotel, shëtit në bjeshkë, lexon...

Shumë grupe turistësh vene e vijnë, në dimër e në verë, Radomira është gjallëruar, ajo do të gjallërohet më shumë. Sonte hoteli është prenotuar nga Hakiku me vëllezër e djem, jo se s'kanë ku të rrinë, por për lezet, për të shijuar gjumin e ëmbël nën muzikën e Veleshicës. Kurse Nurish Ahmati me të tijtë, si çdo vit, i kanë marrë masat për të kaluar natën nën hijet e pishave, te Liqeni i Zi ku gjumi thuajse arratiset nga lojërat, këngët e vallet nën tingujt e lodrave që i kanë porositur me kohë, siç kanë porositur dhe qingjat e prerë që mbushin zgarën .

Kasam Hima gjatë verës e braktis Paskuqanin dhe e kalon në Stërdok. I pret në klubin e të birit të ardhurit, zëri i tij i lartë e burrëror shpreh kënaqësinë e kësaj dite, vështirë është të fusësh dorën në xhep kur je me të. Edhe ata të lagjeve të tjera e kanë bërë traditë të grumbullohen në Tejs nga ku shpërndahen shumë vonë me makina. Shkojnë dhe te miqtë e tyre që i kane në Caren e Ploshtan. Muzika përmes DJ që e ka sponsorizuar **Besnik Ahmati** shpërndan tingujt e muzikës së krahinës që merr shije tjetër nën ison që i mban Veleshica. Kështu deri vonë për ta nisur muhabetin nëpër odat e mikpritjes. Këngët e **Muratit, Arifit e Mifterimit** i kënaqin njerëzit deri vonë.

MYSAFIRËT NGA LARG...

Vitin e kaluar e nderoi Festën një grup shqiptarësh nga **Maqedonia**, kryesisht nga **Gostivari**, disa kishin dhe lidhje gjaku me Radomirën e Kalanë e Dodës, por një lidhje tjetër shumë domethënëse ishte prania e tyre në Radomirë si 11 vite më parë kur qenë në **UÇK**, i njihnin udhët, se i kishin kaluar dhe në errësirën e natës.

Por ky vit qe më i ndryshëm, Radomira donte t'i shihte disa nga ata ish-luftëtarë që në vitin 2001 u bënë të afërt si një familje me radomirasit, ndanë gëzimin e fitores, por dhe mjekuan plagët e plumbave. **Tahir Sinani** vetë i tretë dha jetën matanë Korabit, e qau jo vetëm UÇK-ja këtë trim të paepur e strateg lufte, por e para e qau Radomira që disa orë më parë e kishte përcjellë për të mos u kthyer më. Shoqata "**Korabi-Radomirë**" i ftoi ata trima që tani janë të respektuar në organet më të larta në Maqedoni **si Ali Ahmetin, Talat Xheferin** etj. Lidhjen me ta na e bëri të lehtë një djalë Lume i respektuar, z. **Arben Çejku**, ambasadori i RSH në Republikën e Maqedonisë. Ali Ahmeti nuk mungoi të përcjellë falënderimet e keqardhjen për mosardhjen përmes shokut të tij të armëve, z. Talat Xhaferi, **Ministër i Mbrojtjes i Maqedonisë**. Erdhën dhe shumë mysafirë të tjerë të lartë, u përzien me popullin që ishte grumbulluar te Ura e Krreçit si të ishin radomiras, larg etiketave zyrtare të pritjes, ashtu si 12 vite më parë. Përqafime, shumicës i zinte emrin **z.Talat,** si atëherë. Një pritje e thjeshtë, një çlirim nga emocionet, momente kur më shumë flet zemra. Një kafe me miqtë e muhabet pa teklif me ta Kasam Hima, Fejzullah Ahmati, Hakik Daku, Zaim Kupa, Munir Hoxha etj.

Por **Islam Ahmati** ka dhe emocione, iu bë shumë qejfi për ardhjen e tyre. Normalisht, gjithë Radomira ishte me ta, por te Islami kishin bazën, nënë **Qerimja**, të cilëm z.Talat e përmend të parën, nuk vinte gjumë në sy deri sa "djemtë" , se ajo nuk i ndante nga djali i saj i vetëm, të ishin rehat, të pushonin apo dhe të mjekoheshin. Sa u gëzua kur i pa në shtëpi, ka shqetësim veshët që i janë rënduar, por ndonjë lot nuk i shpëton kur përqafon Talatin. Eh, si kalojnë vitet, sa mall e dhimbje kanë sot të gjithë kur kujtojnë natën e fundit me **Tahir Sinanin,** trimin me shokët që dolën nga kjo derë, dolën nga Radomira për t'u bërë heronj. Ashtu rrafsh, mbi lëkurët e bardha, si atëherë, shtrohet muhabeti e më vonë dhe dreka karakteristike, se Islami i ka marrë masat me gjithçka. Këmbëkryq tregojnë për origjinën e tyre dhe shumica janë nga viset e Lumës, por dhe të Dibrës. Sa na pat larguar padrejtësia 100-vjeçare. . .Por kohët po ndryshojnë.

Në podiumin natyral z.Talat, ambasadori e shokët e nderuar: **Hisen Xhemaili, Ilir Selmani, Bekim Maksuti, Blerim Ukalli** (kërkoj ndjesë për emrat e të tjerëve), nuk pranojnë të rrinë, qëndrojnë në këmbë mes popullit, një gjest tjetër thjeshtësie e kulture.

:Jam sot këtu që këtë manifestim dhe këtë gëzim të Radomirës ta ndajmë bashkë duke përcjellë edhe njëherë atë respekt të ish pjesëtarëve të UÇK-së për mikpritjen dhe bujarinë dhe për t'u bërë me dije se atë mikpritje nuk e kemi harruar e s'e harrojmë kurrë", tha në përshëndetjen e tij **Talat Xhaferi**. Ndërsa ambasadori ynë në z. **Arben Çejku tha**: "Duke parë këto male, mendoja që ato dikur, për dekada kanë qenë mur i pakapëcyeshëm për të parë vëllezërit tanë matanë kufirit të ndarë padrejtësisht...Por ju, me fisnikërinë tuaj, këto male i shndërruat në një urë për të sjellë lirinë për pjesën tjetër të popullit shqiptar, vëllezër në Maqedoni. Ju i bëtë këto male jo vetëm të kapërcyeshme, por i bëtë të lehta për luftëtarët e lirisë."

E, kështu mes përshëndetjeve edhe të banorëve si të Hakik Dakut që sponsorizoi dhe monografinë "Radomira" apo banorë të tjerë e më pas të këngëve të Murat Gjonikut e Arif Madanës, bëhet dhe nisja, por këtë radhë në një perlë tjetër, te **Liqeni i Zi**.

DREJT LIQENIT TË ZI

Pati dhe grupe që shkuan në drejtim të Preshit ku bora këtë vit akoma zotëronte e s'e lëshonte rrugën. Atje i kishin përgatitur dhe aktivitetet si fshat, por shumica morën drejtimin për Malin mbi Tejs ku Liqeni i Zi, i fshehur mes pishave, është bërë një vend shumë i preferuar. Kush e ka parë dhe nuk është mahnitur?

Besoj se lloji i peshkut a ndonjë gjallesë tjetër aty janë endemike, por kjo u takon specialistëve. Nuk është larg nga Tejsi mëse 20 ose 30 min. Varet nga rruga që do të ndjekësh, janë 4-5 drejtime që të çojnë aty. Të bën përshtypje numri i të ardhurve që nuk janë radomiras e që priten si miq të nderuar. Aktivitetet fillojnë menjëherë, futbolli është shpërqendruar jo vetëm në një fushë. Aparatet fiksojnë mjaft kujtime e pamje, shumë u përqendruan kur ca pika shiu të mëdhenj e trazuan faqen e Liqenit duke i dhënë një gjallëri e pamje krejt romantike. Por pushoi shpejt e s'qe nevoja për t'u mbrojtur poshtë pishave kryelarta. Lavdrimi me shokë nuk qëndrojnë vetëm robër të zgarës apo të valles, por futen e notojnë serbes në liqen. Lodrat ku usta Shahini e sidomos Arifi i paarritshëm me bae (culë e madhe), që shpesh i kënaq pjesëmarrësit dhe solo, nuk pushojnë. Çfarë panorame krijohet buzë liqenit ku vallja e vendit luhet me plot talent e me "**derhem**" si thotë populli, **Fatmir Daku** nuk shkëlqen vetëm në këngët me **Mifterimin** (sa keq, sot mungonte), por është i pari i valles e shoqërohet nga të tjerë të talentuar. Shikon përgjegjësinë e këtyre valltarëve dhe të shkon mendje të ajo indiferencë që po tregohet në ruajtjen e këtyre vlerave nga organet përkatëse. Pak po ruhet, se po na mbysin ritmet pa fre.

Grupet ulen sipas dëshirave për të shijuar një drekë të veçantë në këtë vend të veçantë dhe grupi i lodrave i viziton të gjithë, gjëmon mali nga këta banorë që sot janë më gazmorë se kurrë, i kanë lënë hallet mënjanë, se kanë ardhur në vendlindje, aty ku e ndiejnë veten krejt të çliruar.

Është rastësi, ndofta, që po këtë ditë disa specialistë pyjesh që i drejton z.Raxhep Ndreu, ku janë një specialistë nga Kukësi, një vajzë nga Lezha e tjetra nga Mirdita po shohin këtë pyll aq mirë të ruajtur. Tregohen të mrekulluar kur u flasim për ato rregulla që ruhen në shekuj nga Radomira për ruajtjen e pyjeve. Dhe disa fotografi qenë kujtimi më i bukur me ta.

Makinat fillojnë të vihen për udhë një nga një e me grupe. Seç ndien një boshllëk në zemër kur sheh që në udhë e lokale fillon njëfarë qetësie. . .Por gjithmonë ka ndarje, por kjo është ndarje me një premtim: "***Mirë u takofshim vitin e ardhshëm e me një organizim dhe më të mirë!"***

Më vijnë shumë letra valëve të internetit, letra që më sjellin shëndet e gëzim, letra që ma ndezin mallin e dua të vrapoj ta shuaj burimesh e lëndinash të vendit tim...

emigracion

Një **letër** që më solli **mall**...

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Më vijnë shumë letra valëve të internetit, letra që më sjellin shëndet e gëzim, letra që ma ndezin mallin e dua të vrapoj ta shuaj burimesh e lëndinash të vendit tim, Dibrës që e dua.

Kësaj radhe më erdhi një letër nga shoku im, nga miku im, nga Luan Kaba me të cilin na ka lidhur, midis të tjerash e mbi të tjerat, profesioni; ai telekronist i Radio-Televizionit Shqiptar dhe unë gazetar i Agjencisë Telegrafike Shqiptare. Vite të shkuara, viteve shtatëdhjetë. Mundohem të kujtoj rrugëtimet në këmbë me Luanin në kërkim të njerëzve të punës, "njerëz mbi male" siç i kam pas vënë titullin një reportazhi.

Një fotografi (që po e përcjell, foto ku është edhe Fredi, redaktor i RTSH) më ngacmon kujtime në ngjitjen maleve të jashtëzakonshme për nga bukuria dhe begatia, maleve të Kalasë së Dodës, udhëtimit nëpër Radomirë, luginës që merr kryevend tek "Shpellasi" ku thonë se uji ka marrë ngjyrë kur në bjeshkën e Ponairit hodhën bojë për të parë ku humbet e ku del uji për ta prerë "berrin e varur në çengel" për kurrizi, Shqipërinë, njëqind vjet të shkuara.

Më kujton liqenin e Preshit e pak më sipër burimin ku kam mbushur grushtet njëri pas tjetrit për të shuar etjen e ngjitjes në këmbë. Më kujton Sorokolin e pamjen që zbret në njërin krah nga Përroi i Lushe e nga krahu tjetër në Fushën e Korabit. E tej e tej në veri, bjeshkë pas bjeshke, "Kthesën e Koke" ku misionaret e Evropës u detyruar para pushkëve të rrotullohen rreth vetes në detyrimin "Të lënë kokën apo tu lënë tokën shekullore fisit trim të Kokeve".

Eh more Luan Kaba, djali i mikut tim të viteve të rinisë, mjeshtrit të bujqësisë dibrane, Sabri Kabës, kujtimet e të cilit më vijnë e më zënë supin e pesë viteve kur ishim bashkëmësues në shkollën e mesme bujqësore "Nazmi Rushiti".

Nuk mund të lë anash një rrjedhë gjaku gjenetik. Fëmijët e Luanit kanë gjak nga kushëriri i parë i babait tim, Azem Poçi, njeriu që nuk ia gjeje shokun në vend për punëtor e zemër flori. Faleminderit Luan Kaba. Letrën tënde plot ndjenjë e dashuri nuk mund ta mbyll "zarfeve kompjuterikë". Po e përcjell me mall për të shuan paksa mallin e një ikanaku larg e larg vendlindjes, Dibrës tonë.

Gjithashtu, edhe një fotografi, të tre, midis teje e Sami Bulkut, diku në një lokal të vogël në pritje të kafes...

Abdurahim Ashiku
Athinë, 19 korrik 2013



Kësaj radhe më erdhi një letër nga shoku im, nga miku im, nga Luan Kaba me të cilin na ka lidhur, midis të tjerash e mbi të tjerat, profesioni; ai telekronist i Radio-Televizionit Shqiptar dhe unë gazetar i Agjencisë Telegrafike Shqiptare. Vite të shkuara, viteve shtatëdhjetë. Mundohem të kujtoj rrugëtimet në këmbë me Luanin në kërkim të njerëzve të punës, "njerëz mbi male" siç i kam pas vënë titullin një reportazhi.



I rilindur bashkë me "Rilindësit e kohës sonë"

Përshëndetje Abdurahim Ashiku!
Lexova librin tënd të fundit "Rrëfimet e komshiut".

Edhepsemekëmbëtemianukkamshkelur rrugëve të karvanëve të mërgimtarëve, ikanakët, siç i quan, me kokën pas Fushës së Korabit (O e mjera unë...), a Lëndinës së Lotëve, nga përshkrimet me aq ndjenjë, bëre që të më dukej vetja se po përplasem dallgëve të Adriatikut bashkë me Eduardin e të përlotem për djalin e tij dyvjeçar që e përpiu deti i trazuar i 28 marsit 1997.

Bëre të ndjehem se po dridhem nga acari në kapërcim të maleve të Gramozit, Konicës e Pindit bashkë me komshiun tënd e me të burgosurin në "Ahuret e Avgjisë", të më dukej se po sfilitem sporteleve të burokratëve komunar, zyrave të O.A.E.DH-it për një "Kartë kazerme" bashkë me atë "Vorioepirotin nga Luma".

Me rrëfimet më çove e më gëzove atje ku "Gjaku nuk bëhet ujë", mes arvanitasve të Thivas, në Kaskavelin e autorit të "Gjuhës së Perëndive" Aristidh Kolën e madh, më prezantove me Kiço Bllanin shokun e vjetër të klasës në shkollën e mesme...

Vërtet më bëre të trishtohem për rininë e humbur të Valbonës, të ligështohem për fatin e "Gjeneralit akull" por edhe për atë zogun shtegtar tek tavolina 15.

Më bëre të përbuz edhe afendikonjtë nursëzë , avokatët e ftohtë gjakpirës, ikonat mashtruese por më bëre edhe më shumë të ngazëllehem me mjekun Panajotis, gazetaren Magda, pronarin Spiro që Shpëtimin nuk e thërrisnin Jorgo por me emrin e nënës-Shpëtim.

Siç me ndjenjë, rrokshëm e përshkruan, edhe unë do të desha të isha dëshmitar në "Gjyqin e Shqipes" e të përshëndesja me gjithë zemër mësueset Stela e Denada.

Por do të desha të shihja edhe kur i përmalluar takohesh me Gurjonin, mjaltin e mjaltit. Pse jo edhe të filmoja me kamerën time, si gati 30 vjet më parë në Sorokol, liqenet e Lurës a Kacnisë. Është një galeri e vërtetë personazhesh realë, që frymojnë, mbijetojnë, gjallojnë por edhe lulëzojnë në atë klimë. Me një gjuhë të thjeshtë, origjinale, të pastër, me emrat e vet, ata i ke përjetësuar në histori, në një nga faqetë e trishtueshme të saj, në ata të tranzicionit alla shqiptar, që na bën të ndjehemi ngushtësisht keq.

I nderuar Abdurahim Ashiku!

Me a pa dëshirë, me a pa sakrifica, me apo pa peng të lënë pas, kapërceve mes "Gurëve që lëvizin"...dhe vërtet të shoh të rilindur, bashkë me "Rilindësit e kohës sonë".

Edhe njëherë dua shumë të të uroj shëndet e jetë, përtë vazhduar "qilizmën", se me siguri ke edhe të tjera, e të tjera për të na thënë.

Urime nga Luan Kaba, ish telekronist,
drejtor i Arkivit të Shtetit-Peshkopi

JEPET ME QIRA
mjedis **300 m2,** pranë Kombinatit të Autotraktorëve.
E përshtatshme për çdo lloj aktiviteti.
Lartësia e katit 5 m. Mjedis edhe për zyra!
Linjë trefazore elektrike në dispozicion!
Rruga e shtruar me asfalt!
Të interesuarit të komunikojnë me tel:
069 20 68 603

DJ për gëzimet tuaja familjare
me repertor të zgjedhur
me këngë dibrane
Jepi dasmës tënde aromë Dibre....
Tel. **066 60 12 616**

Halil Gjeçi, arkeologu “amator” që kalon verën duke zbuluar historinë e vjetër të Çidhnës

Çidhnaku i pasionuar pas arkeologjisë

Nga **SHAQIR SKARRA**

Nuk njihesha ma parë, as kisha dëgjuar fare për të, por e takova fare rastësisht në një lokal, aty pranë stacionit të trenit tek bisedonte me disa të rinj. Në tavolinë ashtu si në mënyrë të fshehtë kishte nxjerrë disa monedha të vjetra ku shumicës i kishte humbur dhe shkëlqimi i dikurshëm.Përveç monedhave kishte dhe maja shigjetash, vathë e unaza me kode e kryqe, vegla pune të ndryshme të periudhës së hekurit. Kureshtja më shtyu të afrohem rreth tavolinës së tyre. Pas prezantimit të çastit të dy u çliruam disi.

- Quhem Halil Gjeçi dhe jam nga Çidhna por prej dhjetë vitesh banoj në Tiranë. Stina e bukur e verës për mua nuk është plazhi siç turren shumica por Seta, Lura e Sheu i Thatë. Atje në mënyrë krejt të lirë shkoi, gërmoj dhe ja kam gjetur këto e shumë të tjera si këto. Në fillim m’u duk si njeri që merret me kërkim thesaresh që vitet e fundit janë shtuar shumë por në fakt isha gabuar. Halili ishte një arkeolog amator që për punën që kishte bërë deri tani ua kalonte dhe profesionistëve.

- Ke dëgjuar ti për varrin e Vidanit?- mu kthye duke vënë buzën në gaz.

- Jo, iu përgjigja shkurt. Kam dëgjuar për varrin e Jovanit, varrin e Jovan Nokës por që dhe këtu nuk kam qenë fare.

-Jo, jo varri i Vidanit nuk ndodhet në Çidhën, ai ndodhet diku në Lurë dhe ka një histori të çuditshme. Para ca viteve vjen në Lurë një i huaj. Ishte italian dhe kishte me vete një valixhe plot me harta dhe shkresa. Me vete kishte dhe një përkthyes dibranë. Bujtën një natë në një familje të varfër luriane. I zoti i shtëpisë kishte shtëpi dhe shtroje por ishte fukara.

Pasi u përgatitën një darkë me pulë fshati dhe jufka dibre u shtron për të fjetur. Në mëngjes italiani i paguan të zotit të shtëpisë një napolon flori për ushqimin dhe fjetjen.

- Unë dua të rri në Lurë disa ditë se kam punë, nëse ke vend për fjetje dhe na gatuan si sonte ma mirë po rri tek ju. Unë do të paguaj jo me një napolon por me dy napolona natën. Lurianit i qeshën sytë se si i thonë fjalës, Hizri i kishte ardhur në derë.

- Si sonte të rrini tek unë jo një javë por një muaj, pulë,jufka dhe shtroje kam boll. Pas disa netësh që qëndroi tek kjo shtëpi italiani e pyeti një natë të zotin e shtëpisë se mos di gjë ku ndodhet varri i Vidanit.

- E di jo unë por krejt Lura, nesër në mëngjes të çoj në adresën e saktë. Kur u ngjitën sipër në majë të malit, në një lëndinë të bukur panë një varr disi të veçantë që nuk ndodhej askund me ato përmasa. Katër metra i gjatë dhe dy metra i gjerë rrethuar me gur në të katër anët.

- Ja ky është varri i Vidanit, i thotë luriani të huajt.

- Do ta hapim këtë varr,-ia ktheu italiani.

- Jo, unë jo, nuk e bëj këtë punë. Të kam dhënë bukë në shtëpi por varr nuk hap. Ti po deshe ka plot djem të rinj që mund ta bëjnë këtë punë. Ditën e nesërme erdhën dy djem të rinj nga Lura dhe sipas porosisë së italianit filluan të gërmojnë në varr. Pas disa kazmave hasën në një zhurmë hekuri. Kur e zbuluan panë se ishte një sferë e madhe metalike. Italiani kuptoi se kishte ardhur tamam në adresë. Nxori diçka nga valixhja që mbante me vete dhe me anën e kodit që e kishte të qartë e hapi këtë sferë të mbyllur prej disa vitesh. Përveç disa hartave dhe një shumë të madhe ari që ndodhej në fundin e sferës aty nuk u gjet as gjë tjetër. Hartat i mori me vete, monedhat ua dha djemve të Lurës që punuan dhe varri u mbulua përsëri. Gojëdhëna tregon se të dy djemtë që gërmuan në varrin e Vidanit vdiqën, as njëri, as tjetri nuk e gëzoi pasurinë që morën nga ai varr. Njëri nga gëzimi





për këtë shumë monedhash floriri që mori në dorë ra në humnerë dhe tjetri u vra nga vëllai i, tij që erdhi pas pak të kërkoi vëllanë e rënë në humnerë.

Tregimi i Halil Gjecit na vjen në fakt në formë legjende, por vetë Halili nuk është legjendë. Ai është një i dhënë pas arkeologjisë sa punon krejt në mënyrë të pavarur dhe jo pak por sot po të futesh në shtëpinë e tij në Çidhën që kohët e fundit e ka kthyer në një muze do mahnitesh duke parë gjithë këto pasuri që prej vitesh i ka fsheh nëntoka jonë. Dhe Halili nuk rresht së kërkuari në Çidhën, në Lurë, në Setë, në Sheun e Thatë, kërkon krejt në mënyrë individuale dhe sot mund të themi me plot bindjen se Halil Gjeci edhe pse është një arkeolog amator, punën e tij nuk e kanë bërë as arkeologët profesionist. Ai është një ndër koleksionistët më të mëdhenj në vendin tonë, por që ende nuk e njohin sa duhet. Jo vetëm në Tiranë, por dhe atje në shtëpinë e dikurshme në Çidhën ka një pasuri të madhe me gjetje që i ka mbuluar prej vitesh nëntoka jonë dhe nuk kanë qenë në gjendje as arkeologët më të shquar të vendit që t’i nxjerrin në dritë.

Halili është mjaft pesimist pasi ka trokitur disa herë në zyrat e Institutit të Arkeologjisë por e kanë pritur mjaft me indiferentizëm, megjithatë ai bindet se këto gjetje që mban sot në shtëpi pa dyshim janë vetë historia e popullit tonë në breza.

Skicë nga MEVLUD BUCI

Pesha e fjalës

Në çdo kohë Dibra dhe dibranët e kanë ç’muar dhe vlerësuar fjalën, i a kanë ditur vlerën, e kanë gdhendur, latuar, menduar mirë e mirë pra e kanë shprehur. Populli i urtë dibranë nëpërmjet alegorive, dukuri kjo e të urtëve të odave ka shpërfaqur filozofinë në shekuj. Alegoritë janë perlat e Dibrës ashtu siç i ka etiketuar me të drejtë shkrimtari dibranë Xhafer Martini. Alegorinë e kanë mbledhur me kujdes Haziz Ndreu,Hilmi Kolgjegja,Naim Plaku, Xhafer Martini, Shaqir Skarra,Munir Shehu, Sakip Cami e shumë të tjerë, të cilët pa dyshim janë një vlerë e shtuar në pasqyrimin e fjalës së rrallë të mençurisë dibrane. Nisur nga këto thesare të rralla të odave s’ka se si nuk ndalon sot tek pesha e fjalës, tek vetë vlerat e fjalës së njerëzve të kulturuar.Me të drejtë populli thotë:”I miri e vlerëson të mirin se është vëlla me xhevahirin”.

Pesha dhe vlerat e fjalës dëshmojnë kulturën, qënien njeri në radhë të parë.Alegoria është ajka e mendjes, prova e zgjuarsisë. Pra me të drejtë alegoritë e Dibrës mund të quhen pa mëdyshje, filozofia e shekujve ku djepi i saj është Luznia, Çidhna,Reçi, Shumbati,Lura,Katër Grykët e plot fshatra të tjerë në Dibër. Sigurisht, sikurse çdo punë, problem apo dukuri ka rritjen e ndryshimin e vet në kohën tonë të demokracisë edhe fjala ka ndryshimin e saj. Përse? Fjala, ky institucion i shenjtë e akademi ka rrjedhën e vet, burimin më origjinal e të pashtershëm, siç është mençuria e brezave tanë.Një i urtë mbi nëntëdhjet vjeçar i Dibrës kohë më parë thoshte:”Fjala të burrëron, fjala të çburrëron. Tashmë ku çdo ditë, çdo orë dëgjojmë mjaft oratorë, kemi në duar mjaft gazeta e libra, vërejmë plot emisione humane e të ç’muara, sejcili prej nesh mediton për peshën dhe rëndësinë e fjalës.Shkrimtari dibranë Xhafer Martini na ka dhuruar librin:”Fjala priu” si dhe “Kanunin e Dibrës” ku jo vetëm këtu por në mjaft libra të tij, ai pasuron,analizon, argumenton e “luan” me fjalën.Sot më fort se kurrë çdo njeri prej nesh duhet ta çmojë e vlerësojë fjalën, ta mat shtatë herë e ta pres njëherë .Pesha e fjalës dhe vlerat e saj të vetë peshuar, të matur, të saktë janë dëshmia e plotë e njeriut të ditur e të kulturuar. Poeti ynë Dritëro Agolli tek poezia e tij “Kujdes me fjalën” shkruan:

”Kujdes me fjalën zonjëz me çantë,
Kujdes me fjalën dhe t’i zotëri,
Pushteti i fjalës është i veçantë,
Gatuan male dhe kakërdhi….”

Sinqerisht, në shumë raste kur dëgjoj komunikimin e çiltër dhe dinjitoz të Ardit Gjebresë me publikun përlotem. Pse? Jo për nostalgji, as për eliozh, por ai të duket sikur e ke në familje, në hall, në zemër: ”Të dua shumë” faleminderit i dashur” “jeni të mrekullueshëm””ju uroi mirësi” e plot e plot fjalë zemre burojnë nga thellsia e shpirtit të Ardit Gjebresë në emisionet e ndryshme televizive e në biseda telefonike me qytetarë të ndryshëm të njohur dhe pa njohur. Sot jemi në liri të plotë, jemi në demokracvi, jemi në dritën e syrit të popullit cilido prej nesh.

Vërehet një rritje, një vlerë e rrallë, kjo ematurisë së fjalës, e nderimit për vlerat e tjetrit.Populli ynë i lashtë e model i kulturës ilire, sot më fort se kurrë ka nevojë për fjalën e drejtë, të kulturuar, fjalët që i shoqëron mirësia e vepra, ndaj cilido që e thotë fjalën e mirë qoftë edhe për kundërshtim politik apo cilido që ka merita, populli e çmon, e nderon e votëbeson. Të irrituarit, karrieristët, ata që përbaltin të tjerë, populli dhe vetë koha i nxjerr të pa vlerë.Lum kush e peshon fjalën para se ta shprehë, lum kush e thotë fjalën e drejtë në mbrojtje të vlerave e të vërtetës.Vërtet jemi të lirë, por koha e njerëzit e mirë e peshojnë dhe dinë të sitin vlerat e kahjet e fjalës.

Gjëja e ndritur dhe e çmuar-fjala e vetpeshuar, fjala e njerëzve të kulturuar. Dritë bëftë zemra e ndriçuar dhe fjala e kulturuar.Bleroftë gjithmonë alegoria e Dibrës, fjala e mençur mbarë kombëtare.

Shkrimi i mëposhtëm është një vështrim ndryshe i luftës së zhvilluar në Fushë Alie në Korrik 1944. Historiografia komuniste e ka quajtur këtë luftë si një përpjekjet me forcat nacionalistë të Halil Alisë, por Hysen Repa na sjell një vështrim krejt ndryshe. Redaksia fton historianë dhe studiues të sjellin vështrimet e tyre mbi këtë ngjarje, duke e konsideruar të hapur debatin, në shërbim të së vërtetës.

MASAKRAT NË FUSHË ALIE, KORRIK 1944

Luftë civile, krime lufte apo hakmarrje?

Nga **HYSEN REPA** *



Korriku i vitit 1944, për çdo banorë dhe familje Çidhnake, i vjetër apo i ri, është një kujtesë kolektive nga më tragjiket e kësaj zone.

U mbushen 69 vjet nga "Lufta e Fushe Alies" dhe historia rreket pas dilemave që la propaganda komuniste, e cila e trajtoi këtë si luftë të "Bashibozukeve të Halil Alise", tradhtar, kolaboracionist, bashkëpunëtor të fashizmit etj..

Janë shkruar mjaft artikuj për këtë luftë, para dhe pas viteve 1990.

Kundërshtitë për trajtimin historik, ushtarak dhe shoqëror të kësaj beteje të përgjakshme vijnë kryesisht nga historianë të periudhës komuniste, të cilët kërkojnë t'ju qëndrojnë besnik bindjeve dhe deklarimeve të mëparshme, pa bërë një analizë të thellë të asaj që ndodhi në Korrik 1944 në Fushe Alie.

Përpara se të analizojmë për sa më sipër, është e domosdoshme të bëjmë një analizë të gjendjes administrative, ushtarake dhe ekonomike të Dibrës gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944.

Dibra që pas shpalljes së Pavarësisë, gjatë kohës së mbretërisë e në vazhdim gjatë luftës, është administruar nga strukturat e administrimit lokal të bejlerëve dhe agallarëve të Nëntë Maleve të Dibrës.

Një pjesë e tyre që përkrahën Mbretin Zogu I- rë, u fuqizuan si ekonomikisht dhe ushtarakisht. Murat Kaloshi, Dine Hoxha, Dine Dema, Fiqiri Dine, Mena në Lure etj., ose mbanin grada madhore në ushtrinë dhe xhandarmërinë e Zogut, ose ishin titulluar nga Mbreti Zog, si major në rezervë me një forcë ushtarake rezervë deri në 500 persona të armatosur dhe paguheshin nga mbretëria. Këto forca Zogu i përdorte për të nënshtruar kundërshtarët e tij politik.

Kurse një pjesë e Parisë, kundërshtare të Zogut, si Cen Elezi (Ndreu), Haxhi Lleshi, Faik Shehu, Halil Alia, Selim Kaloshi, nuk përfituan ekonomikisht dhe ushtarakisht nga mbretëria.

Megjithatë, aleancat dhe hasmëritë midis Parisë së Dibrës ishin lidhur ose prerë dhe me martesat e miqësitë midis tyre.

Hasmëria me Ndreun dhe Kaloshin e detyruan Halil Alinë të mërgonte jashtë shtetit për gati 2 vjet. U kthye në Fushë Alie vetëm në fillimin e pushtimit fashist.

Halili kishte përkrahje vetëm nga Selim Xhetani (Kaloshi) dhe pak nga Dine Hoxha i Muhurrit. Po ashtu, kishte mbështetje dhe në Lume, ku ishte dhe nip.

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore, pushtimi fashist, e gjeti Parinë e Dibrës të ndarë në qëndrimet e tyre ndaj pushtuesit.

Po ashtu, është e rëndësishme të nënvizohet se paria e Dibrës nuk u angazhua fillimisht në partitë politike si Balli Kombëtar dhe Legaliteti.

Me aktivizimin ushtarak të Partisë Komuniste, një pjesë e parisë panë tek kjo forcë politike si më të mundshmen për të marrë pushtetin pas çlirimit.

Kjo është dhe arsyeja që Haxhi Lleshi dhe Dali Ndreu, megjithëse vone, u angazhuan fillimisht në veprimet luftarake të saj. Këto veprime kryheshin më së shumti në rrethinat e Dibrës së Madhe, Martanesh, Gollobordë apo Çermenikë. Çetat partizane ishin në numër të kufizuar, më tepër pjesëtarë të familjeve të tyre apo rrethit miqësor.

Një arsye tjetër e këtij rreshtimi politik ishte dhe bashkëpunimi i hershëm i këtyre krerëve me Partinë Komuniste Jugosllave dhe ndihma e financimi me para dhe armë i tyre.

Po ashtu, dhe familja e Kaloshit, Miftari, (Murati ishte larguar bashkë me Zogun në Prill 1939) dikur mbështetës i Mbretit, ishte fuqizuar dhe ishte një faktor i fuqishëm ushtarak në Zonë.

Gjendja ekonomike e popullit të Dibrës ishte tepër e rendë. Pak familje prodhonin bukën vjetore. Shteti nuk funksiononte, pak punë kishte në ndërmarrjet italiane apo të ushtrisë.

Populli në përgjithësi kishte armë të vjetra, të cilat i kishin shpëtuar reformës së mbledhjes së armëve në kohën e Zogut.

Burim pagese dhe armatosje ngelej vetëm rekrutimi nga krerët. Paria i armatoste popullatën "me besë" duke ju vënë kushte që ta mbështesin në veprimet e tyre ushtarake apo në mbrojtje të interesave të tyre.

Në këto kushte u kryen dhe veprimet ushtarake të krerëve në ndihmë të italianeve, siç ishte rasti i Halil Alisë në Vlorë, apo Miftar Kaloshit në Dibër të Madhe e Maqedoni. Ka vetëm propagandë komuniste dhe nuk ka asnjë fakt apo dokument historik që të vërtetojë se trupat ushtarake të Halil Alisë të kenë bërë gjenocid mbi banorët, djegie apo keqtrajtime të popullatës.

Në trajtimin e kësaj teme, nuk është objekti kryesor të merrem kryesisht me operacionet ushtarake që kreu Halil Alia në rrethinat e Vlorës. Por, shumë historianë apo persona që janë rrekur të merren me figurën e Halil Alisë dhe të çidhnakëve, nxjerrin si argument këtë ngjarje për të përligjur gjithë gjenocidin e kryer nga komunistët në Fushë Alie në Korrik 1944.

Lufta ka ligjet e saj. Lufta është përpjekje e armatosur. Në një përballje ushtarake ka dhe viktima. Pas përfundimit, fituesit shpallen heronj dhe të mundurit tradhtarë.

Konkluzionet pas çdo lufte bëhen jo për nga numri i ushtarëve të vrarë, por si janë përdor trupat ushtarake ndaj popullsisë së pambrojtur, fëmijëve pleqve dhe grave, si dhe gjenocide.

Në krimet e Gjermanisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, nuk ka ngelur në memorie numri i ushtarëve të vrarë por gjenocide dhe kampet e shfarosjes në masë të Aushvicit.

Gjatë Luftës Ballkanike midis serbëve dhe shqiptarëve ka ngelur në kujtesë shfarosja dhe shkatërrimi i fshatrave të Dibrës e Lumës.

Pushtimi Italian, u ndje shumë pak apo aspak në zonën e Dibrës. Italianët kishin pak forca në Peshkopi dhe disa posta ushtarake fikse apo të lëvizshme në fshatra.

Si italianët dhe më vonë gjermanët, aksin Dibër- Lurë- Lumë e trajtonin si zonë antijugosllave, gjë e cila ishte provuar historikisht.

Po ashtu, veprimet luftarake në këto zona mund të kryheshin të kufizuara pasi mungonte totalisht infrastruktura rrugore dhe zona ishte tepër malore.

Kështu qe administrimin civil dhe ushtarak e lanë në dorë të Parisë.

Një veprim ushtarak që italianët kryen kundër familjes Ndreu në Sllove, është komentuar në mënyrë të njëanshme.

Inkursioni ushtarak ajror ndaj Ndreut në Sllovë, nga propaganda e kohës është komentuar se është kryer në bashkëpunim me Halil Alinë. Dëshmitarë të asaj kohe vërtetojnë të kundërtën. Por dhe dokumenta të Shtabit të Përgjithshëm të NAÇL nuk e vërtetojnë pjesëmarrjen e Halil Alisë. Kjo ishte thjesht si argument meqenëse ata kishin hasmëri dhe për të stimuluar vëllavrasjen në Dibër.

Përpjekjet e armatosura midis italianëve dhe çetave partizane apo njësive territoriale të parisë kanë qenë sporadike. Përpjekje të tilla ka patur në Dibër të Madhe, Peshkopi, Martanesh etj.

Pushtimi gjerman nuk solli ndonjë ndryshim në rreshtimin e parisë së Dibrës.

Paria po shikonte me shqetësim fuqizimin e Nac. Çlirimtares dhe Partisë Komuniste.

Popullsia e malësisë së Dibrës e identifikonte këtë parti si sllavokomuniste. Krerët filluan të ndërgjegjësojnë popullsinë për të këqijat e komunizmit lidhur me fenë, pronën, familjen etj.

Duke parë rezistencën e popullatës së Dibrës, partitë nacionaliste shqiptare kthejnë vëmendjen nga kjo zonë.

Përpjekjet e partive nacionaliste për të krijuar një front të përbashkët të luftës kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë, u kurorëzuan me krijimin e frontit të përbashkët "Bashkimi Dibran".

Bashkimi Dibran, bëri disa aksione të përbashkëta, por u sabotua nga përfaqësuesit e PKSH, me ndërhyrjen jugosllave, të cilët e panë si një rrezik për qëllimet e tyre për aneksimin e Dibrës së Madhe dhe fshatrat përreth. Haxhi Lleshi dhe Esat e Dali Ndreu dolën nga Bashkimi Dibran

Takimi te Varri i Deli Hasanit. Më 11 gusht 1943 erdhën në Dibër krerët e Ballit Kombëtar, Mithat Frashëri, Ali Këlcyra, Ethem Haxhiademi, Thoma Orogllai, Isuf Luzi, Hasan Dosti, Faik Quku, Sulejman Meçe... Këta zhvilluan një takim te Varri i Deli Hasanit. Këtu u bisedua për zhvillimin e luftës kundër pushtuesve dhe kundër rrezikut komunist. Halil Alia ka qenë ndër kryesorët e organizimit të këtij kuvendi. Po këtu deklaron dhe pajtimin me Kaloshin e ndërprerjen e gjakmarrjes. **Mbledhja e Lurës u mbajt 27 gusht 1943**. Në këtë Mbledhje morën pjesë figura qendrore, si Mit'hat Frashëri, Abaz Kupi, Muharrem Bajraktari, Fiqiri Dine, Hysni

Dema, Miftar Kaloshi, Et'hem Haxhiademi, Thoma Orogollai, Isuf Luzi, etj.

Më 6 shtator 1943 u mblodhën përfaqësues të Zonës i Operative të Ushtrisë NAÇL dhe të batalioneve të Maqedonisë. Jeleste Popovski dhe Toma Sofronovski, përfaqësuesit e forcave popullore të Dibrës, Cen Elezi, Hysni Dema, Ali Maliqi, Fiqiri Dinia etj. dhe përfaqësuesit e Ushtrisë NAÇL, Esat Ndreu, Njazi Islami e Sotir Vullkani.

Mbledhja zgjodhi një shtab të luftimeve. Në shtab u zgjodhën: Cen Elezi (kryetar-komandant) dhe Shaban Strazimiri që përfaqësonin Esat Ndreun, Jeleste Popovskin dhe Hamdi Demën. Në takim u vendos të bëhej bashkimi në luftë me forcat partizane. U ra dakord që shtabi operativ të njihej vetëm kur të futeshin në luftë të dy palët, Haxhi Lleshi dhe Dali Ndreu nuk morën pjesë.

Dibranët i rikthehen kuvendeve të dikurshme dhe "Itifakut". Në këtë mbledhje betohen për luftë ndaj komunizmit, falën hasmëritë etj.

Bilanci ushtarak në fund të vitit 1943 ishte:

- Çeta e Haxhi Lleshit, me rreth 100 vetë, që vepronte në Dibër të Madhe, Zogjaj, Zerqan, Bulqize e deri Martanesh

- Çeta e Sllovës komanduar nga Esat e Dali Ndreun, rreth 50 deri 60 vetë në Sllovë, Sllatinë, Reç e Dardhë etj.

- Batalioni Drini, Hysni e Hamdi Dema me rreth 600 vetë që vepronte në Homesh, Shupenzë, Maqellarë.

- Miftar Kaloshi me rreth 600 vete që vepronte në Kandërr, Sohodoll, deri në Peshkopi e Dibër të Madhe.

- Halil Alia dhe Selim Xhetani, rreth 500 vetë, vepronte në Fushë Alie, Sinjë, Mustafej e Çidhën të Poshtme.

- Bajraktari i Lurës, Tahir Mena, me rreth 500 forca vepronte në Lurë, Arni etj.

- Muharrem Bajraktari, Lumë, me rreth 500 vetë

Grupe të tjera të pavarura territoriale me rreth 200 vetë.

Duhet thënë se këto shifra janë me tepër deklarative dhe të padokumentuara plotësisht. Forcat italiane dhe gjermane nuk kanë ndonjë evidence të qartë.

Gjermanët kishin forca në Dibër të Madhe dhe Peshkopi, me nga një batalion respektiv.

Në këto kushte forcat partizane ishin të pakta dhe veprimet e tyre ushtarake ishin sporadike dhe vetëm në zonat e thella malore.

Kjo epërsi numerike dhe ushtarake, e mbajti larg ndërhyrjen dhe prezencën e forcave partizane në zonë deri në pranverë të vitit 1944.

FILLIMI I LUFTIMEVE, QERSHOR-KORRIK 1944

Sulmi i Parë

Në këtë periudhë, SHPNCCL, planifikoi operacionet ushtarake në Verilindje me pjesëmarrjen e Div. I sulmues me përbërje të Batalioneve Partizane të Haxhi Lleshit, dhe Esat e Dali Ndreut, të Br. IV S, Br. V S dhe me vonë të Br. 18 S të sapoformuar në Peshkopi.

Në fund të Qershorit dhe fillim Korrikut 1944, raporti i forcave ndryshoi dhe forcat partizane sulmuan në front të gjerë Dibrën e Madhe dhe Peshkopinë nga Verilindja dhe Mati, të mbështetura dhe nga forcat partizane maqedonase.

Pjesëmarrja e partizanëve jugosllavo-maqedonas në këto sulme krijoi te popullata bindjen e një sulmi të mirëfilltë sllav dhe mobilizimi i popullsisë ishte gati total. Armatimi i përdorur ishte ai që iu mor italianëve në kapitullim e sipër. Forcat partizane të komanduara nga Mehmet Shehu, Shefqet Peçi, Dali Ndreu, Haxhi Lleshi, Kadri Hazbiu etj., u thyen me dëme të mëdha njerëzore dhe materiale, duke u tërhequr në Malësinë e Sllovës. Gramë, Korab, Martanesh dhe thelle në fshatrat e Maqedonisë.

Paria e bashkuar si Kaloshi, Alia, Mena, Dema, Dine, Murrja, Muharrem Bajraktari, Litja etj arriten te bashkerendojne forcat duke i ndjekur forcat partizane ne thellesi.

Ndjekja e metejshme u ndërpre. Po qe se ky sulm në ndjekje do të kishte vazhduar, forcat partizane do të kishin shkuar drejt shpartallimit të plotë. Ky qe dhe një moment debatesh dhe mosmarrëveshjesh midis forcave nacionaliste, ishte ndërhyrja e Kaloshit për këtë ndërprerje sulmi.

Pjesëmarrja e forcave gjermane në këto luftime ishte pothuaj e papërfillshme, po ashtu dhe furnizimi me armë, municion dhe materiale.

Ndër shkaqet e humbjes së forcave partizane, ishte dhe pritja armiqësore e popullatës, dhe lufta shtëpi më shtëpi e banorëve, pa qenë nevoja e organizimit ushtarak të tyre.

Kjo përpjekje ushtarake midis forcave krejtësisht shqiptare, e cila kërkonte të forconte dominimin e palëve, ishte strategjia e P.Komuniste për ta spostuar luftën kundër forcave nacionaliste dhe nuk kishte të bënte me një luftë çlirimtare siç ishte propaganduar. Kishte filluar lufta për pushtet midis forcave partizane dhe nacionaliste. Kishte filluar Lufta Civile. Elementët e parë të kësaj lufte filluan në Dibër dhe më vonë në të gjithë malësinë e veriut (Mirditë, Shkodër, Malësi e Madhe, Lumë) dhe në Kosovë e Maqedoni, nën justifikimin e bashkëpunimit me pushtuesin e vjetër dhe për llogari të pushtuesit të ri, Jugosllavisë.

Theksojmë se në këto përpjekje nuk pati tejkalim të dhunës apo vjedhje e plaçkitje në zonat e marra nën kontroll nga forcat nacionaliste. Pati dhe robër nga forcat partizane, të cilët nuk u keqtrajtuan dhe u lanë të lirë pas luftimeve.

Ideja e drejtuesve të forcave partizane për të vënë dibranët në armiqësi me njëri-tjetrin dështoi. E gjithë zona e Dibrës tani ishte nën kontrollin e forcave nacionaliste. Rol kryesore në këtë fitore të nacionalisteve pati organizimi i luftimeve nga forcat e Miftar Kaloshit dhe Halil Alisë.

Kjo humbje u bë objekt përgjegjësie dhe mobilizimi për drejtuesit e SHPNCCL, të cilët po rigruponin forcat e Divizionit të I, për një sulm tjetër ndaj qëndresës së nacionalistëve me qendër në Peshkopi, Muhurr, Kandërr, Sinje e Fushë Alie dhe në Dibër të Madhe.

Furnizimet kryesore partizanët i morën nga partizanët Jugosllavë, dhe një pjesë nga furnizimet aleate me qendër në Bari të Italisë. Kështu filluan përgatitjet e planit për sulmin e dytë.

SULMI I DYTË, 20 KORRIK 1944

Ky sulm ishte planifikuar të bëhet i rrufeshëm, në shumë drejtime dhe me forca të mëdha ushtarake të Divizjonit të I Sulmues.

Forcat partizane filluan sulmin njëherësh në Dibër të Madhe, Peshkopi, Sinje edhe Fushë Alie, duke ruajtur fshehtësinë dhe befasinë. Sulmi filloi në mëngjes herët për ti kapur në befasi forcat nacionaliste.

histori

Lufta e Korrikut 1944 në Fushë Alie ishte një Luftë Civile me pasoja të një gjenocidi komunist të pakrahasueshëm gjatë Luftës II Botërore në Shqipëri.



Kjo bëri që ata të kapen të papërgatitura. Ato u organizuan në luftime e sipër pothuaj në hyrje të fshatrave e në prezencë të popullsisë së pambrojtur si fëmijë, gra e pleq.

Forcat e Batalionit të Sllovës sulmuan nga Shumbati, Brigata e IV nga Sinja dhe Brigata e I dhe e V në Peshkopi. Forcat partizane u bllokuan në kodrat përreth fshatrave Fushë Alie, Rrenc, Blliqe, Sinje e Epërme dhe Sohodoll e Guben.

Luftimet ishin shume të ashpra dhe që në momentet e para pati shumë të vrarë dhe të plagosur nga të dy palët. Në ndihme të forcave të Fushë Alies erdhën fshatarë të armatosur nga Mustafajt, Kodër Leshe, Arras etj.

Raporti i forcave ishte në favor të partizanëve.

Në këto kushte terrori, popullsia e pambrojtur sidomos në Fushë Alie, Laçe dhe Blliçe filloi evakuimin për në fshatra më të sigurt dhe larg luftimeve si në Mustafe, Lugje, Dardhe, Lurë etj.

Djegia e parë e shtëpive të banorëve dhe dëmtimi i pasurisë dhe bagëtive filloi që në Sinjë nga forcat e batalionit të komanduar nga Kadri Azbiu duke vazhduar në Blliçe në lagjen e Murrakeve ku u dogjën jo vetëm shtëpitë por dhe persona të gjallë e të pa armatosur (Jahe Murraku).

Kishte filluar tërheqja e fshatareve të armatosur në drejtim të Drinit.

Paralel me tërheqjen, sulmi i forcave partizane po shoqërohej me djegie, vjedhje e shkatërrime.

U shkatërruan dhe u dogjën shtëpitë, të mbjellat, bagëtitë në vathë etj. Llogariten rreth 350 shtëpi të djegura, 150 ha të mbjella me grurë e misër, 400 deri në 450 krerë bagëti të djegura dhe të vjedhura. Këto balance janë të krahasueshme vetëm me ato që bëri Serbia në zonën e Dibrës dhe Lumës në Luftën Ballkanike.

Të tilla pati në Rrenz, Blliçe, Laces, Fushë Alie dhe Sinë.

Këto veprime nuk u kryen në zona të tjera të rezistencës Sinë e Kastriot, Kanderr e Kishavec, pavarësisht se nga këto zona kishte mjaft pjesëtarë të rezistencës.

Furia e sulmeve 2 ditore u ndal në rrjedhjen e Drinit. Në zonat e djegura nuk ngeli asnjë banore. Halil Alia i tërhoqi forcat për në Mustafaj, Lurë e me vonë në Lumë, ku në çdo rast zhvilloi luftime të rrepta dhe me humbje njerëzore deri në vrasjen e tij në Kolosjan të Kukësit.

Në asnjë rast nuk pranoi të shkonte jashtë shtetit, siç shkuan një pjesë e parisë së Dibrës, por dha jetën me armë në dorë për idealet e tij antikomuniste.

Dilemat në konkluzionet dhe përcaktimin e kësaj lufte qëndrojnë kryesisht në përcaktimin real dhe shkencor të saj.

Kjo varet si nga përmasat e betejave, fuqia ushtarake dhe pjesëmarrja e trupave dhe teknikës ushtarake, natyra e veprimeve luftarake, pasojat gjatë dhe pas betejës, qëndrimi ndaj robërve dhe popullatës civile, dëmtimet materiale dhe pasurore, tejkalimi i masës gjatë veprimeve luftarake, shkelja e marrëveshjeve të armëpushimit apo të paqes etj.

FAKTET DHE KONKLUZIONE:

1. Për nga drejtimi politik, forcat drejtoheshin nga Partia Komuniste dhe fraksionet nacionaliste antikomuniste.

2. Terreni i veprimeve luftarake ishte në zonat e banuara dhe rreth tyre.

3. Pjesëmarrësit ishin fshatare lokalë, të armatosur, pa uniformë dhe të paorganizuar ushtarakisht në reparte e nën reparte (Vete propaganda komuniste i quan bashibozuke). Me gjithë propagandën komuniste, nuk ka patur pjesëmarrje të forcave të okupatorit. Pjesëmarrësit e forcave partizane ishin nga zona kryesisht jashtë Dibrës, përfshirë dhe maqedonas. Përveç Dali Ndreut dhe Haxhi Lleshit, asnjë komandues nuk ishte dibran.

4. Forcat partizane ishin forca të rregullta ushtarake, si për nga uniforma, armatimi dhe hierarkia ushtarake.

5. Sulmi në të dy rastet është kryer nga forcat partizane, kurse popullata e armatosur ishte në mbrojtje të fshatrave, shtëpive dhe familjeve të tyre.

6. Karakteri i kësaj lufte ishte kryekëput lufte jo kundër okupatorit, por luftë për marrje pushteti me dhunë kundër popullsisë që nuk e donte komunizmin.

7. Kjo luftë nuk ishte për të rrezuar pushtetin apo qeverinë, e cila nuk ishte formuar. (Sipas PK ishte formuar më 24 Maj 1944 në Përmet, por ishte thjesht një spastrim politiko- etnik i kundërshtarëve.)

8. Për nga qëndrimi dhe veprimet e dhunshme para, gjatë dhe pas beteje, kjo beteje ushtarake degjeneroi në terrorizëm, gjenocide dhe plaçkitje të zonës ku u zhvilluan veprimet luftarake.

9. Për nga bilanci i dëmeve në njerëz, kjo betejë ka qenë nga më të përgjakshmet e kryer dhe nga forcat e okupatorëve nazi-fashist gjatë Luftës se Dytë Botërore në Shqipëri. (Qindra të vrarë e të plagosur).

Përpjekje me armë midis forcave nacionaliste të rregullta dhe atyre partizane, ka patur gjate kësaj kohe në Ersekë, Gjirokastër, Vlorë e Krujë etj.

Rasti i luftës së Korrikut 1944 në Fushe Alie është rast tipik dhe i veçante për nga karakteristikat e mësipërme.

Kategorizimet e veprimeve të tilla luftarake, si gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore janë përcaktuar si **Luftë Civile**.

Partia Komuniste e Shqipërisë, SHPNCCL dhe Qeveria Komuniste, gjatë dhe pas luftës, u kujdesën që ta mbulojnë me propagandë të gjithë këtë gjenocid që u krye në Fushë Alie. Ato kurrë nuk i bënë një analizë dhe nxjerrje përgjegjësie për komandat dhe komandantët ushtarakë që urdhëruan dhe drejtuan këtë masakër dhe as deklaruan dëmet e shkaktuara në njerëz, mall dhe në veprimet çnjerëzore.

Në Arkivat partiake, shtetërore dhe ushtarake nuk gjen asnjë gjurmë të urdhrave të dhënë për kryerjen e këtyre veprimeve. Pjesërisht, drejtues partizan të këtyre veprimeve, kanë pranuar se ka patur djegie e shkatërrime të cilat janë kryer pa urdhër, nga partizanë të shkëputur, që i kanë kryer për hakmarrje ndaj shokëve të vrarë. Siç është deklarimi në hetuesi i Kadi Hazbiut, në kohën që u cilësua tradhtar nga E.Hoxha. Por në asnjë rast nuk u distancuan nga këto veprime dhe nuk bëhet fjalë për të kërkuar falje.

Në asnjë moment tjetër, nuk u analizua ky gjenocid, as në forumet partiake dhe ato ushtarake të PKSH –së. Nuk ka se si të ndodhte ndryshe, pasi në këto veprime ishin përfshirë drejtuesit më të lartë ushtarakë të PKSH si Mehmet Shehu, Shefqet Peçi, Petrit Dume, Kadri Hazbiu, Hazhi Lleshi e Dali Ndreu.

Kjo luftë u identifikua si luftë kundër Halil Alisë, dhe jo si rezistencë e popullsisë ndaj invazionit komunist. Halil Alia nuk ishte vetëm. Me të bashkëpunonin të gjithë forcat antikomuniste në Dibër, Lurë e Lumë. Këto forca nuk i komandonte vetëm Halil Alia por dhe Miftar Kaloshi, Sef Kaloshi, Selim Xhetani, Muharrem Bajraktari, Dine Dema e Fiqiri Dine etj.

Veprime me dhunë që u kryen nga forcat partizane dhe në Lumë, Mirditë dhe në Malësinë e Shkodrës, janë analizuar dhe disponohen dokumente, të paktën pas prishjes me Jugosllavinë, ku del në pah që këtu kishte dorë PKJ.

Me pushkatimin e Dali Ndreut nga Qeveria Komuniste, u bë vetëm propagandë, por nuk pati një analizë të thellë të Luftës së zhvilluar nga Divizioni I Sulmues në Veri.

Popullsia e kësaj zone, përveç tmerrit dhe gjenocidit që përjetoi në vitin 1944, vazhdoi të mbahet nën terrorin komunist dhe përgjatë gjithë sundimit komunist.

VËSHTRIMI I NGJARJEVE PAS VITIT 1944

Pas vitit 1944, vazhduan dënimet me vdekje, sekuestrimet e mallit dhe bagëtive, internimet, privimet e lirisë dhe të arsimit, mungesë së përkrahjes ekonomike etj.

Këto reprezalje u bënë me fushata të planifikuara dhe të zbatuara nga Sigurimi i Shtetit.

Më të rënda kanë qenë vrasjet, burgosjet dhe internimet gjatë vitit 1945-1946, 1950-1956, gjatë kohës së kolektivizimit dhe luftës ndaj fesë 1960- 1967 dhe në vitin 1974.

Kuadrot që vinin në Dibër, merrnin notën nga Qeveria komuniste bazuar në masat e mësipërme ndaj popullsisë kryesisht në Fushë Alie, Blliçe, Laçes, Sinjë etj.

Kane ngelur në memorien e zezë të popullatës emrat e Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu, Zoi Themeli, e një lukuni kryetare dege, prokurore e Sigurimsa.

Në këto kushte terrori, mjaft familje u arratisën jashtë shtetit, ndër to dhe familja e Halil Alisë.

Masakrat dhe vrasjet në kufi, janë nga me rrënqethset. Mbi të afërmit e tyre u derdh e gjithë egërsia e pushtetit komunist.

Qeveria komuniste, pas çlirimit bëri masakra dhe në Mirditë, Postribë, Malësi të Madhe etj. Por masakra e Fushë Alie është e veçantë se filloi që gjatë luftës dhe vazhdoi për 50 vjet regjim komunist.

DIMENSIONE TË REJA PAS VITEVE '90

Pas viteve '90, përpjekjet e shumë intelektualëve dibrane e çidhnakë për zbardhjen e këtyre ngjarjeve kanë qenë evidente. Monografi, promovime figurash, ngjarje dhe analiza të këtij gjenocide kanë qenë evidente dhe me përgjegjësi.

Në vazhdimin e këtyre përpjekjeve, e ndjeva detyrë që këtë gjenocid të pashembullt komunist, këtë ***Luftë Civile*** që u zhvillua në Fushë Alie ta shtjelloj në një formë analize shoqërore, sociale, ushtarake dhe administrative të saj.

Saktësinë dhe kronologjinë e ngjarjeve, më është dashur ta ballafaqoj me një seri studimesh, monografish dhe të dhënash zyrtare dhe gojore të dhëna si nga burimet komuniste dhe ato që morën dritë pas viteve '90.

Është e pakët të kërkojnë falje për atë që bënë komunistët për 50 vjet në Fushë Alie, por është e pafalshme të harrohet ai makabritet që u krye në këtë zonë me tradita atdhetare ku heronjtë e tij kanë dhënë jetën brenda e jashtë Dibre: kundër turkut në Radikë të Dibrës së Madhe, në luftë kundër Serbit në Dibër, Shkodër e Gjakovë dhe në formimin e mbrojtjen e shtetit shqiptar me 1912 dhe më vonë. Ndër figurat më të spikatura në këto luftëra kanë qenë djemtë e burrat e Çidhnës si: Sal Demiri, (Alia), Selman Alia, Shaban e Demir Lusha, Sali Noka etj.

PËRFUNDIME

Lufta e Korrikut 1944 në Fushë Alie ishte një Luftë Civile me pasoja të një gjenocidi komunist të pakrahasueshëm gjatë Luftës II Botërore në Shqipëri.

Ajo mori përmasat e një spastrimi politiko-etnik që vazhdoi deri në vitet '90.

Duke e ndjerë si një detyrë qytetare dhe si bir i Fushë Alies, në këtë shkrim jam munduar të ndriçoj sado pak atë se çfarë ndodhi në Korrik 1944 dhe më vonë në këtë zonë.

Trajtimi i këtyre temave kërkon kurajo civile dhe qytetare, por nuk duhet të ngelen tabu.

Brezat duhen të njihen me realitetin e tyre, dhe pastaj të mbajnë qëndrimin e tyre.

Kjo është dhe një farë ndjese dhe homazhi ndaj atyre që dhanë jetën për të mbrojtur idealet e tyre, fshatin, familjen e pronën.

Populli i kësaj zone e meriton të vlerësohet dhe të "shkojë haka tek i zoti".

Qëndrimet politike ndaj kësaj ngjarje makabre kanë qenë dhe janë të ndryshme, elektorale, krahinore dhe nganjëherë të qëllimshme. Por nuk duhet të harrojnë se aksionet antikomuniste të zhvilluara gjatë dhe pas luftës kundër instalimit të diktaturës komuniste në Shqipëri, ia ngrenë vlerat luftës së popullit tonë për liri e demokraci.

Gjithashtu, dua të ritheksoj se në asnjë rresht të këtij shkrimi nuk kam patur qëllim të denigroj familjet e mëdha të zonës, veçanërisht familjen Ndreu, e cila ka një kontribut të vyer në luftërat për pavarësi. Vetë fakti që qeveria komuniste, këtë familje, e vrau, e dënoi, e internoi dhe e masakroi pas çlirimit tregon të vërtetat e gabimeve të bëra në Korrik 1944.

Rreth temave të mësipërme, historianë dhe studiuesit dibranë dhe të tjerë, janë të mirëpritur për të ndriçuar me debate dhe fakte historike.

Kjo mund të bëhet në çdo kohe dhe kudo..

** Gjeneral brigade në rezervë*
Tirane, Qershor 2013.

Rruga e Arbërit nr. 87

Bisedë me tetëdhjetë e tre vjeçarin
Beqir Daut Hoxha

skicë & vjersha

Arbnesh, or vëlla!

Nga **SELMAN MËZIU**

Biseda me tetëdhjetë e tre vjeçarin Beqir Daut Hoxhën në oborrin e shtëpisë së tij në gushtin e vitit të kaluar, u zhvillua e qetë. Ai iu përgjigjesh me korrektes, pyetjeve të mia. Por një ngjarje që më la shumë përshtypje, është dëshmia e mëposhtëme:

"Një pranverë jo e zakontë kishte trokitur edhe në Kurtin e Boxhoit. Zhurma e brishtë e saj, kishte tronditur shpirtrat. Qielli kishte ndierë zhurmën therëse të avionëve ushtarak. Edhe lulet e sapoçelura, mugulli i shelgjeve, plepave, e dushkajave nuk kishte hijeshinë e gjithhershme. Dikush nga perëndimi i largët kërkonte që këtë truall ta plagoste e rrjepte për së gjalli.

E qeshura, këtyre njerëzve i kishte braktisur marrëzisht. Një brengë në shpirt filloi të formohej edhe për Muhurrakun. Ishte viti i fundit e dhjetëvjeçarit të tretë të shekullit të njëzetë. Trupat italiane, me kuaj e mushka të fuqishme çanë mes përmes Drinin plakë. Edhe ai shkumëzoi nga inati. Njerëzit ishin strukur edhe sepse sa u kishte vdekur Sokrati dhe majori i tyre, Dine Hoxha.

Kryeplaku Jonuz Lala, burrë me trup mesatar, fytyrë hollë, kishte marrë frenat e drejtimit të krahinës. Pushtuesi solli me vete, topa, mortaja që i tërhiqnin kafshët e samarit. Ndërsa të tjera të ngarkuara me ushqime, veshmbathje, pajisje mjekësore e ilaçe farmaceutike, armë të lehta, të cilat trokëllinin sertshëm e frikshëm, udhëve të ngushta të Mokrës antike.

Karvani ishte i gjatë, hijerëndë dhe të fuste tmerrin. Për ne cullët e fshatit buzë murras, ishte një pamje e trishtueshme dhe e frikshme sa s'ka ma. Zemra ime trokiste fort mrena gjoksit. Edhe pse nuk vinin nga brigjet e Danubit ato mëkonin shpirtrat me frikën drithëronjëse. Një truproje u vendos tek Lisi i Ali Krashit, aty ku shihej plotësisht faqja e Malit të Shmrais, gryka e Murrës, dhe pjesërisht e përroit të Shqathit. Çadra e madhe e shërbimit mjekësor u ngul në Lamën e Milloshit. Ara e Seferit u mbush me çadra e ushtar si mizat e dheut. Në Thanzë u shfaq befasueshëm një grup ushtarësh armatosur gjer në dham, të cilët dogjën shkollën, zyrat e Komunës dhe dyqanin e tregtarit sheherli Trajka. Ku edhe birrat që kishte pranë pusit për tu fohur ia thyen. Nuk ishte gjë tjetër veçse shembëlltyra e gjakosjes, e cila sapo kishte shtërnguar pamëshirshëm dhëmbët e pushtimit.

Një çadër ngjyrë gri ku ishin pesë ushtar, u vendos pranë shtëpisë time. Ndërtue prej qitash e mulume me kashtë thekni. Unë isha veç shtatë vjeç. Ato ishin me trup të gjatë e të lidhun. Dukeshin të urtë. Por revolverin e mbanin në brez edhe kur çdo mëngjez dilnin në krua e lanin sytë. Kokën e mbanin të qethur zero e flokët sikur iu ndrisnin. Uniforma e pastër, pantallonat të ngjeshura pas kamëve e të lidhura në fund, ndërsa xhaketa e kopsitur me dy xhepa në lartësinë e gjoksit.



Në horizont Xharxhishti e Runja e Lurës.

Ato patrullonin çdo dy orë, në gjithë udhët e fshatrave ditën me diell e natën me ose pa hane nën yjet e shumta. Flisnin gjuhën e tyne, ku disa fjalë i kuptonim se ngjanim me tonën.

Kur dyshonin, të kontrolloin për s'mari. Ne fëmijët filluam të mësonim fjalë të ndryshme, sidomos ato me përdorim të përditshëm. Na jepnin ndonjëherë ndonjë gavetë me makarona e ndonjë copw buke gruni. Më shumë kohën me ato e harxhoja unë. Babai lëshonte dhitë e delet për kullot. Dukesh ashiqare se ai nuk i shihte me sy të mirë. Edhe pse ato e përshëndesnin gjithmonë me kokë, të qetë dhe me edukatë.

Një ditë prej ditësh, njëri nga ushtarët i afrohet babait. Pasi e pyeti për fëmijët e mbarëvajtjen e blegtorisë iu drejtua me sytë ngulur në fytyrën e tijë:

- Ku asht Lurja, Lurna- këto fjalë i tha me një shqiptim të perçartë, por për çudi ato ishin shqip. Edhe pse jo e folme e rregullt e as në dialektin dibran.

Babai shtangu në vend, i hodhi një vështrim të shpejtë nga kreja te kamët. Sytë iu mjegulluan, e buzët mezi i lëvizi duke nxjerrë këto fjale:

- Çfarë u lidh me Lurën? Duke lëvizur edhe duart, për t'i dhanë me kuptue ma mirë ato që dëshironte ti thoshte.

Unë shikoja herë njanin e herë tjetrin. Fjalët e tyne më nguleshin lehtësisht në trurin tim njomzak, dhe më duken se edhe tani i kam përpara meje.

- E kam rrethën nga ai ven. Am Arbnesh - fityra sikur iu çel me sa duket u lirua nga emocionet. Prandaj ushtari foli më ngrohtësisht e lirshëm e sytë i ndrisnin me një shkëlqim dashurie.

Babai nuk priti ma, dhe i hodhi dy krahët ne qafë dhe e përqafoi, duke e afruar pas trupit të tij me forcë. Mua më ngjau sikur ato ishin vëllezër, domethënë të dalë nga nji bark nane.

Përpara kishin pemë te larta, kështu që u larguan dy ose tre metra, dhe babai duke ngritur krahun dhe nxjerre gishtin tregues i tha:

-Atje ne horizont ku duket së pari Xharxhishti e më pas Runja mrapa atine asht vendi i quajtur LURA.

Djaloshit trup gjatë dhe hollak i shpërthyen lotët. Ato I rrokullisheshi si orteqe nëpër faqet e njoma djaloshare. Ishte aroma e dheut të prejardhjes. Stërgjyshërit e tij ishin larguar nga ajo krahinë qindra vjet ma parë.

Edhe mua më përpin emocione të forta. E pyeta veten: Pse kaq i mallshëm ashte dheu ynë. Brigjet, luginat e kurrizet me pishnaja. Gjurra ku buron ujit e ftohte e pinë unshëm fëmija e qingjat. Ndërkaq ato bisedonin. Natyrisht gjuha e amël i bashkoi, gjaku i gjakut, zakonet e traditat që kishte ai si arbëresh në vendlindje ngjanin si dy pika uji me tonat. Sa mir kështu!

- Jemi larguem që pas vdekjes së Kastriotit të madh. Kanë vuajtur shumë të parët e mijë, për të siguruar bukën e gojës e rritur neve. Ndërsa tani të mallkuarit na kanë futur në ushtri me forcë. Më kanë sjellë këtu ne mes këtyre maleve kreshnike për të vrarë e gjakosur vëllezërit e mi. Njerëzit e një gjaku. Por unë se bëj kurrë këtë gja. Si menon ti, a e kam mirë? - duke e shikuar, në beben e syrit babain, bile, herë herë edhe mua,- unë flejë me çadër në trojen tanë - vazhdoi ai por me një zë që ziente nga një zemërim i brendshëm - ha,

> "Një ditë ushtari italian e pyet babain:
> - Ku asht Lurja, Lurna? Këto fjalë i tha me një shqiptim të perçartë, por për çudi ato ishin shqip.

pijë e flejë gjumë për bukuri mbi këtë truall, e nesër të të ve pushkën në lulen e ballit e të vras. Jo, jo.. Kurrë, kurrë, asnjëherë.....

Ai u skuq i tani edhe majat e veshëve iu kthyen si qershia në qërshorin plotë diell. Ndërsa lotët, nuk i mbajti, se zemrimi i kishte pushtuar shpirt e zemër. Ato nuk komandoheshin ma. Arsyeja ishte bërë mbretëresha e qenies të ketij djaloshi të fuqishëm e plotë energji.

Familja jonë tanime i ftoi edhe për darka e dreka, edhe ato na ftonin në çadrën e tyre. Kështu u miqësuam, mësuam nga njani tjetri shume gjana, nga e kaluara dhe jeta e përditshme.

Nuk kaluan veçse disa muaji dhe ato u transferuan. Që nga ajo kohe ne nuk dimë se ku përfundoi LURIANI i shkretë si ushtar i Duçes për të gjakosur vëllezërit e tij. Por ai u betua se gjaku nuk shkelet, por pihet e bahesh birazel me atë tjetrin ngado qoftë, e ngado që vjen, pra me një fjale ose ma qartë vëllazën.

Shënim: Shkruar sipas kujtimeve të Beqir Daut Hoxhës, Fushe Muhurr, Lagjia Hoxhe. Dibër

Firence 11.11. 2012

Vjersha nga Donika Paci

GJYSHIT

Ike, u largove si zog shtegtar,
Fluturove lart,
Pa të vënë dorën në ballë.
U largove si engjëll,
Kur nuk e prisnim...
Vajzat pa përqafuar i le,
Ndërsa djemtë të përcollën të përmalluar...

MURANA

U lodh shpirti,
U lodh zemra,
Çdo gjë tani ka mbaruar.
Lumturinë kurrë nuk gjeta.

Ike sikur s'kam qenë kurrë,
Dashurinë në lum e hodhe,
Ndjenja që na goditi u shua,
Zemra s'mendoi më për mua.
Muranë do bëhem!

DUA PAK JETË...

Boll më sundove,
Boll më shkatërrove,
O dhimbje!...
Lërmë të jetoj,
së paku një ore,
një ditë, një muaj a vit,
Mos më godit,
Kështu, çdo ditë,
Boll...

SHPIRTI

Si vargonj janë kapur
mendimet,
Dorë për dore.
Përpiqen të gjejnë një shteg,
Të trokasin për pak ngrohtësi.
Gjithandej bën ftohtë.
Zemra ka ngrirë.

DIMËR

Dimër, ky shpirt.
Dimër dhe acar.
Diell nuk ka më,
Të ndriçojë si më parë.
Pranverë nuk ka,
që çel në shpirtin tim
Veç dimër i ftohtë
Dëborë pa pushim...

DIELLIT IU LUTA

Një ditë i thashë diellit:
Eja më ngroh!
Dielli mu përgjigj:
-Jo, nuk mundem!
Rrezet e mia nuk hyjnë dot!

Ju luta hënës:
Natën më bëj dritë,
Se ma mbyti shpirtin errësira!
Hëna më tha:
- Drita ime u shua!
Dashurisë i thashë:
- Të lutem më gëzo,
me zjarrin tënd shpirtin
ma ngroh!
Mos më largo, mos më verbo!

Por dashuria iku,
Tani nuk e shoh...

Këto dy poezi janë shkëputur nga libri i sapodalë në treg i aktores Marika Kallamata "Të dashur kolegë", botim i "Tirana Times".

Aktorë të mirënjohur dibranë

Ikona të Teatrit dhe kinematografisë shqiptare

Sulejman Pitarka, lindi më 2 shkurt të vitit 1924 në Dibër dhe vdiq në Tiranë më 24 mars të vitit 2007. Ishte nje aktor shqiptar i gjysmës së dytë të shekullit XX, i nderuar me titullin Artist i Populllit.

Sulejman Pitarka ka luajtur me sukses rreth 50 role në Teatrin Kombëtar të Tiranës dhe 20 të tjerë në kinema. Ka hyrë në historinë e dramës shqipe si autor i dramës "Familja e peshkatarit". Më 1927, kur ai ishte në moshën tre vjeçare, familja e tij u vendos në Durrës. Këtu kaloi fëmijërinë. Pas mbarimit të shkollës së mesme, filloi punë në bankë.

Disa përvoja skenike, pothuaj rastësore, gjatë shërbimit ushtarak (1945 – '47) e shtynë të interesohej më shumë për teatrin dhe të përfshihej në lëvizjen amatore të Durrësit. Më 1951, u përzgjodh për t'iu bashkangjitur



trupës, ende në formim, të Teatrit Popullor (sot Kombëtar) në Tiranë, ku u bë menjëherë margaritari i kurorës. Luajti rreth 50 role, duke shkëlqyer njësoj, si në dramë, ashtu edhe në komedi.

Sulejman Pitarka më 3 shkurt 2002 është shpallur "Qytetar Nderi i Dibrës".

Një tjetër figurë e njohur e kinematografisë shqiptare është ndarë nga jeta. Aktorja e mirënjohur e skenës shqiptare, Esma Agolli, ndërroi jetë në moshën 82-vjeçare. Familjarët thonë se Agolli humbi jetën pas një infarkti kardiak, në shtëpinë e saj në Tiranë. Esma Agolli është një nga aktorët më të njohura të teatrit dhe të kinematografise shqiptare, sidomos për rolet e karakterit. Esma Agolli u lind më 1 korrik 1928 në Tiranë. Karrierën e saj e filloi në vitin 1948, duke interpretuar rreth 60 role.

Agolli ishte një figurë e njohur e ekranit, pasi kishte interpretuar në disa filma si "Pertej mureve të gurta", "Fëmijët e saj" dhe pjesë të tjera



teatrale. Ajo ka luajtur shumë role në teatër dhe kinematografi, por rolet qe spikasin jane "Mysafiri" ne vitin 1979, Zonja Neriman te filmi "Pertej mureve te gurta" ne 1979. Esma Agolli mban titullin "Artiste e Merituar".

ESMA AGOLLI

"Artiste e Merituar"

Vajtën Hënës dhe i thanë
se një vajzë në Tiranë,
lindur nga prindër dibranë:
- Ty moj Hënë fort të ngjan.

Tha Hëna: - Çfarë thua,
qënka një vajzë që më ngjan mua?
Dua vetë ta shikoj,
këtë që thatë ta verifikoj.

Shëtiti Hëna anembanë,
lëshoi rreze në Tiranë,
nga dritarja pa Esmanë
- Po, po mua më ngjan,
kjo që më thanë është e vërtetë,
veç kur jam e plotë, pesëmbëdhjetë.

Hëna nuk u zemërua,
përkundrazi u gëzua,
bilé edhe u zotua:
- Për këtë vajzë që më ngjan mua,
do kujdesem, do ta dua.
Dhe tha me ngadale:
- Fale Zot, fale, jepi bukuri orientale.

Hëna Makën e kundronte,
me rrezet e saj e ledhatonte,
mirësi i dhuronte,
jetë të lumtur i uronte.

U rrit Esmaja plot hire
ndër të tjera më e mira,
e zgjuar dhe me edukatë
në shoqëri gojëmjaltë,
nëpër mbledhje gojëshpatë.
Pastaj Maka u bë aktore,
luajti shumë role kryesore
dhe në ekrane e pamë
në disa role Esmanë.

U bë nënë edhe gjyshe
së shpejti dhe stërgjyshe,
teze dhe stërteze,
hallë dhe stërhallë,
u shtoftë dhe u bëftë një mëhallë.

Hëna fjalën e ka mbajtur
gjithnjë në kujdes e ka patur,
që sozia e saj të jetë e re
dhe jo e plakur.

Se njëherë, kur ishim ne
në Maqedoni në turne,
vjen kamarieri serbes-serbes
i drejtohet asaj gjithë finesë:

- Zonjushë, çfarë do të merrni për mëngjez?
Ajo e shikon me mëdyshje:
- Faleminderit, por unë jam gjyshe.
Atëhere fjala nuk më shkoi kot,
dukej gjyshja më e re në botë.

Dhe tani që është në pension
është e mirë dhe goxha zonjë,
e them dhe të gjithë e thonë,
megjithëse ka kaluar koha e rinisë,
nuk ka shenja të pleqërisë.

I urojmë Makës: - Jetë të gjatë,
Ishallah, merr shtëpi dhe bie rehat!
(se tani në vitet e demokracisë,
ka dalë lëng stërlëng i zoti i shtëpisë)

I uroj gëzim e shëndet ngahera
mbushtë dhe njëqindenjëzet pranvera!

Tiranë, më 08 Shtator 1997

SULEJMAN PITARKA

"Artist i Populllit" – "Mjeshter i Madh i Punes"

Në qytetin e Durrësit u aktivizua në teatrin amator
dhe në vitin '51 në Teatrin Popullor,
aktor me një gamë të gjerë, në dramë e komedi,
në interpretimet e tij figura me shumë larmi,
rolin e parë në teatër e nisi me një dublim.

Në dramën "Halili dhe Hajria"
malësorin, luftëtarin trim Halil Goria,
në "Gjashtë dashnorët" Stefani,
te "Shtatë shaljanët" Osmani.

Te "Toka jonë" përgjegjësin e rinisë Meti,
Hasan agën te komedia "Prefekti",
në "Shërbëtorin e dy zotërinjve" doktori,
te "Borgjezi fisnik" profesori.

Shçevkinin te komedia "Revizori",
në dramën e Brehtit "Arturo Ui" aktori,
i thirrur nga Artur diktatori
që atij t'i mësojë, si të flasë, të pozojë e qëndrojë.

Xha Nuron në "Furrënaltën",
që shqetësohet për gjithçka
e s'e ze gjumi natën.

Te "Zonja nga qyteti" xha Bakon e mirë e me humor,
që gjithë fshati e nderon,
por me teto Ollgën mirë nuk shkojnë,
e me fjalët hidh e prit, njeri tjetrin thumbojnë.
Mundohet xha Bakua i ngrati,
që zonjën nga qyteti, ta bëjë shoqe fshati.

Në "Epokën para gjyqit"
një figurë historike interpreton
Sulejman Vokshin,
patriotin shquar të kombit tonë.

Në dramën "Shënomëni dhe mua"
Rrapo Shkëmbin ka interpretuar
e në Festivalin Kombëtar në vitin '76
aktori më i mirë u vlerësua.

Mbas 15 vjetëve nga teatri larguar
u ngjit në skenë një rol të ri për të interpretuar,
në dramën "Pjata e drunjtë" babanë,
shkruar nga Morrison, shkrimtar amerikan.

Sula në këtë rol shkëlqeu, pati shumë sukses,
në spektatorë la të madhe mbresë
e në Festivalin Teatral Kombëtar
si aktori më i mirë mori çmim të parë.

Ai ka interpretuar mbi njëzet role në kinematografi
tipa, karaktere me shumë larmi,
te "Debatiku" mësuesin demokrat,
në "Horizonte të hapura" një burokrat,
njeri negativ, personazhin Sokrat.

Në "Gunat përmbi tela" gjeneralin italian
ardhur pushtues nga përtej bregut matanë,
ironik, përbuzës, mospërfillës, prepotent
me mëndjemadhësi flet
për supermacinë e shtetit të vet.

Zenel beun te "Historiani dhe kameleoni",
gdhendësi i drurit, xha Avdiu,
te "Gjeneral gramafoni".
Në filmin "Ballë për ballë", admiral Zheleznovi
interpretuar me mjaft mjeshtëri,
një tjetër figurë e arrirë në karrierën e tij.
Në "Nxënësit e klasës time", Çelo Kasapi,
një rol i vogël, por që spikati.

Ai në mënyrë perfekte
është njohës dhe flet shumë dialekte,
si në Jug e në Veri
dhe në Dibër, ku origjinën ka ai.
I përdor herë pas here,
kur i duhen për tipa e karaktere.

Në shoqëri i këndshëm
dhe me humor gjithmonë,
i dalluar për batutat që lëshon,
si dhe për lojrat që sajon.

Nuk mund të rrijë dot rehat
pa bërë ndonjë numër a gallatë.

Një herë, në një turne në Elbasan,
një shokut tonë gjyslyket e diellit
nga dora i ranë
dhe copë-copë iu thye një xham.

Na lajmëruan, bëhuni gati,
mos u vononi shumë,
se në ora dhjetë
do bëjmë vizitë në muzeum.

Sulës ndërmend i shkon
që me gjyslykët të bëjë një lojë,
fshehurazi ia merr shokut në dhomë
dhe i pari në muzeum shkon.

Atje drejtorin takon
për shakanë që do bëjë i tregon.
Ai buzëqesh e pranon
dhe vetë e shoqëron në pavion i shkreti,
atje ku ishin ekspozuar gjetje arkeologjike
nga antikiteti.

Sa hyn, shikon në sallë,
ku qëndronte në piedestal, i ngritur pak,
bustin e një perandori romak.

Për Sulën kjo mjaftoi,
ia ve në sy gjyslykët perandorit
dhe pret të vijnë të tjerët në hyrje të oborrit.

Sallat me radhë i vizituam
në heshtje, nuk u nxituam,
me vëmendje e interes i shikuam,
por kur hymë të shohim objektet e lashtësisë
papritur qetësia u prish.

Qeshëm e u argëtuam
dhe Sulën e përgëzuam
për këtë lojë që kish sajuar.
Pastaj gjyslykët perandorit ia heq
dhe me pompozitet ia kthen shokut e i flet:

"I gëzofsh, t'i mbash me shëndet,
t'i dhuron perandori vetë".
E përsëri grupi duartroket
për këtë lojë me shumë lezet.

Sula jo vetëm aktor i madh e i shquar,
por dhe dramaturg i dëgjuar
shumë drama ai ka shkruar.

Po përmend pikë së pari
dramën e bukur "Familja e peshkatarit",
me temë nga lufta për liri e popullit tonë
në vitet nën okupacion.

"Trimi i mirë me shokë shumë", shkruar
 për kryengritjet shqiptare shekujt e kaluar,
"Udhëkryq e barrikadë", "Burri me përparëse"
dhe të tjera drama me tema familjare e shoqërore,
me probleme të përditshme të asaj kohe.

Sula ynë i dashur e i respektuar
për krijimtarinë e tij gjithmonë i vlerësuar
me tituj dhe çmime është nderuar.

Rruga e Arbërit nr. 87

Veprimtaria e Sheh Hajredinit, shembull i lartë patriotik, një kushtrim për bashkëkohësit dhe brezat në mbrojtje të qenies kombëtare.

Hajredin Shehu, *një shembull i atdhetarizmit*

Nga **DESTAN RAMA**

VENDLINDJA

Në mes të një lugine të bukur në formën e lugut, të rrethuar nga të dy anët e saj me male, kodra e rrafshnalta, ndodhet fshati Zerqan.

Fshati është i vendosur ne anën të djathtë të zallit të Bulqizës, në rrjedhën e mesme të tij, mbi një rrafshnaltë të bukur plot livadhe të gjelbërta, shkurre dushku, plantacione gështenjash dhe mbi të gjitha ujëra të ftohta e të kristalta. Duke u mbështetur në dokumente burimore mendohet se ky fshat është një vendbanim i hershëm. Njohja e tij daton 18 maj 1273 në një diplome të Karlit të I Anzhu, ku ai i dhuron fisnikut Pal Gropa nga fshati Gropa, që ndodhej në rrethinat e Zerqanit, disa feude.

Njerëzit e mire, inteligjente e të butë të Zerqanit e kanë marrë në sy shumë herët botën. Ata kanë sjellë që andej nga e shkuara gjëra të reja, ide të reja, përvoja të reja për vete dhe për të tjerët. Mbi të gjitha mësuan se bota pushtohet me të ditur dhe jo me të mundur. Pra, dija është pasuria më e madhe për njeriun në këtë botë.

Zerqani në shumë vite ka qenë nyje lidhëse, ku kalonin rrugët që lidhnin qytetin e Dibrës së Madhe me malësinë dhe Krujën. Që nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë Zerqani u shndërrua në qendër nënprefekturë me Sheh Sulën nënprefekti i parë.

Pra në këtë fshat me tradita të hershme patriotike, atdhetare e kulturore me një pozitë gjeografike të shkëlqyer, me njerëz të mrekullueshëm, me një Teqe me disa breza klerikësh të dëgjuar lindi kleriku Hajredin Shehu, me 4 qershor 1882.

Vitet e para të fëmijërisë i kaloi pranë Teqes nën kujdesin e prindërve dhe xhaxhait Sheh Sulës. Prej tyre mësoi dhe u edukua me bëmat e të parëve për luftërat kundër pushtuesve osmane.

SHKOLLIMI

Mësimet e para i kreu në mejtepin turk, që tashmë ishte hapur nga qeveria turke në Zerqan. Më pas, fshehurazi mësoi shkrim e këndim shqip. Gjatë këtyre viteve krahas të atit, i qëndroi pranë Sheh Sula. Nën kujdesin e tyre u dërgua të vijojë mësimet në Manastir, ku për 7 vite kreu shkollën e ulet dhe të mesme. Rreth vitit 1904 Hajredin Shehu dërgohet për studime në Stamboll. Në shkolle veç shkencave të kohës mësoi; turqisht, arabisht, persisht e frëngjisht. Lexon ne origjinal "Rubairat" e Omer Kajamit. Këtu kishte kaluar shumë vite Sheh Sula si student, por edhe i internuar.

NË SHËRBIM TË ATDHEUT

Manastiri ku Sheh Hajredini vijoi studimet deri në të mesme, ishte qendër e rëndësishme e lëvizjes kombëtare shqiptare. Këtu ai njihet me shumë atdhetarë dibranë. Në Manastir përveç arsimit te fituar, Hajredini u vu në lidhje edhe me rrethet patriotike. Bashkë me studentë të tjerë merr pjesë në një sërë veprimtarish me karakter atdhetar kombëtar.

Në vitin 1903 rreth moshës 20 vjeç kthehet në vendlindje, Zerqan. Në këtë kohë roli i Teqes nën drejtimin e Sheh Sulës ishte rritur shumë. Edhe familja ishte fuqizuar ekonomikisht.



Në vitin 1904 Hajredin Shehu ndodhej në Stamboll për studime. Aty kishte edhe mikun e vet të familjes, Riza Ali Valikardhën (Gurra). Ai i ofroi gjithë mbështetjen. Këtu u afrua me rrethet atdhetare. Njihet me shumë shqiptare dhe njerëz nga Gryka e Madhe dhe Bulqiza. Ishte përkrahes i lëvizjes Xhonturke, i revolucionit të tyre. Propagandonte idetë e tyre dhe bashkë me Tushin dhe luftëtarët e Grykës së Madhe angazhohet në përpjekjet që bëheshin për përmbysjen e regjimit të Sulltan Hamitit.

Turqit e rinj për ta patur krah Teqenë në qëllimet e tyre, pas revolucionit i ofruan detyra të ndryshme. Punoi komisar policie në Shkodër e më pas në Tiranë. Në vitet 1909-1912, meqë Sheh Sula ishte në moshë të thyer, Hajredini kthehet në Zerqan. Këtu ofron ndihmesën e tij pranë Teqes, por edhe ndaj lëvizjes kombëtare. Veprimtaria e tij u bë e njohur në tërë krahinën dhe më gjerë. Hajredini bashkëpunon me çetën vullnetare që kishte krijuar kushëriri i tij Tushi, nën kujdesin e Sheh Sulës, si edhe me të gjitha çetat e tjera që vepronin në Gryken e Madhe. Merr pjesë në një sërë aksionesh luftarake kundër pushtuesit osman. Merr pjesë në kuvendet e dheut që organizonte Sheh Sula me krerë të tjerë të Dibrës.

Me organizimin e xhandarmërisë shqiptare nga qeveria e Vlorës, dhjetor 1913, Hajredin Shehut iu ofruan detyra në radhë të saj. Kujdeset për ruajtjen e rendit dhe punon për shtrirjen e administratës së qeverisë së Vlorës. Përkrah dhe është mbështetës i princ Vidit, i qeverisë së tij. Me ardhjen e tij ai vendoset në Durrës. Me largimin e princ Vidit, edhe Hajredini si shumë nëpunës të tjerë në shërbim të princit u larguan. Kthehet në Zerqan dhe vihet në shërbim të Teqes, kryen edhe shërbesat fetare meqë Sheh Sula ishte i pamundur për moshën që kishte.

Gjatë Luftës së Parë Botërore merr pjesë në një sërë ngjarjesh politike biles edhe me armë. Vdekja e Sheh Sulës e tronditi shumë. Kjo qe një humbje shumë e madhe jo vetëm për Teqenë e Zerqanit, por edhe për lëvizjen kombëtare në Dibrën e Epërme. Pas vdekjes së Sheh Sulës, Sheh Hajredini bëri emër në ngjarjet kryesore të kohës. Tashme ai është figura qendrore atdhetare e klerikale e Teqes dhe e krahinës.

Hajredin Shehu zhvillon një veprimtari të gjithanshme kundër pushtuesve serbe. Merr pjesë si përfaqësues i Grykës së Madhe në një sërë takimesh me krerë e intelektuale; bisedon me Elez Isufin, Dan Camin e të tjerë për organizimin e luftës kundër pushtuesit serb dhe çjerrjen e maskës së sadistëve. Edhe pse larg ai ka informacion të plotë rreth Konferencës së Paqes në Paris. Për të kundërshtuar përpjekjet e jugosllavëve për kufirin "Strategjik", Hajredin Shehu pasi këshillohet me krerë nga Gryka e Madhe, Gryka e Vogël e Bulqiza lëviz në qytetin e Dibrës së Madhe, Peshkopi, Dibër të Poshtme, Mat në përpjekje për të krijuar një besëlidhje e qëndresë të përbashkët. Pas shumë përpjekjesh u arrit që në nënprefekturen e Matit të mbahej një mbledhje. Hajredin Shehu në përbërje të të dërguarve të Grykës së Madhe bashkë me dy shokë të tjerë marrin pjesë në mbledhje përkrah 42 krerëve nga Dibra, Mati, Mirdita. Të pranishmit diskutuan për domosdoshmërinë e organizimit të luftës kundër pushtuesve serbë por edhe kundër esadizmit, si tradhtar i kombit.

Bashke me disa shokë të tjerë patriotë nga Gryka e Madhe dha një ndihmesë të madhe për mbrojtjen dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit të Lushnjës. Mbështetja e këtij kongresi bëri që qeveria e Sulejman Delvinës t'i ofrojë detyra të rëndësishme. Fillimisht u emërua nënprefekt në Fullqet të Matit. Këtu përballoi me sukses shume vështirësi të krijuara si rezultat i luftimeve të zgjatura kundër pushtuesve serbë. Në Fullqet Hajredin Shehu më me forcë angazhohet në mbështetje të luftës së dibranëve kundër ushtrisë serbe. Në zbatim të Lidhjes së Kombeve ushtria serbe duhej të largohej nga Shqipëria. Për këtë Hajredini kërkoj të bisedojë me autoritetet serbe. Ai u kërkoi atyre një takim në shtëpinë e Sali Hasan Lalës, në Qafëmurrë. Të dy palët u zotuan se do të respektonin pikat e marrëveshjes, sipas të cilave forcat serbe duhet të linin viset e Bulqizës, Grykës së Vogël, Qafëmurrës e Lurës të qarkut të Peshkopisë. Hajredin Shehu, Shehat Shehu i Peshkopisë dhe Ali Rizai takuan në Peshkopi komandantin e ushtrisë jugosllave. U ra dakord që jugosllavët të respektonin vendimin e Fuqive të Mëdha dhe Dibra të zbrazej pa krisma armësh. Kështu me 10 dhjetor 1921 u larguan ushtarët e fundit serbë. Të entuziazmuar nga atmosfera e gëzimit në Peshkopinë e lirë u foli të pranishmeve Hajredin Shehu. Me një fjalim të gjatë evidentoi rrugën luftarake të dibranëve, lirinë e fituar me gjak, për të rënët etj. Ai bëri thirrje për besë e bashkim. Fjalën e mbylli me thirrjet: Rrofte flamuri! Rroftë Shqipëria! Rroftë Dibra e lirë!

Hajredin Shehu përkrahu dhe mbështeti "Lëvizjen e Marsit" 1922 me karakter demokratik. Mbështeti qeverinë e Fan Nolit. I vendosur në krah të saj, përcjell me shqetësim veprimtarinë antishqiptare të qarqeve jugosllave e greke. Emërohet nga kjo qeveri nënprefekt në Zerqan. Nën drejtimin e tij, Zerqani mori një pamje krejt të re.

Gjatë kësaj kohe kundërshton me forcë propogandën jugosllave se gjoja autoritetet vendore të nënprefekturës të Zerqanit dhe ata të prefekturës të Peshkopisë shkelin të drejtat e shtetasve me kombësi serbe, duke i quajtur ata vetëm shpifje e gënjeshtra. Hajredin Shehu bashkë me Elez Isufin përgatisin një dokument dhe ia dërgojnë prefekturës Peshkopi, ku protestojnë kundër këtyre shpifjeve, njëkohësisht kërkojnë që të hiqen elementet turbullues të Ahmet Zogut me shokë, të ndihmuar nga qeveria jugosllave, nga kufiri shqiptar, të cilët kërkojnë rikthimin e tij në Shqipëri. Por shqetësimi i tyre qe pa dobi. Fundviti 1924 shënoi fundin e qeverisë se Nolit dhe ardhjen në pushtet të Ahmet Zogut. Erdhi koha që pas disa vitesh qeverisjeje të Ahmet Zogut, edhe në krye të Republikës Shqiptare, edhe si "Mbret i Shqiptarëve", u duken përplasjet e para në mes Mbretërisë Shqiptare dhe Qeverisë Italiane, të cilat paralajmëruan rrezikun e pushtimit të Shqipërisë.

Lajmin ogurzi se Italia fashiste do të pushtonte Shqipërinë populli i krahinës së Zerqanit ashtu si i gjithë Shqipërisë e priti me dhimbje të madhe, po kështu edhe Sheh Hajredini. Vetë populli e ndjente nevojën e të dalurit zot vatanit. Për këtë Sheh Hajredini me 3 prill 1939 dërgoi lajmëtarë në fshatrat e Grykës së Madhe dhe të Bulqizës se do të shkonin në Durrës për të luftuar kundër pushtuesve italiane. U bashkuan me të qindra fshatarë të paarmatosur. Kaluan Qafën e Buallit me shpresën se do të gjenin baza furnizimi me armë e me ushqime. Por më kot. Tradhti dhe vetëm Tradhti... Kryeqeveritarët ishin larguar...

AMANET SHKOPIN!

Italia kërkonte që pushtimit të Shqipërisë t'i jepte ngjyrat e një shpëtimi e ripërtëritje kombëtare dhe jo të një pushtimi me dhunë. Për këtë u përgatit dërgimi në Itali i gjithë personaliteteve më të njohura të të gjitha fushave, dhe që ishin pro Italisë. U kërkua që bashkë me këta të shkonin edhe disa klerikë të njohur me autoritet, ndër të cilët ishte dhe Hajredin Shehu. Të gjithë së bashku do t'i dorëzonin "Kurorën e Skënderbeut" Viktor Emanuaelit, mbretit të Italisë, duke e shpallur atë edhe mbret të Shqipërisë.

Sheh Hajredini nuk pranoi të shkonte, por forca dhe kërcënimi i oficerit xhandar e mposhti. Nisja do të bëhej nga Kastrioti me avion. Sheh Hajredini e dinte se ky veprim përbënte një fyerje të paraardhësve të tij, një tradhti kombëtare, ndaj edhe dërgimit me dhunë në Romë iu shmang ashtu si dinte ai.

Në Kastriot ai u takua me Ramiz bej Dibrën, shoku i tij. Ky kishte rënë viktimë e joshjes fashiste. Hipi në avion dhe zuri vendin ku do të rrinte. Aty për momentin la shkopin me të cilin mbahej dhe i tha Ramiz beut:

-Po dal të prish një avdes, se jam pak me dhimbje barku.

Doli jashtë, u shtri diku, prapa një shkurreje. Po priste me ankth momentin kur do të nisej avioni. Kur avioni u ngrit, ky doli me vrap duke thirrur se më iku avioni. U kthye ne Peshkopi. Shkoi në PTT dhe i bëri një telegram Ramiz bej Dibrës. Në tekstin e tij shkroi: Amanet shkopin! Sheh Hajredini.

Kur u paraqit delegacioni para Viktor Emanuelit, Ramiz beu tha :

Gjithë delegacioni është prezent me përjashtim të Sheh Hajredinit, i cili paraqitet përpara jush i përfaqësuar nga ky shkop, dhe ia dha Viktor Emanuelit. Ky pasi e vërviti në duar disa here tha :

- Zoterinj, merreni me vete këtë shkop! Kur të vij në Shqipëri kam dëshirë të njoh të zotin e këtij shkopi. Ky është simbol i vëllazërimit.

Ramiz beu e solli shkopin në Shqipëri dhe ia dha Hajredin Shehut. Ndër të tjera i tha: Ti, or Sheh Hajredini kishe pasur të drejtë. Unë atje e kuptova se pushtuesi do peshqesh shkopin e jo kurorën.

PËRCJELLJA NË BANESËN E FUNDIT

Sheh Hajredini vdiq më 6 prill 1940. Vdekja e tij qe një dhimbje e madhe për familjen, për bashkëfshatarët, për gjithë krahinën. Lajmi për vdekjen e tij u shpërnda si rrufja në Peshkopi, Tiranë e gjetkë.

U grumbulluan klerikë e pari, besimtare e njerëz të thjeshtë nga të gjitha anët. Në këtë ditë të përmotshme kujtonin Hajredinin klerikë dhe atdhetar nga gjithë vendi. Në fjalën e tij përpara arkivolit, Sheh Tasimi, kryetar i grupit të sekteve aleviane të Shqipërisë, e quajti këtë një humbje të madhe trimërie, atdhetarie, klerikale e kulturore.

Veprimtaria e Sheh Hajredinit qe një shembull i lartë patriotik, një kushtrim për bashkëkohësit dhe brezat në mbrojtje të qenies kombëtare.

portret

Jakup Sofraçani përkrahu reformat që ndërmori qeveria e dalë nga Revolucioni i Qershorit 1924.

Jakup Sofraçani, patriot i Grykës së Madhe

Nga **ZABIT LLESHI**

Në veprimtarinë e përditshme shumë njerëz punojnë e luftojnë për fshatin e krahinën, duke lënë gjurmë në zhvillimin dhe përparimin e tyre. Populli e shpërblen këtë duke i dhënë emrin që e trashëgon brez pas brezi.

I tillë ishte edhe Jakup Cani nga Sofraçani. Lindi në gusht të vitit 1848(165 vjet ma parë), në një familje me tradita të hershme patriotike. Babai i tij, Sulejman Cani (hoxhë Cani) kishte një kulturë orientale që e kishte marrë në një shkollë teologjie në Stamboll.

Gjatë studimeve në Turqi kishte rënë në kontakt e bashkëpunim me patriotët e rilindjes. i njohur kundër reformave të Tanzimatit me patriotët Salë Markja, Fasli Malja, Fejzë Bulqiza etj, ka dhënë një ndihmesë të madhe kundër zgjedhës turke në dobi të çështjes kombëtare. Me këtë frymë patriotike u rrit Jakup Cani i cili qysh në rininë e tij u shqua për guxim e trimëri. Ai mësoi gjuhën turke nga babai si audidakt. Shoqëria "Drita" në gazetën "Bashkimi" propagandonte se gjuha shqipe do të sillte dashuri, bashkim e vllazërim. Kjo ndezi prushin e Grykës së Madhe për gjuhën shqipe[-1]). Seh Sula me teqen e Zerqanit në bashkëpunim me Said Najdenin, Shaqir Dacin,Sheh latifin dhe patriot të tjerë dibranë i dhanë një hov të ri çështjes kombëtare dhe arsimit shqip në fundin e shekullit nëntëmbëdhjetë dhe fillimet e shekullit njëzet.Jakup Cani mori pjesë në luftën e Dohoshishtit 1882 me Tush Lleshin duke u lidhur ngushtësisht me lëvizjen patriotike.

Vazhdimisht përkrah Sheh Sulës. Jakupin e gjejmë herë si përfaqësues të Malsisë dibrane në bisedime me autoritetet turke, herë si luftëtarë në radhët e malsorëve. Shpesh kreu dhe detyrën e përkthyesit midis përfaqësuesve të Qeverisë turke me malsorët. Në maj të vitit 1910 në kuvendin që u mbajt

> Veprimtaria dhe lufta për çështjen shqiptare e Jakup Canit i kaloi kufijtë e Dibrës dhe krahinave rreth saj, ai tashmë njihej në rrethet patriotike si Jakup Sofraçani emër të cilin e ruajti me dinjitet deri në fund të jetës së tij.

tek Gjurra e Mazhicës nën kryesinë e Isuf Karasanit dhe Mersim Demës, Jakup Cani kryesonte këshillin e Grykës së Madhe deri në shpalljen e pavarësisë së bashkueme me Osman Lleshin Zogje, Ram Dukën Stushaj, Zenel Hoxhën Gjuras, Osman Karajn Bulqizë[-2]). Në tetor 1910 në Fushë të thatë të Gjoricës, në prani të 1500 pjesëmarrësve nga Gryka e Vogël,Gryka e Madhe dhe Bulqiza u organizua një tubim që mori përmasat e një mitingu[-3]). Malësorët i paraqitën Mytesarifit të Dibrës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre Jakup Cani, Osman Karaj, Selman Kurti, Allaman Elezi, 5 kërkesa që konsistonin në: "Të gjithë burrat nën armë ishin gati të luftonin si vetëdashës (vullnetar) edhe si ushtar të rregullt nëse siguroheshin të drejtat kombëtare.

Gjithashtu nuk mund të visheshin ushtar deklaronin ata, deri sa t'u përgjigjet qeveria kërkesave që ka malësia" Përfaqësuesit e dibranëve po aty theksonin se ishin gati "t'i shërbenin atdheut si më besnikët e perandorisë osmane duke u gëzuar me të drejtat e tyre" do të shkruante Hasan Ballanca në gazetën "Drita" e Manastirit.[-4]).

Mytesarifi (prefekti) i Dibrës u informua se malësorët kanë lidhur si gjithnjë besën për të mbrojtur edhe gurin e fundit të Atdheut, njohjen dhe lejimin e hapjes së shkollave shqipe etj. Veprimtaria patriotike e Jakup Canit erdhi duke u rritur në lëvizjen për pavarësi e veçanërisht në Lëvizjen e Plugut (Gropat e Ukut), i cili krahas Mersim Demës udhëhiqte një çetë të armatosur të Grykës së Madhe në mbështetje të kërkesave për largimin e trupave turke nga Dibra e hapjen e shkollave shqipe. Në gusht të vitit 1912 mbledhja e Maqellarës e ngarkoi Jakup Canin si përfaqësues i Nëntë Maleve të shkonte në Shkup të bisedonte me udhëheqësit kosovarë për qëndrimin që duhej të mbanin malësorët pas triumfit të kryengritjes në viset dibrane. Udhëheqësit kosovarë nëpërmjet Jakup Canit iu kumtuan dibranëve "Të gjitha kërkesat tona u pranuan, qëndroni në shtëpitë tuaja"[-5]).Veprimtaria dhe lufta për çështjen shqiptare e Jakup Canit i kaloi kufijtë e Dibrës dhe krahinave rreth saj, ai tashmë njihej në rrethet patriotike si Jakup Sofraçani emër të cilin e ruajti me dinjitet deri në fund të jetës së tij.

Mori pjesë aktivisht për ruajtjen e pavarësisë. Bashkë me Destan Pucën ruajtën besnikërisht frontin kundër pushtimit serb në kryengritjen e Grykës së Vogël, në vijën Çerenec-Viçisht (26 dhjetor-5 janar 1913 si dhe në kryengritjen e shtatorit 1913.

Kundërshtoi pushtimin Austro hungarez në vitet 1916-1918. Nuk besonte në premtimet e pushtuesve të rinj sidomos në politikën arsimore e kulturore, prandaj kërkonte që populli mos gënjehej nga propaganda e re skllavëruese.


Mbështeti lëvizjen e marsit 1922 krahas Elez Isufit, Halit Lleshit e Mehmet Duriçit, që ka hy në histori si një lëvizje "që synonte të krijonte në popull idenë e emancipimit shoqëror, idenë e çlirimit prej mbeturinave të feudalizmit dhe të vendosnin demokracinë në Shqipëri"[-6]). Ishte fanolist dhe përkrahu reformat që ndërmori qeveria e dalë nga Revolucioni i Qershorit 1924.

Vitet e pleqërisë i kaloi në Sofraçan ku ndërroi jetë në moshën 85 vjeçare në vitin 1933. Familja e Jakup Canit ishte një familje madhe. Ashtu si dhe familjet e tjera të fshatit Sofraçan, edhe kjo i dha një ndihmesë të madhe luftës Nacional-çlirimtare. Arif Cani (nipi) u vra në luftën italo-greke. Ramadani (djali) u vra më 17 korrik 1944 kur Sofraçani u dogj krejtësisht nga pushtuesit gjermanë dhe ku u vranë 7 veta. Bajram Cani (i afërt) si kryetar i këshillit Nacional-çlirimtar përballoi punën për rimëkëmbjen e pasojave të luftës që zgjatën për shumë kohë. Shaqiri (nipi) për veprimtari të rrezikshme në favor të luftës (kështu vlerësohej nga pushtuesi) kaloi në ilegalitet. Skënderi më i riu si korrier me çetat territoriale.

Shtëpia dhe gjithë fshati ishin bazë e luftës Nacional-çlirimtare."Kur dola partizan në çetën e Dibrës, pashë se shtëpia e Shaqirit me të vëllain e tij Skënderin (nipat e Jakup Canit (Z.Ll) ishte bazë e partizanëve, ku u strehova disa herë së bashku me Haxhi Lleshin dhe shokë të tjerë prej të cilëve mësova se Shaqiri duke qenë shofer në kuesturë ndihmonte çetën partizane"-[7]).

REFERENCA

1-Lutfi Hanku "Rruga e Arbërit" tetor 2012 , faqe 8
2-Mois Murra "Mersim Dema" f.56
3-Hasan Ballanca "Dritë e Manastirit", 9 vjeshtë e dytë 1911.
4-Hasan Ballanca "Drita e Manastirit" artikulli "Çështjet malësore" N.38. 9/10/1911.
5-Haki Stërmilli "Dibra në prag të historisë"
6-Gazeta "Ora e maleve" 19 korrik 1924.
7-Eshref Palikuqi Kujtime nga lufta Nacional-çlirimtare. Dibër, dorëshkrim.



Librin HISTORIA E DIBRËS
të Kristo Frashërit mund ta gjeni në Tiranë pranë librarisë së Shtëpisë Botuese M&B, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.
Në Peshkopi: Libraria "Fleta XXI", pranë Muzeut.
Në Dibër të Madhe: Rexhep Torte. e-mail <diars@t-home.mk>
Në Durrës: Libraria "Dyrrah". Tel. 0694053353
Për porosi: tel. (04) 22 33 283 / 069 20 68 603
068 65 08 441 / 067 30 73 265
E-mail: <mbbotime@gmail.com>

Thirrje për sponsorizim

Shtëpia Botuese "M&B" ka në proces botimi dy libra me vlera historike, kulturore dhe kombëtare për Dibrën dhe gjithë Shqipërinë:
"ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE"
dhe monografinë **"ABDYL FRASHËRI"**
- Jeta, veprimtaria dhe shkrimet
të **Akademikut KRISTO FRASHËRI.**

Individë ose biznesmenë që dëshirojnë të bëhen bashkëkontribues në këto projekte, mund të na shkruajnë në email:
mbbotime@gmail.com/ botimemb@gmail.com
ose në tel: 069 20 68 603.
Faleminderit!

foto e muajit

A jeni gati për një kafe duke lexuar gazetën?

Gazeta “Rruga e Arbërit” prej 8 vitesh po na shoqëron çdo muaj me lajme nga vendlindja. Por jo vetëm aq, por edhe me informacione mbi botimet, kulturën, traditën, sportin, mbi të gjithë sukseset e dibranëve në botë, pse jo edhe me gjithçka që na frymëzon dhe na bën ta kujtojmë gjithmonë me mall Dibrën tonë të dashur. Por mbi të gjitha, na mban gjallë ëndrrën tonë për rrugën e Arbrit, që shpresojmë të mbarohet sa më shpejt. Unë jetoj në New York dhe jam i abonuar.
Çdo muaj e marr gazetën, me email dhe kur më vijnë miqtë nga Dibra ma sjellin edhe të printuar. Por që ajo të na jetë më pranë ka nevojë për mbështetjen tonë.
Dhe mbështetja jonë është vetëm një abonim...
Dhe ky abonim kushton sa dy kafe ekspres!
Shumë, shumë pak në krahasim me atë që gazeta na dhuron çdo muaj...
Për abonime në gazetë shkruaj: <rrugaearberit@gmail.com>

Gazmend Kërkuti / Dibra Dibër Debar
https://www.facebook.com/dibra.debar.9

Firmos peticionin për rrugën e Arbrit
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arbëri-road-ndërtoni-sa-më-shpejt-dhe-me-standarde-rrugën-e-arbërit